

PËRMBAJTJA E REVISTËS:

Numri XXXIX, viti 2007

Faqe

Reforma ligjore dhe Integrimi European:

Opinione mbi reformën në drejtësi:

Fatos BEJA 4

Fatmir XHAFAJ 9

Rëndësia e mbrojtjes së dëshmitarëve të krimeve të rënda.

Rezana BALLA 16

Sistemi i menaxhimit të çështjeve CCMIS si pjesë e reformës
në sistemin shqiptar të drejtësisë.

Rovena QOSE 58

E Drejta Kushtetuese:

Reforma gjyqësore dhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese

Fehmi ABDIU 68

Sistemi zgjedhor ndërmjet kushtetutshmërisë dhe politikës

Sokol SADUSHI 89

Legjislacioni i miratuar:

Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend

Filip LAKO 101

Punimet e Kuvendit

Nga punimet e Kuvendit për periudhën 21 janar – 3 mars 2008

Alma KONDAKÇIU 122

TABLE OF CONTENTS:

39th issue, year 2007

	Page
<hr/>	
<i>Legal Reform and European Integration:</i>	
Opinions about the reform on judiciary:	
Fatos BEJA	4
Fatmir XHAFAJ	9
Importance of protection of witnesses of severe crimes	
Rezana BALLA	16
The CCMIS management system of the cases as part of the reform in the Albanian justice system	
Rovena QOSE	58
<hr/>	
<i>Constitutional Law:</i>	
Judiciary reform and jurisprudence of Constitutional Court	
Fehmi ABDIU	68
Electoral system in between constitutionalism and politics	
Sokol SADUSHI	89
<hr/>	
<i>Legislation passed by the Assembly:</i>	
Information on legislation approved by the Assembly	
Filip LAKO	101
<hr/>	
<i>From the proceedings of the Assembly:</i>	
From the proceedings of the Assembly for the period 21 January – 3 March 2008	
Alma KONDAKÇIU	122
<hr/>	

Rubrikat në vijim synojnë prezantimin e politikave ligjore dhe trajtimeve teorike për organizimin dhe funksionimin e institucioneve kushtetuese. Botuesi vlerëson si një kontribut në zhvillimin dhe përmirësimin e funksionimit të institucioneve kushtetuese, paraqitjen e opinioneve dhe mendimeve të studiuesve të ndryshëm, në mënyrë të paanshme dhe objektive, duke nxitur një debat profesional.

Opinionet e paraqitura janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin e botuesit të kësaj reviste.

Opinione mbi reformën në drejtësi

*Fatos BEJA,
Kryetar i Komisionit të Çështjeve Ligjore, Administratës Publike
dhe të Drejtave të Njeriut,
Kuvendi i Shqipërisë*

CILAT JANË OBJEKTIVAT QË SYNON REFORMA NE DREJTËSI DHE KONKRETISHT LIGJI “PËR ORGANIZIMIN GJYQËSOR”?

Gjykoj se ka një teprim në përdorimin e fjalës reformë në drejtësi, dhe për më tepër me nënkuptimin e ndryshimeve rrënjësore në organizimin e sistemit. Sigurisht, një shpjegim e ka pse opinioni publik dhe politika flasin kaq shumë për reformë në drejtësi. Ne të gjithë jemi të vetëdijsëm se gjyqësori shqiptar ka probleme serioze, është shumë larg standardeve europianoperëndimore, jo thjesht për cilësinë profesionale të dhënies së drejtësisë, që edhe ajo është problem, por mbi të gjitha për “shitjen e drejtësisë” dhe besueshmërinë publike shumë të ulët që cenon sigurinë juridike në shoqëri. Dukuria e “vetëgjyqësisë”, që del herë pas here në shoqërinë tonë akuzon për një standard shqetësues të gjyqësorit shqiptar. Në një vend të vogël si Shqipëria, ku çdokush njih shumëkënd, çdo “shitje drejtësie” nuk shpëton pa u marrë vesh e pa u komentuar në tryezat familjare e miqësore. Dhe aq më tepër që produkti “padrejtësi”, penale ose civile, gjendet rëndom në treg, në formën e vrasësve që për pak kohë kalojnë nga sistemi ynë i drejtësisë në qarkullim të lirë publik, në formën e grabitësve të pronës së tjetrit që rrezatojnë fuqi e pozicione komode shoqërore dhe në shumë forma të tjera të tilla.

Përgjegjësinë për një standard kaq të ulët të gjyqësorit shqiptar e kanë pa dyshim vetë gjyqtarët, edhe pse politika nuk i shpëton dot pjesës së vet të përgjegjësisë. Është e vërtetë që në çdo proces gjyqësor ka një palë që humbet, pra që del e pakënaqur; është po ashtu e vërtetë që në mjedisin publik flitet lehtë për skandalet e drejtësisë, por jo për proceset profesionalisht të suksesshme. Megjithatë, nuk mohohet dot që perceptimi popullor për korrupsionin më të lartë në gjyqësor ka një bazë reale. Gjykoj se është e pazakontë që gjyqtarët vetë nuk shprehin ndonjë shqetësim për këtë, që nuk pamë një sallë me gjyqtarë që të debatojnë për korrupsionin në drejtësi ose një reagim tjetër nga brenda sistemit, qoftë institucional, qoftë shoqëror. Shohim që po krijohen shoqata gjyqtarësh, jashtë Konferencave Gjyqësore, për “të mbrojtur të drejtat e tyre”. Por, si nuk doli një grup gjyqtarësh të ndershëm të krijonte një shoqatë për të mbrojtur cilësinë e dhënies së drejtësisë në Shqipëri dhe besueshmërinë e gjyqësorit, pra, luftën kundër korrupsionit në gjykata. Qytetarët do ta vlerësonin një përpjekje të tillë nga brenda sistemit. Meqenëse kjo nuk po ndodh, gjithë shpresat janë te “reforma”. Në fakt, besueshmëria e ulët e qytetarëve te gjykatat tona dhe keqfunksionimi i gjyqësorit te ne nuk vjen për shkak të cilësisë jo të mirë të ligjit, por për shkak të moszbatimit të kërkesave ligjore, për shkak të shkeljes së pandëshkuar të ligjit. Ky është shqetësimi më kryesor për gjyqësorin tonë. Mund t’i ndërrosh modelet ligjore ose mënyrën e organizimit të institucioneve të drejtësisë, por ndryshimi nuk do të vijë thjesht nga ndryshimi. Madje, ndryshimet e shpeshta nuk janë të mira.

SI VLERËSOHET PAKTI PËR DREJTËSINË DHE SA I QËNDRUESHËM ËSHTË BASHKËPUNIMI NDËRMJET MAZHORANCËS DHE OPOZITËS NË REFORMAT PËR DREJTËSINË?

Jam i kënaqur nga përpjekjet që po bën politika sot për të bërë përmirësime ligjore, por po përiqem të përkufizoj kuptimin e fjalës reformë. Një reformë rrënjësore në gjyqësorin e një vendi kërkon një studim kohëgjatë

për defektet në funksionimin e sistemit, të realizuar me metoda shkencore të kërkimit të shkaqeve dhe zgjidhjeve më të mira, që edhe pse mund të vijë nga nevoja ose presione shoqërore e politike, kryhet brenda sistemit me aktorë institucionet e sistemit. Përfundimet e studimit i shërbejnë reformës që mund të përfshijë ndryshime të kushtetutës, të ligjeve organike që rregullojnë pushtetin gjyqësor, të institucioneve të dhënies së drejtësisë dhe të parimeve bazë të funksionimit të këtij pushteti. Pa dyshim një reformë e tillë nuk mund të arrihet pa një mbështetje të përbashkët të palëve politike e parlamentare. Në rastin tonë nuk kemi të bëjmë me një situatë të tillë. Kushtetutën dhe ligjet që organizojnë sistemin e drejtësisë i kemi të gjitha të modeleve europiane dhe më pak se dhjetë vjet, në një kohë që shtetet me gjyqësor të stabilizuar i kanë prej shumë dekadash. Kodet po ashtu janë të mesit të viteve '90. Në shoqërinë shqiptare është evidentuar mungesa e zbatimit të ligjit, mungesa e besueshmërisë së publikut ndaj gjykatësve, shkalla e lartë e korrupsionit, mosndëshkimi i shkelësve të ligjit, mosbashkërendim i institucioneve të sistemit të drejtësisë etj. Shoqëria jonë është e shqetësuar nga këto dukuri, madje dhe bashkësia europiane ku duam të integrohemi i ka identifikuar këto probleme. Gjendja është emergjente dhe ne duhet t'i përgjigjemi nevojës së shoqërisë. Edhe përpjekjet për të pasur një pakt për drejtësinë midis mazhorancës dhe opozitës synon pikërisht për të identifikuar bashkë me aktorët e sistemit të drejtësisë mekanizmat dhe rrugët që do të sjellin zbatimin e ligjit dhe ngritjen e standardit në pushtetin gjyqësor të Shqipërisë. Janë të gjitha mundësitë që kjo të jetë një ndërmarrje e suksesshme dhe nuk ka aspak ngjyra politike. Ndryshimet e arritura bashkërisht nga palët politike në Kuvend garantojnë jetëgjatësinë e ndryshimeve dhe mbrojtjen e gjyqësorit nga rotacionet politike, ndërsa bashkëveprimi me pushtetin gjyqësor, që do të garantohet edhe me instrumente politike dhe kuvendore, do të mund të na garantojë cilësinë e ndryshimeve.

CILAT JANË ÇËSHTJET KRYESORE QË ADRESON LIGJI I RI PËR ORGANIZIMIN GJYQËSOR DHE MEKANIZMAT E PËRZGJEDHUR.

E përsëris, ne ligjet i kemi të rinj, të modeleve europiane dhe të hartuar me ekspertizë europianoperëndimore. Duket këto ligje janë bërë për njerëz që synojnë si ta zbatojnë ligjin dhe jo si t'i shmangen ligjit për interesa të përfitimit vetjak. Duke parë ç'ka ndodhur te ne këto dhjetë vjet, jemi përpjekur, edhe në miratimin e ndryshimeve të para ca ditëve në ligjin për organizimin e pushtetit gjyqësor, të mbyllim shtigjet e keqpërdorimit të ligjit, të objektivizojmë sa më shumë kërkesat ligjore, duke ulur sa më shumë interpretimet subjektive, duke konkretizuar ndëshkimet disiplinore e duke mbrojtur gjyqtarin nga presionet që i vijnë nga brenda sistemit ose nga jashtë tij në procesin e dhënies së drejtësisë.

Ligji i ri për pushtetin gjyqësor e përmirëson funksionimin e pushtetit gjyqësor, forcon pavarësinë e gjyqtarëve dhe mbrojtjen kushtetuese të tyre, ul dukshëm subjektivizmat që bëhen terren për korrupsion. Bëhet kujdes që personat që do të merren me dhënie e drejtësisë të kenë mundësi që të merren gjithë jetën me këtë profesion me një rol shumë të veçantë në shoqëri, të trajtohen mirë financiarisht për punën që bëjnë, kuptohet në kushtet e nivelit të jetesës te ne, dhe të mos ta shikojnë atë si një trampolinë për t'u marrë me veprimtari të tjera. Ligji i ri garanton karrierën e gjyqtarit mbi baza objektive e kritere profesionale që nga çasti i rekrutimit, pra, hyrjes në sistem, gjatë ngjitjes për meritë nëpër shkallët e gjyqësorit e deri në daljen në pension të tij. Ligji i shton mundësitë rregullatore të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, fut konkursin e mekanizma vlerësuese objektive për aftësitë profesionale, për zgjedhjen e lëvizjen e kryetarëve të gjykatave, përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të gjyqtarëve, të përvojës dhe rezultateve në punë për çdo gjyqtar, ndëshkimin disiplinor e deri në shkarkim të gjyqtarëve që shkelin ligjin.

Gjithësesi miratimi i këtij ligji nuk i zgjidh të gjitha problemet që ndihen sot në pushtetin tonë gjyqësor. Nevoja për të përballuar gjendjen emergjente nuk na lejon të realizojmë një paketë tërësore të të gjitha ligjeve të pushtetit

gjyqësor, një punë që do t'i ngelet të ardhmes. Ne synojmë që shumë shpejt të ndërhyjmë në disa ligje të tjera që rregullojnë funksionimin e institucioneve të drejtësisë, në mënyrë që të arrijmë standardet komunitare edhe në gjyqësor, duke përfshirë administratën e gjykatave, prokurorinë, inspektimin e gjyqësorit, profilizimin në dhënien e drejtësisë, ngritjen e aftësive profesionale të të gjithë trupës së gjyqtarëve etj. Një punë që do të kryhet në bashkëveprim të ngushtë e të hapur, transparente me këto institucione dhe grupet e tjera të interesit.

Opinione mbi Reformën në Drejtësi

*Fatmir XHAFAJ,
Nënkryetar i Komisionit të Çështjeve Ligjore, Administratës
Publike dhe të Drejtave të Njeriut,
Kuvendi i Shqipërisë*

SI VLERËSOHET PAKTI PËR DREJTËSINË DHE SA I QËNDRUESHËM ËSHTË BASHKËPUNIMI NDËRMEJT MAZHORANCËS DHE OPOZITËS NË REFORMAT PËR DREJTËSINË.

Pakti kombëtar për drejtësinë është një realitet i pranuar tashmë politikisht, është ravijëzimi i të nesërmes së pashmangshme dhe njëkohësisht është një model dhe një praktikë që duhen përqafular sa kohë që nuk do të donim më të vazhdonim të krijojmë hendek nga idetë me veprat që tentojmë të shkruajmë. Është një ndihmesë që dëshmon se parimet mund të bashkohen dhe të shumëfishojnë punën e përbashkët në dobi të qytetarit. Në këtë frymë, Partia Socialiste është jo vetëm shprehëse dhe mbartëse e këtij vullneti, por është dhe ushtruese pa mëdyshje e vullnetit për ndryshim dhe emancipim të gjithë politikës shqiptare, edhe nëpërmjet emancipimit të vetvetes.

Ideja e Partisë Socialiste për të propozuar, promovuar e mbështetur një pakt kombëtar për drejtësinë buron nga njohja e nevojës për reformimin e sistemit të drejtësisë dhe synon, ndër të tjera :

- të nxisë e të formulojë një qasje tjetër të procesit, ta largojë atë nga shtrati i demagogjisë së fjalës e deklarimeve emocionale që në vetvete përbëjnë një rrezik të shtuar ndaj procesit dhe ta shndërrojë në një proces

debati konstruktiv, gjithëpërfshirës dhe në funksion të zgjidhjeve efektive;

- të krijojë garancinë për ruajtjen e një raporti kushtetues ndërmjet pushteteve në këtë proces, të vendosë një marrëdhënie të re ndërmjet politikës e drejtësisë, të synojë të mbyllë përfundimisht tranzicionin e vështirë të përpjekjeve për vënien e drejtësisë në shërbim të politikës, duke synuar angazhimin e saj për t' i shërbyer më mirë jo thjesht sistemit për hir të sistemit, por vlerave e qëllimeve të tij dhe, nëpërmjet tyre, t' i shërbejë qytetarit.

Projekti i propozuar është fryt i një debati të gjerë brenda dhe jashtë PS-së, ndihmesë i disa ekspertëve të njohur në fushën e së drejtës dhe i këshilluar me shumë të tjerë të njohur për përvojën e profesionalizmin e tyre. Projekti nuk është mbyllje e debatit dhe as përfundimi e vendimmarrja e procesit. Përkundrazi, paraqitja i tij publike duhet konsideruar një ftesë për të ndërtuar një proces aktiv debati brenda dhe ndërmjet krahëve të politikës, njerëzve që shërbejnë në sistem dhe strukturave të tyre përfaqësuese, ekspertëve të shoqërisë civile dhe vetë qytetarëve. Nisma e ndërmarrë dhe projekti që propozohet i parë si nismë politike e ligjore është një shans historik, për të ndryshuar mënyrën e të bërit politikë nga politika dhe njëherësh është një mundësi për të rimodeluar një funksion jetik të shtetit siç është drejtësia dhe për ta bërë atë më funksionale në shërbim të qytetarit dhe të procesit integruar të vendit.

Roli aktiv i opozitës në këtë proces është vijim i asaj fryme të re që ne po tentojmë të sjellim në politikë, është frut i bindjes së thellë që reformimi i sistemit të drejtësisë nuk është pronë vetëm e një pjese të shoqërisë, por është një mekanizëm që ndikon në radhë të parë edhe në vetë emancipimin e saj. Ne u nxitëm edhe nga paaftësia e shfaqur nga mazhoranca aktuale, e cila u kujdes më shumë për disa aspekte të forcimit të pushtetit politik, u miklua nga defektet e sistemit dhe u përpoq t' i shfrytëzojë ato për ta kontrolluar këtë sistem. Në këtë mënyrë, ajo nuk arriti të adresonte problematikat reale të sistemit të drejtësisë dhe nuk arriti të formulojë një strategji të qartë e të realizojë një proces aktiv e gjithëpërfshirës. Nga ana

tjetër, ne mendojmë se zgjedhësit kanë të drejtën të dinë se cila është oferta jonë publike në këtë fushë, të na vlerësojnë për qasjen tonë ndaj kësaj problematike dhe reformës përkatëse.

Një shembull konkret i seriozitetit të opozitës në këtë proces është edhe qëndrimi i saj lidhur me projektligjin për organizimin e pushtetit gjyqësor. Rëndësia e një akti shumëfishohet jo vetëm nga thelbi i tij, por edhe nga rruga për të mbërritur deri te vetë akti. Dhe ky projekt mbetet një nga ato pak punë serioze të këtij Kuvendi, i cili u përpilua në një frymë konsensusi dhe bashkëpunimi të gjerë, sipas një parimi vërtet të rrallë për politikën shqiptare. Opozita në gjithë këtë proces dëshmoi një filozofi të qartë konstruktiviteti, duke abstraguuar nga fakti se kush është në pushtet dhe kush në opozitë, me bindjen e thellë se ky ligj, si dhe të tjerë të të njëjtit korpus, i shërbejnë drejtpërdrejtë sistemit të drejtësisë, dhe në fund të fundit, detyrimin të politikës për shërbesë ndaj qytetarit.

CILËT JANË OBJEKTIVAT QË SYNON REFORMA NË DREJTËSI DHE KONKRETISHT LIGJI “PËR ORGANIZIMIN GJYQËSOR”?

Pavarësisht këndvështrimeve, arsyeve e motivimeve të ndryshme, të gjithë sot bashkohemi në një pikë: të gjithë e pranojmë domosdoshmërinë e një procesi reformues në sistemin e drejtësisë. Ndryshe nga reformat në sektorë të tjerë, qasja te drejtësia është shumë më delikate e komplekse.

Unë besoj se në këtë reformë nuk e fillojmë punën në një terren të kuotës zero. Ne kemi një rregullim kushtetues e ligjor të sistemit relativisht të ri. Sistemi nuk ka funksionuar keq, përkundrazi në shumë drejtime ka arritje të vlerësuara dhe në disa aspekte u ka rezistuar mirë edhe presioneve që i janë bërë, çka dëshmon qëndrueshmërinë vepruese të institucioneve. Njëherësh është duke u krijuar një shtresë profesionistësh të sistemit që besojnë përditë e më shumë të përgjegjësia dhe vlerat morale e ligjore të funksionit që ushtrojnë. Por pavarësisht këtyre, ka një perceptim të qartë negativ të publikut ndaj sistemit dhe veçanërisht ndaj njerëzve që shërbejnë

në të, mungesë besueshmërie te vendimmarrja e tyre. Teste e mjaft analiza serioze provojnë praninë e shkallës së lartë të korrupsionit në hallka të ndryshme të sistemit, paaftësi profesionale e keqmenaxhim të proceseve hetimore e gjyqësore. Ndaj ndërhyrja në sistem, siç dhe e theksova, është mjaft delikate edhe sepse është shumë e vështirë të ndryshohet perceptimi i krijuar në vite dhe të zhbëhet tradita e keqe.

Ne e kemi të qartë se duhet pranuar se deri më tani ka munguar një analizë e qartë dhe e plotë mbi funksionimin e sistemit, ka munguar mirë për caktimi i aspekteve që kanë nevojë të forcohen ose të ndryshohen dhe përmirësohen. Nxitimi i papërligjur është shtrati më i përshtatshëm për gabime. Kështu, ka ndodhur shpesh në të shkuarën, kësaj duhet t'i ruhem të mos ndodhë sërish edhe tani. Çdo gabim ka pasojën e vet, por gabimet në drejtësi i paguajnë të gjithë, për një kohë të gjatë e me mundësi riparimi të kufizuara.

Porë në këtë optikë, në vlerësimin tim problemi nuk qëndron aq te sistemi në tërësi, te rregullimi kushtetues i organizimit dhe funksionimit të tij, sesa qëndron te mekanizmat e tij përbërës që kanë nevojë të sistemohen e harmonizohen më mirë në raport me të tërën dhe ndërmjet tyre, me nevojën për të përmirësuar cilësitë dhe qëndrueshmërinë morale e ligjore të njerëzve që shërbejnë në sistem.

Kjo do të thotë se nuk është e nevojshme të preket thelbi kushtetues, i sistemit, por duhen ndërhyrje në aspekte të veçanta të mirëfunksionimit të tij, të cilat kanë nevojë për kirurgji të plotë, të qëndrueshme dhe të harmonizuar në kuadrin ligjor përkatës, lidhur me mirëfunksionimin e institucioneve të sistemit, siç janë ligjet për organizimin gjyqësor, Këshillin e Lartë të Drejtësisë, Konferencën Gjyqësore, Prokurorinë, Ministrinë e Drejtësisë etj. Nga ana tjetër, mendoj se sot është koha për të bërë ndërhyrje të plota, të qëndrueshme dhe të harmonizuara në terrenin, në të cilin vepron sistemi i drejtësisë, duke përfshirë kodet materiale e procedurale.

Ne vlerësojmë se një reformë efektive në drejtësi kërkon domosdoshmërisht një proces gjithëpërfshirës dhe profesional, duke vendosur

një dialog intensiv me të gjithë faktorët e aktorët e vetë sistemit, si dhe me grupet e tjera të interesit, si mundësia më e mirë në funksion të nevojës për të identifikuar e mirëpërcaktuar problemet themelore që ka drejtësia sot dhe që meritojnë ndërhyrje. Këtë frymë përcjell edhe nisma jonë për paktin kombëtar për drejtësinë dhe plani i veprimit me masat afatshkurtra që ne kemi propozuar. Ky plan veprimi parashikon hapjen e një dialogu intensiv me aktorët e sistemit dhe grupet e interesit për çështjet e mundshme që meritojnë të jenë objekt i reformës. Miratimi këto ditë nga Kuvendi i vendimit për ngritjen e një komisioni *ad-hoc* për drejtimin dhe organizimin e këtij procesi është një hap i mirëpritur në funksion të zbatimit të këtij plani veprimi. Ndër të tjera në të parashikohen seanca dëgjimore me faktorët dhe aktorët kryesorë të sistemit që ndikojnë drejtpërsëdrejti në efikasitetin e tij (Këshilli i Lartë i Drejtësisë; Gjykata Kushtetuese; Gjykata e Lartë; Prokuroria e Përgjithshme; Shkolla e Magjistraturës; Avokati i Popullit; Policinë e Shtetit; Universiteti i Tiranës, Fakulteti Juridik; Komiteti Shqiptar i Helsinkit; Dhoma Kombëtare e Avokatisë; organizata të shoqërisë civile, universitetet private etj).

Ligji për organizimin e pushtetit gjyqësor është një akt shumë i rëndësishëm, por jo arritja absolute e objektivit tonë të përbashkët; është një hap në kohën e duhur dhe drejtimin e duhur, por jo fundi i rrugës për reformimin e sistemit të drejtësisë. Mendoj se kemi ofruar një projekt, fryt i konsensusit politik e parlamentar dhe shprehje e vullnetit për domosdoshmërinë e përmirësimit të legjislacionit të sistemit të drejtësisë. Opozita shqiptare ka afruar një vullnet të plotë dhe një rol aktiv në të gjithë procesin, një rol i cili ka qenë i dukshëm jo thjesht e vetëm në planin politik, por i dobishëm dhe i vlerësueshëm edhe në planin profesional.

- CILAT JANË ÇËSHTJET KRYESORE QË ADRESON LIGJI I RI

“PËR ORGANIZIMIN GJYQËSOR” DHE MEKANIZMAT E PËRZGJEDHUR?

Projekti ka sjellë përmirësime të dukshme, të cilat janë derivat i një këshillimi të gjerë me ekspertët më të mirë të sistemit dhe me thithjen e gjithë atyre ideve racionale të ardhura nga vetë aktorët e sistemit dhe faktorët e tij që janë trajtuar në të njëjtën kohë si objekt dhe subjekt i ndryshimeve të propozuara. Në të janë pasqyruar përgjithësisht standardet ndërkombëtare dhe rekomandimet e BE-së, të përcjella nga misionet përfaqësuese në Tiranë, si Euralius e të tjerë.

Është fakt i pamohueshëm që projektligji i sjellë nga Qeveria, në reflektim edhe të vërejtjeve e sugjerimeve të ofruara nga aktorët e sistemit, ekspertiza vendase dhe ajo ndërkombëtare, në tërësinë e tij ka pësuar ndryshime pozitive. Nga 45 nene është ndërhyrë në mbi 2/3 e tij, jo vetëm në teknikën e projektimit, por edhe në thelbin e shumë dispozitave. Kjo, nga njëra anë, dëshmon mungesën e kapaciteteve përkatëse në Ministrinë e Drejtësisë (dhe kjo është shumë shqetësuese), por edhe bashkëpunimin jo në nivelin e duhur të ekzekutivit me ekspertizën vendore e ndërkombëtare në procesin e hartimit të draftit. Nga ana tjetër, është, gjithashtu, edhe një tregues i përgjegjshmërisë me të cilën është punuar në komisionin kuvendor të ligjeve. E vlerësoj normale dhe detyrim moral e parlamentar, që të çmoj ndihmesën e ekspertizës që iu ofrua komisionit nga profesionistët e respektuar E. Jorgaqi, G. Ibrahimit dhe V. Kosta, si dhe shumë të tjerëve brenda dhe jashtë sistemit, që me këshillat e sugjerimet e tyre të vlefshme kanë kontribuar në përmirësimin e përmbajtjes së këtij projektligji.

Projektligji ka pësuar ndryshime të rëndësishme veçanërisht në rregullimet e bëra lidhur me statusin e gjyqtarëve, emërimin dhe vlerësimin e tyre, karrierën profesionale e drejtuese, sistemin e pagave, procedimin disiplinor etj. Të gjitha këto janë ndihmesë e rëndësishme që kanë përmirësuar ndjeshëm përmbajtjen dhe qëllimin e ligjit, duke synuar konsolidimin e

pavarësisë së pushtetit gjyqësor, rritjen e efijencës së tij dhe njëherësh transparencën në kryerjen e këtij shërbimi.

Me këtë ligj pushteti gjyqësor në tërësi, institucionet përgjegjëse të tij dhe vetë gjyqtarët, kanë disa instrumente ligjore më bashkëkohore e më të qëndrueshme, që konsolidojnë statusin e tyre kushtetues e ligjor, por edhe japin mundësinë për të pasur një gjyqësor shumë më të përgjegjshëm në ushtrimin e funksionit të tyre në dhënien e drejtësisë.

Ky ligj, me dispozitat e miratuara, nuk ka si qëllim në vetvete për të garantuar që gjyqtarët të jenë të pavarur e të paprekshëm në ushtrimin e funksionit të tyre kushtetues, por synon, para së gjithash, të garantojë të drejtën kushtetuese të çdo shtetasi që çështja e tij të gjykohet nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, larg çdo lloj ndikimi politik, ekonomik e administrativ.

Rëndësia e mbrojtjes së dëshmitarëve të krimeve të rënda

*Rezana Balla**

HYRJE

Përgjatë dy dekadave të fundit vëmendja për rolin e dëshmitarit në procesin penal, si në nivel europian, ashtu edhe ndërkombëtar, është rritur ndjeshëm. Duke parë kërcënimin në rritje të popullsisë civile nga aktet terroriste, reagimi ligjor ndaj këtyre veprimeve duhet të jetë më i ashpër, me masa më të forta shtrënguese, jo vetëm ligjore, por njëkohësisht edhe institucionale, me synim parandalimin dhe luftimin e veprimeve jo vetëm terroriste¹, por edhe të gjitha veprimeve të paligjshme të krimit të organizuar. Mbrojtja e dëshmitarit është kthyer në një prej shqetësimeve kryesore për sistemin e drejtësisë penale të shumë vendeve europiane dhe, për pasojë, në një çështje studimore për vendosjen e standardeve dhe normimin e bashkëpunimit ndërkombëtar nga Këshilli i Europës dhe nga Bashkimi Europian. Këto zhvillime mund t'u atribuohen disa faktorëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin.

■ Faktori i parë lidhet me rritjen e krimit të organizuar dhe terrorizmit² në kontekstin që frikësimi drejtpërdrejt dhe tërthorazi, si dhe raprezaljet kundër

* Autorja është Përgjegjëse e sektorit të së Drejtës Familjare dhe Drejtësisë për të Mitur në Ministrinë e Drejtësisë

¹ “Reagimi ligjor ndaj fenomenit të terrorizmit sipas legjisllacionit shqiptar dhe ndërkombëtar”, 2007, R. Balla, bot. “E drejta Parlamentare dhe Politikat Ligjore”.

² Terrorizmi mbrojtja e dëshmitarit dhe e bashkëpunëtorit të drejtësisë , 2006, Maklu, Antwerp-Apeldoorn.

dëshmitarëve janë një pengesë reale dhe e pranishme për administrimin e drejtësisë. Provat e dhëna nga dëshmitarët në lidhje me këto krime, të njohura për vështirësinë e tyre të të provuarit dhe të ndëshkuarit janë themelore për arritjen e rezultateve të suksesshme. Grupet kriminale janë të afta dhe të gatshme të pengojnë hetimet dhe administrimin e drejtësisë, në një shkallë shumë herë më të lartë se sa kriminelët e shkëputur nëpërmjet frikësimit, dëmtimit ose korrupsionit të dëshmitarëve, ose të të afërmeve të tyre. Prania e masave ligjore dhe praktike për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të afërmeve të tyre, para, gjatë dhe pas gjykimit është në këtë kontekst një domosdoshmëri, jo vetëm në raport me interesat e një dëshmitari të veçantë, por, gjithashtu, një detyrë e shtetit për të garantuar integritet dhe efektivitet të sistemit të drejtësisë penale, në tërësi.

- Faktori i dytë është i lidhur me kuptimin dhe përdorimin në rritje, nga shumë sisteme të drejtësisë penale europiane, të bashkëpunëtorëve të drejtësisë si instrumente të rëndësishme³ në çmontimin dhe dënimin e grupeve të krimit të organizuar dhe grupeve terroriste. Nisur nga natyra e mbyllur e këtyre organizatave kriminale, dëshmia e bashkëpunëtorëve të drejtësisë, është shpesh jetike për marrjen e provave, lidhur me veprat penale të kryera nga individët, anëtarë të këtyre organizatave, si dhe për marrjen e informacioneve të nevojshme lidhur me funksionimin e gjithë grupit në tërësi. Për arsye të qarta, ish-anëtarët e organizatave kriminale ose terroriste që vendosin të bashkëpunojnë me autoritetet dhe të dëshmojnë kundër anëtarëve të tjerë të grupit, si dhe të afërmit e tyre, gjenden zakonisht nën rrezikun serioz të dëmtimit ose të zhdukjes.

³ Raportet shpjeguese të rekomandimeve të ndryshme të Këshillit të Europës, G Vermuelen (Ed.)

▪ Faktori i tretë lidhet në mënyrë të ngjashme me diçka që gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit është pranuar si një prej mjeteve të domosdoshme dhe të ligjshme në hetimin e krimeve të rënda - përdorimi i agjentëve të infiltruar (nën mbulim), të informatorëve dhe i mjeteve të tjera të posaçme hetimore në përgjithësi⁴. Një prej elementeve thelbësore për zhvillimin me sukses të operacioneve nën mbulim është konfidencialiteti i tyre tërësor dhe ruajtja e identitetit të vërtetë të agjentëve të infiltruar dhe i personave që vënë në zbatim mjetet e posaçme hetimore. Zbulimi i plotë i identitetit të këtyre personave gjatë një gjykimi me dyer të hapura mund të vërë në rrezik operacionet e mëtejshme dhe në mënyrë të veçantë në vendet e vogla do ta turbullonte së tepërmi mundësinë e përdorimit të mëtejshëm të agjentit të infiltruar, për trajnimin e të cilit dhe krijimin e identitetit të rremë të tij shteti normalisht investon burime të konsiderueshme materiale dhe njerëzore.

▪ Faktori i katërt mund t’i atribuohet vëmendjes në rritje që po i kushtohet pozitës së viktimës⁵ në procesin penal, në përgjithësi, dhe nevojave të veçanta të kategorive të caktuara të viktimave/dëshmitarëve në veçanti. Mbrojtja dhe mbështetja e viktimave – të konsideruara të prekshme ose për shkak të karakteristikave të tyre vetjake, p.sh. fëmijët, ose për shkak të llojit të krimit që është kryer kundër tyre, si dhuna brenda familjes, veprat penale me natyrë seksuale, trafikimi i qenieve njerëzore është pranuar dhe njohur nga shumë shtete europiane si një përgjegjësi e rëndësishme e sistemeve të drejtësisë penale. Përveç kësaj, nga këndvështrimi praktik i zbatimit të ligjit, dënimi me sukses i krimeve të tilla, si veprat penale seksuale, trafikimi i qenieve njerëzore ose dhuna familjare mund të cenohet seriozisht nëse viktimave do t’u kërkohej të paraqesin dëshminë në kushte që do t’u krijonin atyre trauma të reja, duke

⁴ Standardet e BE-së në raport me mbrojtjen e dëshmitarit dhe të bashkëpunëtorit me drejtësinë, 2005.

⁵ V. Hysi “Kriminologjia”, 2005, Tiranë.

i vënë përballë me të pandehurin, ose duke diskutuar çështje tepër intime në një gjykim me dyer të hapura.

▪ Faktori i fundit, por jo më pak i rëndësishëm nga të tjerët, ka të bëjë me faktin se dhënia e dëshmisë është konsideruar për një kohë të gjatë një detyrë civile dhe, në shumicën e vendeve, dëshmitarët mund të detyrohen të dëshmojnë nën kërcënimin e dënimit me gjobë ose edhe me burgim. Sidoqoftë, detyrimi për të dëshmuar është i drejtë vetëm për sa kohë dëshmitari nuk ka frikë për jetën e tij/saj ose të të afërmeve të tij/saj. Për pasojë, detyrimi i dëshmitarit për të dëshmuar duhet të bashkohet me përgjegjësinë e sistemit të drejtësisë penale për të krijuar një mjedis të përshtatshëm, në të cilin dëshmitari të dëshmojë lirisht dhe i pashqetësuar.

Në kontrast me këta faktorë dhe me faktorë të tjerë të ligjshëm që lidhen me interesat e prokurorisë dhe me interesat e viktimave dhe të dëshmitarëve, qëndrojnë garancitë themelore të gjyqimit të drejtë dhe të ndershëm, të barazisë së palëve, të së drejtës së mbrojtjes për të testuar dëshminë e dëshmitarit të sanksionuara në nenin 6 paragrafi 3/d të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut⁶, në të cilën parashikohet se “gjithkush që është akuzuar për kryerjen e një veprë penale ka të drejtë të pyesë ose të kërkojë marrjen në pyetje të dëshmitarëve kundër tij dhe të përfitojë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me ato të dëshmitarëve që dëshmojnë kundër tij”. Ndërkohë që shumica e masave mbrojtëse procedurale si përkufizim e kufizojnë në shkallë të ndryshme të drejtën themelore të mbrojtjes, për të shqyrtuar provat dhe/ose parimin që provat të shqyrtohen në gjyq dhe gjykimi të bëhet vetëm mbi bazën e provave të paraqitura dhe të administruara nga gjykata. Në këtë kontekst, duke pasur parasysh të drejtat dhe parimet e shprehura në nenin 6 paragrafi 3/d të

⁶ Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut.

Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka krijuar përgjatë tre dhjetëvjeçarëve të fundit një jurisprudencë të pasur, ku përcaktohen kufizimet e kësaj të drejte.

Instrumentet ligjore europiane, në raport me masat procedurale për mbrojtjen e dëshmitarit, synojnë të caktojnë kritere të përbashkëta për konceptimin dhe vënien në jetë të një pakete efektive masash ligjore dhe praktike, si dhe të programeve të asistencës për kategori të ndryshme dëshmitarësh, viktimash dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, duke ruajtur në të njëjtën kohë një baraspeshë të pranueshme ndërmjet masave mbrojtëse dhe të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të të gjitha palëve të përfshira (dëshmitarët, bashkëpunëtorët e drejtësisë, të pandehurve, viktimat). Në rastin e bashkëpunëtorëve të drejtësisë të ruajë edhe integritetin e sistemit të drejtësisë penale dhe sigurinë publike. Përveç kësaj, natyrshëm një pjesë e rregulloreve europiane, por edhe ndërkombëtare i dedikohet një bashkëpunimi ndërkombëtar më të ngushtë dhe më efektiv ndërmjet autoriteteve të drejtësisë penale në këtë fushë.

A është e mundur pra, të flitet sot për standarde europiane vërtet gjithëpërfshirëse në fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve? Jo plotësisht. Sot nuk ka asnjë instrument european detyrues⁷ që do të trajtonte në mënyrë specifike dhe të gjithanshme çështjen e mbrojtjes së dëshmitarit.

Sidoqoftë një numër tekstesh ligjore detyruese që trajtojnë problemin e krimit të organizuar, korrupsionit, pastrimit të parave, terrorizmit, trafikimit të qenieve njerëzore dhe ndihmës së ndërsjellë ndërkombëtare, të miratuar nga Këshilli i Europës dhe Bashkimi European, tërthorazi kanë rëndësi edhe për mbrojtjen e dëshmitarit dhe mund të lehtësojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në këtë fushë. Për më tepër, ashtu siç u përmend edhe më parë, ka një jurisprudencë domethënëse të Gjykatës Europiane të të Drejtave

⁷ “Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Rruga për në Gjykatën e Strasburgut”, Qendra Europiane, Tiranë 2003.

të Njeriut, në lidhje me nenin 6 paragrafi 3/d të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, e cila është *de facto* detyruese për të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Europës. Në mungesë të një traktati gjithëpërfshirës detyrues europian ose ndërkombëtar për mbrojtjen e dëshmitarit, kjo temë është trajtuar nga një sërë instrumentesh jo detyruese të quajtura ndryshe rekomandime që bëjnë pjesë në legjislacionin dytësor.

Në dy dhjetëvjeçarët e fundit janë miratuar disa rekomandime të rëndësishme të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës që trajtojnë specifikisht çështjen e mbrojtjes dhe të pozitës së dëshmitarit, viktimës dhe bashkëpunëtorit të drejtësisë në procesin penal, si dhe të drejtat korresponduese të mbrojtjes. Rekomandimet si instrumente ligjore nuk janë të detyrueshme për shtetet anëtare; ato përfaqësojnë një pozicion të përbashkët të shteteve anëtare të Këshillit të Europës për çështje juridike shqetësuese, me qëllim përshtatjen e vazhdueshme të sistemeve të drejtësisë penale dhe, si të tilla, kanë një autoritet domethënës dhe përbëjnë udhëzime të vlefshme për ligjvënësit dhe aktorët e drejtësisë penale dhe ekspertët. Këshilli i Europës ka miratuar një sërë rezolutash që janë po instrumente ligjore jo të detyrueshme për problemet e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë për ndjekjen e veprave penale të krimit të organizuar. Së fundi, Europoli dhe rrjeti i tij i ekspertëve mbi mbrojtjen e dëshmitarit ka zhvilluar vitet e fundit dhe ka rënë dakord për “Parimet bazë të bashkëpunimit të policive të vendeve të Bashkimit Europian në fushën e mbrojtjes së dëshmitarit”, si dhe mbi “Kriteret e përbashkëta të futjes së dëshmitarit në programin e mbrojtjes”, duke synuar lehtësimin e bashkëpunimit policor në fushën e mbrojtjes së dëshmitarit në Europë.

Në të drejtën ndërkombëtare, mbrojtjes së dëshmitarëve duket se i jepet një status më i lartë se në të drejtën europiane⁸. Si pikë reference për të

⁸ Standardet e BE-së në mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, 2005, G. Vermuelen, Maklu, Anwerp-Apeldoorn, 50-64.

drejtën ndërkombëtare për mbrojtjen e dëshmitarëve, Gjykata Ndërkombëtare Penale e Jugosllavisë ka qenë një burim jetëdhënës në fushën e së drejtës penale dhe të së drejtës procedurale penale. Në të drejtën ndërkombëtare nuk ka asnjë përkufizim se ç'është "dëshmitari". Megjithatë, kjo mund të dalë nga traktatet dhe rastet që palët, të cilat japin dëshmi në çështjet penale, përgjithësisht u nënshtrohen disa rregullave dhe udhëzimeve. Këto palë përfshijnë atë që ne përgjithësisht kuptojmë sipas të drejtës sonë kombëtare si dëshmitarë, veçanërisht viktimat, të cilët dalin si dëshmitarë, në çështjet penale dhe kategoritë e tjera më të rrezikuara, përfshirë fëmijët dhe ata me probleme mendore. Gjithashtu, nuk ekziston një përkufizim në të drejtën ndërkombëtare për nivelin e masave mbrojtëse që duhet të gëzojë një dëshmitar në çështjet penale. Masat për mbrojtjen e dëshmitarit janë të parashikuara nga Statuti i Gjykatës Penale Ndërkombëtare.

Edhe Republika e Shqipërisë i ka kushtuar një vëmendje të madhe mbrojtjes së dëshmitarëve. Kështu, është miratuar ligji nr.9205, datë 15.3.2004 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, duke përcaktuar mekanizmat ligjorë e institucionale për mbrojtjen e dëshmitarëve.

1. DËSHMITARËT

1.1 Koncepti i dëshmitarit

Kodi i Procedurës Penale përcakton se kush është dëshmitar, kush nuk mund të jetë dëshmitar, të drejtat dhe detyrimet e dëshmitarit, trajtimin e dëshmitarëve nga autoritetet që kryejnë procedimin, mënyrën e marrjes në pyetje, vendin, vlerësimin e aftësisë së dëshmitarit për të dhënë dëshmi, mjetet për regjistrimin e dëshmisë, si dhe pasojat e shkeljes së dispozitave të mësipërme.

Për qëllimet e këtij studimi, si dhe duke përmbledhur të gjitha normat kombëtare dhe ndërkombëtare që përkufizojnë konceptin për dëshmitarin, dëshmitarin do ta përkufizojmë si një person fizik, gjithmonë jo i pandehuri,

që ka njohuri për faktet që do të verifikohen dhe që kanë lidhje me krimin, autorin e krimit ose me rrethana ose fakte të tjera që autoritetet synojnë t'i identifikojnë. Dëshmia e një dëshmitari është një deklaratë e bërë nga një person, i cili nuk është subjekt i një procedimi penal. Dëshmia i jepet organit që kryen ndjekjen penale dhe që do ta përdorë atë për të verifikuar faktet mbi bazën e të cilave do të merret vendimi.

1.2 Koncepti i palës së dëmtuar

Për të përcaktuar viktimën⁹ e një krimi, Kodi i Procedurës Penale përdor termin “palë e dëmtuar”. Pala e dëmtuar ose e lënduar shihet si subjekt që ka disa të drejta, të cilat rrjedhin nga fakti që ai ose ajo është viktimë e krimit. Duke qenë njëkohësisht dëshmitar i krimit, ai ka edhe disa detyrime që rrjedhin nga ky rol në procedimin penal. Pala e dëmtuar është një person fizik të drejtat pasurore ose vetjake të të cilit janë vënë në rrezik ose janë shkelur nga vepra penale. Pozita e palës së dëmtuar në ndjekjen penale është specifike dhe presupozon të drejta dhe detyrime në procesin penal¹⁰.

Pala e dëmtuar është kryesisht një person fizik. Ajo është pjesë e rëndësishme e ndjekjes penale, sepse është shpesh i vetmi individ, me përjashtim të të akuzuarit, që ka qenë i pranishëm kur është kryer krimi. Për këtë arsye pala e dëmtuar, në rolin e dëshmitarit përbën një burim të rëndësishëm informacioni. Pala e dëmtuar është, gjithashtu, personi që ka njohuri për kryerjen e krimit dhe që ka për detyrë të informojë autoritetet e zbatimit të ligjit, pra oficerët e policisë gjyqësore ose prokurorinë, duke bërë denoncimin dhe duke u bërë kështu shkas për nisjen e të gjithë procedimit. Megjithatë, pala e dëmtuar është e ekspozuar ndaj mundësisë për t'u bërë

⁹Termi *viktimë* përdoret në viktimologji dhe kriminologji, V. Hysi “Kriminologjia”, Tiranë, 2005.

¹⁰ Van Dijk “Caring for Crime Victims” Criminal Justice Press, Mensey, New York, 1999, p6.

objekt i kërcënimit nga kriminelë që synojnë të shmangin ndjekjen penale ose të parandalojnë fillimin e saj. Ekzistojnë dy raste të procedimit penal. Së pari, për vepra të krimeve të rënda, nisma për fillimin e ndjekjes penale është e prokurorit. Ndërsa për vepra të tjera të përcaktuara në KPP nisma për fillimin e procedimit penal është e palës së dëmtuar.

Në përputhje me rolet që luan në procedimin penal, viktimat mund të përkufizohet se gëzojnë drejtat të parashikuara me ligj, kontribuon aktivisht në çështjen kundër të akuzuarit, merr pjesë në procedim si dëshmitar, paraqet pretendim pasuror – ka të drejtë për kompensimin e dëmit, në rastet e parashikuara nga KPP pala e dëmtuar mund të nisë procedimin penal.

1.3 Kategoritë e dëshmitarëve

Personat e thirrur si dëshmitarë janë ata që mund të japin informacion për krimin, autorin e krimin dhe rrethanat të tjera të rëndësishme.

Në bazë të raportit midis dëshmitarit dhe autorit të veprës penale, raportit të dëshmitarit me krimin, mënyrës se si dëshmitari ka marrë dijeni për faktet, për karakteristikat vetjake të dëshmitarit, si dhe për një sërë elementesh të tjera, dëshmitarët ndahen në disa kategori.

Në bazë të informacionit vetjak dëshmitarët ndahen në dy grupe:

1. Dëshmitarë që kanë marrë informacion për fakte të rëndësishme nëpërmjet një ose dy shqisave fizike;
2. Dëshmitarë, të cilët kanë marrë informacion për fakte të rëndësishme nga persona të tjerë.

Dëshmitarët e dëshmitarëve që i përkasin grupit të parë është më e besueshme. Në disa raste të drejtat procedurale përjashtojnë mundësinë e përdorimit të dëshmitarëve që i përkasin grupit të dytë. E drejta procedurale penale përgjithësisht bazohet në qëndrimin e justifikuar që këta dëshmitarë nuk duhen refuzuar *a priori*, sepse ata mund të çojnë në identifikimin e personave që kanë informacion duke qenë dëshmitarë okularë.

Një dëshmitar i kërcënuar është një dëshmitar që, në qoftë se jep dëshmi

– ose edhe sikur t’u përgjigjet pyetjeve të caktuara – mund të ekspozojë veten e tij ose një person të afërt ndaj një kërcënimi serioz për jetën, shëndetin, integritetin fizik, lirinë ose pronën.

Një bashkëpunëtor i drejtësisë është një dëshmitar që ka qenë anëtar i një organizate kriminale dhe të cilit i është dhënë ky status me vendim të posaçëm të një gjykatë ose prokurori¹¹. Kjo është metoda klasike e njohur nga shumë sisteme ligjore si mjet për të luftuar krimin e organizuar¹².

Një hetues i infiltruar është përgjithësisht një oficer policie, i cili, duke vepruar me një vendim të posaçëm, ndërmerr një operacion të fshehtë për të grumbulluar të dhëna për ndjekjen penale. Një informator konfidencial është një anëtar i publikut që merr pjesë në hetim mbi bazën e një urdhri gjykatë, e cila për arsye praktike e lejon të luajë atë rol.

Një dëshmitar ekspert është një person, njohuritë e specializuara të të cilit ndihmojnë gjykatën të zgjidhë një çështje të rëndësishme në procedimin penal. Dëshmitari ekspert e ndihmon gjykatën, duke bërë deklaratatë të specializuara, përfundime dhe opinione. Një përkthyes është një person që ndihmon gjykatën të komunikojë me dëshmitarët dhe të pandehurin. Këta specialistë mund të jenë, gjithashtu, të rrezikuar për shkak të rolit të tyre në procedimin penal. Për këtë arsye ata duhet të mbrohen nëpërmjet masave të posaçme në përputhje me shkallën e kërcënimit ndaj tyre.

Të gjitha këto kategori dëshmitarësh mund të jenë dëshmitarë nën mbrojtje. Dëshmitari nën mbrojtje është një person i cili i përket një prej kategorive të mësipërme dhe të cilit i është dhënë mbrojtje sipas dispozitave ligjore. Mbrojtja e dëshmitarit rregullohet me ligj dhe përfshin: Mbrojtje bazë përpara gjyqit, teknika të veçanta të marrjes në pyetje dhe mënyrat e pjesëmarrjes së dëshmitarit në procedim.

¹¹ Elezi, I., Kacupi, S., Haxhia, M. “Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë”, GEER, Tiranë, 2006

¹² Italianët i quajnë *pentiti* dhe i kanë përdorur për të luftuar mafian.

2. FORMAT E NDRYSHME TË MBROJTJES SË DËSHMITARIT

2.1 *Koncepti i mbrojtjes së dëshmitarit*

Në procedurën penale bashkëkohore¹³, dëshmitari pavarësisht se cilës kategori i përket ka nevojë të mbrohet, pasi dëshmitari, me gjithë teknologjinë e përparuar, ende përfaqëson një burim të pazëvendësueshëm të informacionit në procesin penal dhe shpesh është e vetmja “mbështetje” e prokurorit, që nga momenti i kryerjes së krimit, deri në çastin kur gjykata merr vendimin.

Kategori të caktuara personash, për shkak të vetë natyrës së krimit, kanë nevojë për një shkallë më të lartë mbrojtjeje dhe trajtim të diferencuar nga prokurorët e çështjes. Në legjislacionin penal disa masa mbrojtëse për dëshmitarët dhe viktimat-dëshmitarë njihen si masa të përgjithshme të disiplinës procedurale, si: arresti ose masa të posaçme për marrjen në pyetje të dëshmitarëve siç janë fëmijët, viktimat e përdhunimit, persona me paaftësi në komunikim ose persona të tjerë të ngjashëm, ndërkohë që të tjera masa ofrojnë drejtpërdrejt mbrojtje për ata që janë të përfshirë ose jo në procesin penal në programin për mbrojtjen e dëshmitarit.

Kështu, të gjithë hapat e sipërpërmendur për të garantuar mbrojtjen e dëshmitarit, mund të kenë tri forma bazë:

1. Mbrojtje policore bazë për dëshmitarin dhe viktimën.
2. Masat procedurale për mbrojtjen e dëshmitarit.
3. Mbrojtje e posaçme për dëshmitarin me anë të një programi të mbrojtjes së dëshmitarit.

2.2 *Mbrojtja policore bazë për dëshmitarin dhe viktimën*

Detyra e policisë së çdo shteti është të mbrojë shtetasit nga sulmet e të

¹³ Rekomandimi i Këshillit të Europës nr.97(13) për frikësimin e dëshmitarit dhe të drejtat e mbrojtjes, si dhe Rekomandimi i miratuar kohët e fundit Rec(2005)9 përmbajnë përkufizimet e dëshmitarit, bashkëpunëtorit të drejtësisë, frikësimin, anonimitetin, si dhe personave të afërt të dëshmitarit dhe të bashkëpunëtorit të drejtësisë.

gjitha natyrave, si dhe të marrë masa për gjurmimin dhe zbulimin e krimeve dhe të gjejë autorët e këtyre krimeve. Ndër detyrat e policisë përfshihet edhe ajo për mbrojtjen bazë të dëshmitarit, që parashikohet në norma ligjore eksplicite ose në udhëzime ose procedura që rregullojnë mënyrat e veprimit me persona të caktuar, si dhe sjelljen e policisë në rrethana të caktuara. Përgjegjësitë e policisë për mbrojtjen e dëshmitarit mund të ndahen në kategoritë e mëposhtme:

- Identifikimi i problemit.
- Marrja e hapave të vendosur për të hetuar krimin në prizmin e problemit të identifikuar.
- Informimi i organeve të tjera për hapat e ndërmarra.

2.3 Masat procedurale të mbrojtjes së dëshmitarit.

Masat procedurale për mbrojtjen e dëshmitarit, që zbatohen gjatë procesit gjyqësor mund të ndahen si më poshtë:

1. Masat e përgjithshme të mbrojtjes së dëshmitarit.
2. Masat që lidhen me administrimin e gjyqit.
3. Masat e posaçme të mbrojtjes së dëshmitarit.

Masat e përgjithshme për mbrojtjen e dëshmitarit, që kanë për qëllim të reduktojnë rrezikun e ardhshëm për dëshmitarin, përfshijnë p.sh., masat e sigurisë dhe arrestin.

Masat procedurale për mbrojtjen e dëshmitarit janë të specializuara, sidomos për mbrojtjen e dëshmitarëve të caktuar “të prekshëm” dhe të rrezikuar. Për personat e rrezikuar, masat e parashikuara me ligj kanë si qëllim të parandalojnë zbulimin e identitetit dhe ato zbatohen përgjatë veprimtarisë së gjykatës dhe të autoritetit të prokurorisë, që fillojnë me njohjen e statusit të dëshmitarit të rrezikuar, si dhe vijnë me mundësinë e zbatimit të teknikave të posaçme, të marrjes në pyetje të dëshmitarit dhe masa të tjera të posaçme në ndihmë të dëshmitarit të rrezikuar, për të garantuar pjesëmarrjen e tij në procesin penal.

2.4 Programet e mbrojtjes së dëshmitarit

Programet e mbrojtjes së dëshmitarit mund të përkufizohen si programe që rregullohen nga ligji, me qëllim mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të viktimave në rastet e kërcënimeve serioze, të cilat nuk mund të trajtohen nga masa të tjera mbrojtëse dhe atje ku dëshmia e këtyre dëshmitarëve është e një rëndësie të veçantë për procesin penal. Një prej kushteve bazë për përfshirjen në program është që dëshmitari të hyjë vullnetarisht. Ndërsa për interesat e shtetit kushti bazë është rëndësia e dëshmisë së dëshmitarit si provë në procesin penal.

3. STANDARDET EUROPIANE DHE NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E MBROJTJES SË DËSHMITARËVE

3.1 Instrumentet ligjore europiane

Konventa Penale Kundër Korrupsionit (ETS Nr. 173, 27 Janar 2001).

Konventa Penale Kundër Korrupsionit e Këshillit të Europës¹⁴ është relativisht e kufizuar në veprimet ose mosveprimet që mund të cilësohen si vepra penale dhe që shtetet palë duhet t'i përfshijnë, në rastin e shtetit tonë në Kodin Penal, duke parashikuar dënime përkatëse, në përputhje me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore. Ajo përmban dispozita që kriminalizojnë një listë të veçantë të formave të korrupsionit dhe së bashku të çështjeve të sektorit publik dhe privat. Konventa Penale Kundër Korrupsionit synon të kontrollojë korrupsionin, duke përcaktuar veprat penale me ndëshkimet përkatëse.

Në nenin 22 të saj me titull “Mbrojtja e bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe e dëshmitarëve” kërkon nga çdo shtet palë që të miratojë masa që do të ofrojnë mbrojtje efektive dhe të përshtatshme për personat që do të kallëzojnë marrjen e ryshfetit dhe vepra të tjera penale që lidhen me korrupsionin, të përfshira në Konventë ose që bashkëpunojnë në forma të tjera me autoritetet

¹⁴ “E Drejta Civile për Korrupsionin dhe Çështje të Përafrimit të Legjislacionit”, 2006, R. Balla, bot. “E drejta Parlamentare dhe Politikë Ligjore”.

e hetimit dhe të ndjekjes penale, sikurse edhe për dëshmitarët që dëshmojnë kundër këtyre veprave penale.

Protokolli i dytë shtesë i Konventës Europiane për Ndihmë të Ndërsjellë në Fushën Penale (Ets Nr. 182, 8 nëntor 2001).

Nenet 9 dhe 10 të këtij Protokolli rregullojnë zbatimin e masave procedurale mbrojtëse në lidhje me paraqitjen e dëshmisë jashtë kufijve, nëpërmjet videokonferencës ose telefonkonferencës; neni 23 ofron një bazë ligjore për bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e masave mbrojtëse joprocedurale dhe programeve për mbrojtjen e dëshmitarit.

Konventa për Parandalimin e Terrorizmit e Këshillit të Europës e hapur për nënshkrim në Varshavë, më 16.5.2005

Qëllimi i hartimit të kësaj Konvente është zgjerimi i përpjekjeve të të gjitha shteteve palë në parandalimin e terrorizmit dhe të efekteve të tij, duke përcaktuar masa që duhet të merren në nivel kombëtar dhe nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar, duke pasur parasysh, zbatimin e marrëveshjeve ose traktateve dypalëshe ose shumëpalëshe midis palëve.

Neni 13 i Konventës kërkon që shtetet pjesëmarrëse në të, të marrin masa të brendshme legjislative, për të siguruar mbrojtjen, kompensimin dhe ndihmën e viktimave të terrorizmit dhe të familjeve të tyre.

Konventa për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore e Këshillit të Europës e hapur për nënshkrim në Varshavë, më 16.05.2005

Neni 15 i Konventës parashikon të drejtën e kompensimit dhe ndihmën ligjore falas për viktimat e trafikut të qenieve njerëzore. Konventa përcakton detyrimin që shtetet, të cilat do ta ratifikojnë atë, të marrin masat e përshtatshme ligjore që të parashikojnë në legjislacionin e brendshëm të drejtën për mbrojtjen ligjore falas për viktimat e trafikut, si dhe të drejtën për kompensimin e këtyre viktimave. Gjithashtu, paragrafi i 4-t i Konventës kërkon që shtetet të garantojnë kompensimin e viktimave të trafikut, duke ngritur një fond për kompensimin e viktimave, duke zbatuar programe sociale dhe asistencë me qëllim riintegrimin e viktimave në shoqëri.

Në nenin 28 të Konventës parashikohet që shtetet të cilat do të ratifikojnë Konventën duhet të parashikojnë në legjislacionin e tyre mbrojtjen e viktimeve të trafikut e të familjarëve të tyre, dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve me organet gjyqësore nga autorët e veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore.

Neni 30 i Konventës kërkon shprehimisht që shtetet palë të saj të rregullojnë në bazë të legjislacionit të brendshëm garantimin e mbrojtjes të jetës private të viktimeve, identitetin, si dhe sigurinë e tyre gjatë procesit gjyqësor.

INSTRUMENTET JODETYRUESE

Këshilli i Europës ka nxjerrë disa rekomandime që lidhen me mbrojtjen e dëshmitarëve, por asnjëri prej tyre nuk ka fuqi ligjore detyruese. Ato thjesht nxisin shtetet të orientojnë masat e tyre ligjore dhe institucionale, duke ndjekur parimet e përcaktuara në këto rekomandime. Këto rekomandime janë:

Rekomandimi nr. Rec (85) 11 për pozitën e viktimës në kuadrin e së drejtës penale dhe të procedurës penale (28 qershor 1985)

Rekomandimi nr. Rec. (85) 4 për dhunën në familje

Rekomandimi nr. Rec. (87) 21 për ndihmën ndaj viktimës dhe parandalimin e viktimizimit (17 shtator 1997)

Rekomandimi nr. Rec. (97) 13 që i referohet frikësimit të dëshmitarit dhe të drejtave të mbrojtjes (10 shtator 1997)

Rekomandimi nr. Rec (2001) 11 që i referohet parimeve udhërrëfyese në luftën kundër krimit të organizuar (19 shtator 2001)

Rekomandimi nr. Rec (2005) 9 për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë (20 prill 2005).

3.2 *Jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut*

Gjykata e ka konfirmuar në një sërë vendimesh¹⁵ qëndrimin e saj, se

¹⁵ Bianku, L. "Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut, botim i Qendrës Europiane, Këshillit të Europës dhe Komisionit Europian, Tiranë, 2005

garancia e parashikuar në nenin 6 paragrafi 3/d të Konventës nuk është absolute dhe ka gdhendur një numër përjashtimesh nga rregulli i përgjithshëm se “... të gjitha provat duhet të administrohen në gjyq, në praninë e të akuzuarit, në respekt të argumentit kundërvënës”.

Këto përjashtime mund të klasifikohen në katër kategori të ndryshme :

1. Dëshmitarët e munguar

Sipas jurisprudencës së Gjykatës në çështjet *Unterpernting*, *Windich*, *Delta*, *Saidi*, *Rachdad*, thëniet e dëshmitarit, i cili ka lëshuar një deklaratë paraprake para autoriteteve policore ose të prokurorisë në fazën e hetimeve, por më pas, nuk mund të përcaktohet vendndodhja e tij, ka vdekur ose nuk mund të paraqitet në gjykatë për motive të ligjshme, mund të përdoren si provë vetëm atëherë kur mbrojtja e të pandehurit ka pasur mundësinë të pyesë dëshmitarin në një fazë më të hershme dhe autoritetet nuk mund të fajësohen për mungesën e dëshmitarit.

2. Dëshmitarët e çmuar

Kjo kategori përfshin agjentët e infiltruar ose nën mbulim dhe informatorët, për të cilët ekziston një interes publik për të mos zbuluar identitetin e tyre, për shkak se kjo mund të kompromentonte angazhimin e tyre të mëtejshëm. Gjykata e ka pranuar këtë shqetësim deri në njëfarë mase. Ajo ka lejuar të merren masa të ndryshme mbrojtëse që do të pengonin zbulimin e identitetit të plotë të agjentit tek i akuzuari dhe publiku, nëse i akuzuari e njeh agjentin nën identitetin e tij të rremë dhe e ka takuar atë (çështja *Ludi*), ndërsa e ka refuzuar anonimitetin e plotë të një agjenti të fshehtë, në një sektor vëzhgimesh të fshehta, të cilin i akuzuari nuk e kishte takuar kurrë (çështja *Van Mechelen*). Për pasojë, sipas jurisprudencës aktuale të Gjykatës, agjentët e infiltruar, informatorët dhe persona të tjerë që zbatojnë masa të posaçme hetimore nuk mund të gëzojnë anonimitet të plotë, mbi bazën e interesit publik për të mos zbuluar identitetin e tyre për qëllime operationale; anonimiteti i plotë mund të njihet vetëm kur dëshmitari përfshihet në kategorinë e dëshmitarëve të frikësuar.

3. Dëshmitarët e prekshëm

Gjykata e ka pranuar në një numër vendimesh (çështjet *Baegen, P.S.*, *N.*, *Finkensier, S.*, *Hols, M.K.*) se interesi i dëshmitarëve të prekshëm, zakonisht viktimë të dhunës familjare, të krimeve me natyrë seksuale ose fëmijë, të cilëve ballafaqimi me të akuzuarin ose dhënia e dëshmisë në një gjyq publik do t'i traumatizonte përsëri seriozisht, i legjitimon masat mbrojtëse. Jurisprudenca e Gjykatës tregon, gjithashtu, se si pavarësisht masave mbrojtëse të drejtat e mbrojtjes së të pandehurit mund të garantohen: duke regjistruar me aparate xhirimi, marrjen e parë në pyetje, duke i dhënë mbrojtjes videon, duke e lejuar mbrojtjen që të paraqesë pyetje me shkrim për dëshmitarin, duke vijuar përsëri me marrjen në pyetje, duke përdorur aparate xhirimi.

4. Dëshmitarët e frikësuar dhe anonimiteti

Neni 6 i Konventës nuk kërkon shprehimisht që interesat e dëshmitarëve në përgjithësi dhe në veçanti ato të viktimave që thirren për të dëshmuar, duhet të merren në konsideratë. Sidoqoftë, jeta, siguria ose liria e personit mund të rrezikohet, ashtu si mund të preken edhe interesat që rregullohen në nenin 8 të Konventës. Këto interesa të dëshmitarëve dhe të viktimave mbrohen parimisht nga nene të tjera të Konventës dhe kjo nënkupton që shtetet palë duhet t'i organizojnë procedurat e tyre penale në një formë të tillë, që interesat e këtyre personave të mos vihen në rrezik, në mënyrë të papërligjur.

Nga jurisprudenca e Gjykatës¹⁶ rezulton se përdorimi i deklaratave të bëra nga dëshmitarë anonimë nuk është në çdo rrethanë i papajtueshëm me nenin 6 paragrafi 3/d, nëse respektohen një varg kushtesh. Një përmbledhje të shkurtër të standardeve që dalin nga jurisprudenca e Gjykatës mbi këtë temë (çështjet *Kostovski*, *Doorson*, *Van Mechelen*, *Visser*, *Birutis*), po e japim më poshtë:

¹⁶ Përfundimet janë nxjerrë nga shqyrtimi i një sërë vendimesh të Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut.

· Njohja e anonimitetit duhet të jetë një masë përjashtimore, që mund të merret vetëm: kur jeta dhe liria e personit të përfshirë ose e personave të afërt me të është seriozisht e rrezikuar; provat konsiderohen të jenë domethënëse dhe dëshmitari konsiderohet i besueshëm.

· Shteti duhet të përcaktojë, të paktën në fazën që pason hetimin policor, një procedure të veçantë gjyqësore që do të lejojë si verifikimin e kushteve të domosdoshme për njohjen e anonimitetit, ashtu edhe kompromisin e defekteve që anonimiteti krijon, duke minimizuar kështu rreziqet e përdorimit të tij.

· Identiteti i dëshmitarit duhet t'i bëhet i njohur autoritetit gjyqësor që vendos për dhënien e anonimitetit.

Në lidhje me agjentët e infiltruar dhe informatorët, anonimiteti i plotë nuk mund të akordohet vetëm për qëllime operacionale, nëse elemente të frikësimit nuk shfaqen.

Përveç sa u tha më sipër, nuk është vetëm procedura e dhënies së anonimitetit që duhet trajtuar me kujdes, por edhe vetë pyetja e dëshmitarit anonim. Si përfundim, marrja në pyetje e dëshmitarit anonim gjatë procesit, krijon mundësi të shumta për shkeljen e nenit 6, sepse Gjykata është në të njëjtën kohë përgjegjëse për të mos i lejuar pyetjet e bëra nga pala mbrojtëse që mund të zbulojnë identitetin e dëshmitarit. Kushti i fundit, i cili është konfirmuar në mënyrë të përsëritur nga Gjykata (edhe pse nuk është shpjeguar asnjëherë në detaje), është fakti që dënimi nuk duhet të mbështetet vetëm ose në një shkallë përcaktuese në provat e paraqitura nga dëshmitarët anonimë.

3.3 Gjykatat ndërkombëtare

Në tre drejtën ndërkombëtare mbrojtja procedurale dhe joprocedurale trajtohen në mënyrë të ngjashme si në Statutet e Gjykatës Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë, Gjykatës Ndërkombëtare Penale e Ruandës¹⁷

¹⁷ Kjo gjykatë u krijua me rezolutën 955 të nëntorit 1994, si pasojë e shkeljeve të rënda të së drejtës humanitare që janë bërë në Ruandë.

dhe Gjykatës Ndërkombëtare Penale¹⁸. Statuti i GJNP-së reflekton vendimet e Kartës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Ato kanë ngjashmëri të mëdha dhe të gjitha sigurojnë krijimin e Njësisë së Mbështetjes së Dëshmitarit dhe të Viktimës, e cila merret specifikisht me mbrojtjen e dëshmitarit.

4. LEGJISLACIONI I SHQIPTAR

Në Republikën e Shqipërisë sistemi i mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë garanton mbrojtjen e tyre në mënyrë të shkallëzuar nëpërmjet mbrojtjes procedurale dhe joprocedurale e cila realizohet nga Programi për Mbrojtjen e Dëshmitarit dhe të bashkëpunëtorit të Drejtësisë. Republika e Shqipërisë ka nënshkruar, ratifikuar ose aderuar në një numër të madh të Konventave Ndërkombëtare në kuadër të Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Europës dhe organizatave të tjera ndërkombëtare në fusha të ndryshme të bashkëpunimit, me qëllim goditjen e krimit të organizuar, mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut dhe viktimave të veprave kriminale. Republika e Shqipërisë pas nënshkrimit të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave Themelore të Njeriut, duke u bërë kështu një anëtare e Këshillit të Europës, ka përfshirë në sistemin e saj ligjor rekomandime dhe vendime të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Instrumentet ligjore në fushën e mbrojtjes së dëshmitarit dhe bashkëpunëtorit të drejtësisë janë:

4.1 Kushtetuta;

Në Kushtetutë janë sanksionuar garancitë për respektimin e parimeve bazë në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, parashikuar nga nenet 25 e në vijim. Ajo, gjithashtu, garanton përmbushjen e detyrimit ligjor, që një

¹⁸ Juridiksioni dhe funksionimi i kësaj Gjykatë rregullohen nga Statusi i Romës ratifikuar me ligj nr. 8984, datë 23.12.2002 “Për ratifikimin e Statutit të Romës për Gjykatën Ndërkombëtare Penale”.

dëshmitar ka për të dhënë dëshmi para gjykatës, në një proces penal, të balancuar me të drejtat e tij, për të mos pasur frikë për jetën e tij, në rastet kur përmbush këtë detyrim, duke parashikuar se jeta e personit mbrohet me ligj, nga neni 21; e drejta e pronës është e garantuar nga neni 41; askush nuk mund të detyrohet të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij, - neni 35/1. Në fushën e mbrojtjes së dëshmitarit dhe bashkëpunëtorit të drejtësisë, dispozitat për një gjykim të drejtë janë të përfshira si një parim i përgjithshëm, por edhe me veprime të përcaktuara që duhen kryer në kuadër të procesit penal. Sipas nenet 42/2 “Kushdo ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”. Njëkohësisht në nenet 31, 32, 33 parashikohen të drejtat e të pandehurit për gjatë procesit penal. Kushtetuta parashikon se çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik.

4.2 Kodi i Procedurës Penale

Ky Kod është ligji bazë që rregullon ndjekjen penale në Republikën e Shqipërisë dhe që përmban masat procedurale për mbrojtjen e dëshmitarit dhe bashkëpunëtorit të drejtësisë siç janë: masat e sigurimit vetjak; masat e përgjithshme; masat për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të Drejtësisë; shqyrtimi i kategorive të prekshme të dëshmitarëve.

- Masat e sigurimit vetjak ndahen në masa shtrënguese dhe masa ndaluese. Këto masa sigurimi vetjak kanë karakter shtrëngues dhe ndalues ndaj personave mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova për kryerjen e një vepre penale. Këto masa vendosen kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen e vërtetësisë së provës; kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet ose kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj, për të cilin procedohet (neni 228/3 i KPP).

Masat shtrënguese janë: ndalimi i daljes jashtë shtetit; detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore; ndalimi dhe detyrimi për qëndrim në një vend të caktuar; garancia pasurore; arresti në shtëpi; arresti në burg; shtrimi i përkohshëm në spitalin psikiatrik (neni 232 i KPP).

Masat ndaluese janë: pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik; ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste (neni 240 i KPP).

- Me masa të përgjithshme do të kuptojmë masat dhe veprimet që u referohen palëve, të cilat nuk përshkruhen në Kod por në rregullore dhe udhëzues të tjerë. Këto masa janë pranimi dhe lejimi i dëshmitarit në ndërtesën e gjykatës pas verifikimit të sigurisë; vendosja e tyre në mjedise të veçanta për dëshmitarët; ndalimi për të përdorur mjetet e komunikimit.

Njëkohësisht kemi edhe masat e përgjithshme për drejtimin e procesit penal që përshkruhen në Kod dhe lidhen me detyrimin e gjyqtarit për të ruajtur qetësinë; për të respektuar dinjitetin dhe sigurinë e personave të pranishëm; për të përjashtuar publikun dhe palët nga seanca; nenet 103, 104, 279, 339, 340, 341, 344 të KPP).

MASAT PROCEDURALE PËR MBROJTJEN E DËSHMITARIT DHE BASHKËPUNËTORIT TË DREJTËSISË

Dëshmitari është i detyruar të paraqitet në gjykatë t'u përmbahet urdhrave të saj dhe t'u përgjigjet me vërtetësi pyetjeve që i bëhen. Dëshmitari nuk mund të detyrohet të dëshmojë për fakte për të cilat mund të lindte përgjegjësia penale për të (neni 157 i KPP). Përjashtohen nga detyrimi për të dëshmuar personat si më poshtë: Gjinia ose krushqia e afërt e të pandehurit; bashkëshorti; bashkëshorti i ndarë; bashkëjetuesi; personi i lidhur me marrëdhënie birësimi me të pandehurin (neni 158 KPP). Në raste kur për shkak të dhënies së dëshmisë ose të përgjigjes për ndonjë pyetje të caktuar dëshmitari ose një person i afërt me të mund t'i kërcënohet ndonjë rrezik për jetën, shëndetin, integritetin fizik ose lirisë së pronës (dëshmitari i rrezikuar),

dëshmitari ka të drejtë të refuzojë zbulimin e identitetit të tij, të refuzojë përgjigjet për ndonjë pyetje të caktuar ose të refuzojë të dëshmojë, derisa të jetë garantuar masa mbrojtëse. Në dispozitat e KPP rregullohet në mënyrë të posaçme mbrojtja e dëshmitarit dhe bashkëpunëtorit të drejtësisë nëpërmjet një mënyre të veçantë të marrjes në pyetje, të cilat parashikojnë anonimitet të plotë ose të pjesshëm të dëshmitarit.

Personi nën hetim ose i pandehuri që akuzohet për një krim të rëndë të kryer në bashkëpunim, kur bashkëpunon me prokurorin dhe gjykatën, duhet të japë informacion të plotë dhe pa asnjë rezervë ose kusht, për të gjitha aktet, ngjarjet dhe rrethanat që shërbejnë si prova vendimtare për zbulimin, hetimin, gjykimin dhe parandalimin e krimeve të rënda dhe riparimin e dëmeve të shkaktuara. Kushtet e bashkëpunimit caktohen në marrëveshjen e mbrojtjes të hartuar sipas dispozitave të posaçme ligjore për mbrojtjen e dëshmitarit dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë. Kur marrëveshja e bashkëpunimit realizohet gjatë gjykimin, gjykata që shqyrton çështjen vendos uljen e masës së dënimit ose përjashtimin nga dënimi, sipas nenit 28 të Kodit Penal, kur bashkëpunimi realizohet gjatë ekzekutimit, të vendimit të dënimit, bashkëpunëtori i drejtësisë mund të kërkojë nga gjykata që e ka dënuar ose nga ajo e vendit të ekzekutimit, ndryshimin e dënimit të dhënë. Marrëveshja e bashkëpunimit mund të revokohet, kur bashkëpunëtori i drejtësisë shkel kushtet e përcaktuara ose bën dëshmi të rreme (neni 37/a i KPP-së).

Pyetja e bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe e dëshmitarëve të mbrojtur zhvillohet në masa të veçanta për mbrojtjen e tyre, të cilat përcaktohen nga gjykata kryesisht ose me kërkesën e palëve. Në rastet kur disponon mjetet teknike, gjykata mund të vendosë që marrja në pyetje e tyre të zhvillohet në distancë me anë të lidhjes audiovizive, sipas rregullave të parashikuara në pikën 7 të nenit 361 të KPP. Në rastet kur ndaj personit që do të pyetet është vendosur ndryshimi i identitetit, gjykata urdhëron marrjen e masave të përshtatshme, për të bërë të mundur që fytyra dhe zëri i personit të mos jenë të dallueshme për palët neni (361/a i KPP).

Anonimiteti i pjesshëm ose mbrojtja bazë e identitetit përbën një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, sipas të cilit çdo dëshmitar është i detyruar të japë të dhëna rreth identitetit të tij në fillim të procesit para se t'i nënshtrohet marrjes në pyetje. Në këto raste dëshmitari do të merret në pyetje, duke përdorur një pseudonim, ndërkohë që të dhënat e sakta dihen vetëm nga gjykata. Anonimiteti i plotë realizohet me anë të fshehjes dhe maskimit tërësor të paraqitjes së dëshmitarit dhe përfshin edhe mbrojtjen bazë të identitetit. Gjithashtu, marrja në pyetje në këto raste kryhet duke përdorur aparatura teknike, të cilat ndryshojnë zërin dhe fytyrën e tij. Gjithashtu, i pandehuri në një procedim të lidhur i proceduar ose që vuan dënimin jashtë shtetit për një veprë tjetër penale, kur refuzohet ekstradimi i tij, mund të pyetet në distancë me anë të lidhjes audiovizive, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare, me kusht që shteti i huaj të garantojë pjesëmarrjen e mbrojtësit të të pandehurit në vendin ku kryhet marrja në pyetje (neni 167/a KPP).

MARRJA NË PYETJE E DËSHMITARËVE TË MITUR DHE E PERSONAVE NË PAMUNDËSI PËR T'U PARAQITUR NË GJYKATË.

Për të miturit duhet të bëhet kujdes i veçantë për të parandaluar efektet e dëmshme që marrja në pyetje mund të ketë mbi shëndetin mendor të të miturit. Pyetja e dëshmitarit të mitur mund të bëhet nga kryetari i trupit gjykues mbi kërkesat dhe kundërshtimet e palëve. Kryetari mund të ndihmohet nga një familjar i të miturit ose nga një specialist i fushës së edukimit të fëmijëve. Kur çmohet se pyetja e drejtpërdrejtë e të miturit nuk e dëmton gjendjen psikologjike të tij, kryetari urdhëron që pyetja të vazhdojë nga prokurori ose nga mbrojtësi a përfaqësuesi që ka kërkuar pyetjen si dhe më pas nga palët sipas radhës. Ky urdhër mund të revokohet neni 361/5 i KPP.

Në rast pamundësie absolute që dëshmitarët dhe ekspertët të paraqiten në gjykatë, me kërkesën e palëve, gjykata mund të vendosë që pyetja e tyre të bëhet në vendin ku ndodhet, duke njoftuar ditën, orën dhe vendin e pyetjes.

Pyetja mund të bëhet edhe nga një anëtar i trupit gjykues në prani të palëve. Pyetja bëhet në format e parashikuara në ligj pa praninë e publikut. I pandehuri dhe palët private përfaqësohen nga mbrojtësi dhe përfaqësuesit e tyre. Gjykata mund të lejojë ndërhyrjen e të pandehurit në pyetje (neni 364 i KPP).

4.3 Dispozita të Kodit Penal

Në fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, ka dispozita të veçanta në Kodin Penal që garantojnë ulje ose përjashtim nga dënimi për bashkëpunëtorët e drejtësisë dhe kallëzimin ose personin që ndihmon drejtësinë në procedimin penal të korrupsionit, si dhe dënimin e të gjitha formave të kërcënimit, presionit ose frikësimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ndaj dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, kështu ato janë: Format e veçanta të bashkëpunimit (neni 28/7 KP); përjashtimi nga vuajtja e dënimit (neni 245/2 i KP); ndihma në zbulimin e krimeve (neni 284/b i KP); vrasje në rrethana të cilësuar (neni 79/ç); Kanosja për të mos kallëzuar neni 311; Kanosja për deklarime a dëshmi, ekspertim ose përkthim të rremë neni 312/a; ndalimi i dhënies dhe i shpalljes së të dhënave në kundërshtim me ligjin, bëra publike edhe në organet e medias, në kundërshtim me ligjin e të dhënave me karakter të klasifikuar dhe konfidencial, që rrezikojnë jetën, integritetin fizik ose lirinë e personave të mbrojtur, sipas ligjit 9205, datë 15.3. 2004 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë” përbën vepër penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim. Kur kjo vepër kryhet nga një prej personave që kanë përgjegjësinë për të ruajtur karakterin e klasifikuar dhe konfidencial të të dhënave dënohet me gjobë ose burgim, kur ka sjellë si pasojë vdekjen (neni 313/b KP).

Kanosja (neni 84 i KP); kanosja për shkak të detyrës (neni 238 i KP); tregtimi i sekretit shtetëror nga personi që i është besuar (neni 294 i KP); tregtimi i sekretit shtetëror nga shtetasit (neni 295 KP); veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës (neni 301 i KP); përkrahja e autorit të krimit (neni 302 i KP); fshehja ose asgjësimi i kufomës (neni 303 i KP); dëshmia e rreme

(neni 306 i KP); refuzimi për të dëshmuar (neni 307); korrupsioni aktiv i dëshmitarit ekspertit ose përkthyesit (neni 312 i KP).

- **LIGJI NR 9205, DATË 15.03.2004 “PËR MBROJTJEN E DËSHMITARËVE DHE TË BASHKËPUNËTORËVE TË DREJTËSISË”**

Ky ligj rregullon afatet, masat e posaçme, mënyrën dhe procedurat e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, si dhe organizimin dhe funksionimin, kompetencat dhe marrëdhëniet ndërmjet organeve të ngarkuara me propozimin, vlerësimin, miratimin dhe zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes.

Ekzistojnë edhe një sërë ligjesh të tjera që rregullojnë fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve, por ky është ligji bazë.

5. MARRJA E PROVËS

Parimet e përgjithshme që duhen respektuar gjatë pyetjes së një dëshmitari.

Qëllimi i intervistës është të grumbullojë të dhëna të sakta dhe sa më shumë të jetë e mundur për një vepër penale. Këto parime janë:

1. Gjatë pyetjes dëshmitarët duhet të trajtohen me respekt, ata duhet të ndihen të lirshëm dhe jo nën ndonjë lloj presioni.

2. Dëshmitarit duhet t’i jepet një rol aktiv, jo pasiv, në dhënien e përgjigjeve.

3. Duhet të shmangen sugjerimet dhe dhënia e udhëzimeve të tepërta dëshmitarit.

4. Intervistuesi duhet t’i përshtatet dëshmitarit.

5.1 Marrja e dëshmisë së dëshmitarëve të rrezikuar dhe të frikësuar¹⁹

¹⁹ “Marrja e dëshmisë më të mirë në procedimin penal” - udhëzim për dëshmitarët e rrezikuar dhe të frikësuar, Home Office 2002.

Mbështetja për dëshmitarin përfshin praninë në intervistë të një personi tek i cili ka besim, ndihmë për të shkuar në gjykatë etj. E rëndësishme është të identifikohet sa më shpejt që të jetë e mundur në procedimin penal nëse një dëshmitar përfshihet në kategorinë e personave të rrezikuar.

5.2 Marrja e dëshmisë së fëmijëve

Intervista dhe pyetjet duhet të bëhen nga një person i kualifikuar për të zhvilluar intervistë ligjore me fëmijët²⁰ dhe të zbatohen njohuritë moderne shkencore për funksionimin mendor, social dhe komunikativ të fëmijëve.

- Të drejtat e fëmijës në procesin e marrjes së dëshmisë dhe të intervistimit.

Marrja e dëshmisë dhe intervistimi i fëmijëve bëhet në prani të një përfaqësuesi ligjor. Nëse fëmija është dëmtuar gjatë veprës penale dhe nëse dyshohet se përfaqësuesi i tij ligjor e ka kryer aktin penal, atëherë, për të mbrojtur interesat e fëmijës, caktohet një kujdestar përgjegjës. Intervistimi i fëmijës, që është dëmtuar gjatë veprës penale, bëhet me ndihmën e një psikologu, punonjësi social ose profesionistëve të tjerë.

5.3 Marrja e dëshmisë nga dëshmitarët në stres të madh

Në mënyrë që të realizohet pyetja e një personi nën stres të madh është e nevojshme që në procedurat paraprake dhe në fazën e parë të intervistës të vendoset besimi, të zhduket ose të reduktohet frika e dëshmitarit dhe të krijohet një ndjenjë sigurie. Viktimat e përdhunimit janë në një gjendje të veçantë psikologjike dhe për këtë arsye ata kanë nevojë të veçanta.

5.4 Marrja e dëshmisë së dëshmitarëve me çrregullime, mangësi ose paaftësi

²⁰ Aldridge, M., Wood, J., 1998 "Intervistimi i fëmijëve - Guidë për kujdesin e fëmijëve", Chichester: Wiley.

Kjo kategori dëshmitarësh të preکشëm, përfshin dëshmitarë me mangësi ose paaftësi²¹. Pozita e tij e preکشme varet nga shkalla në të cilën paaftësia kufizon aftësinë e personit për të dhënë dëshminë. Për këtë arsye, çdo rast duhet trajtuar mbi bazën e specifikës së vet. Intervista dhe pyetja e tyre duhet të bazohet në aftësitë e shëndetshme të këtyre personave.

5.5 Marrja e dëshmisë së dëshmitarëve të frikësuar

Dëshmitarët e frikësuar janë persona që kanë frikë të dëshmojnë në atë shkallë që kjo pengon bashkëpunimin e tyre me policinë ose ushtron ndikim të konsiderueshëm në cilësinë e dëshmisë së tyre. Rreziku i frikësimit të tyre zakonisht lidhet me krimet e rënda, si: trafikimi, dhuna në familje, vepra penale seksuale, sulme, akte të kryera për shkak të urrejtjes dhe hakmarrjes, viktimizimi i përsëritur i viktimës, njohja ose afërsia e viktimës dhe autorit të veprës penale, si dhe përvoja negative e mëparshme me policinë dhe sistemin gjyqësor. Njohja e preکشmërisë për shkak të frikësimit mund të bëhet përpara pyetjes mbi bazën e karakteristikave të krimit ose informacionit të marrë për kërcënime. Njohja e frikësimit të dëshmitarit është e rëndësishme për të krijuar parakushtet e nevojshme për bashkëpunimin e policisë me dëshmitarin.

6. MBROJTJA E DËSHMITARIT TË KËRCËNUAR

6.1 Trajtimi i dëshmitarëve të kërcënuar

Çdo veprim që përfshin një burim informacioni, provash ose një proces për grumbullimin e provave, si dhe trajtimi i të dyshuarve dhe individëve të tjerë, duhet të jetë i paanshëm. Procedurat që kanë të bëjnë me dëshmitarë të kërcënuar, persona të dyshuar, ashtu si çdo veprim tjetër duhet të bazohen në dispozita ligjore, por dispozita të tilla duhen përpunuar më tej në formën e një rregulloreje procedurale, veçanërisht në rastet kur zbatimi i një norme ligjore kërkon njohuri

²¹ Kebbll, M.R. and Hatton , C. 1999 “Njerëzit me zhvillim të vonuar mendor si dëshmitarë në gjykatë”, f. 37.

në shumë fusha si të logjikës, psikologjisë dhe kriminologjisë.

6.2 Njohja e kërcënimit

Burimi i informacionit rreth kërcënimit mund të jetë dëshmia e personit dëshmitarit ose viktimës, ose ai mund të rrjedhë nga natyra e krimit, lidhja midis viktimës dhe autorit të krimit, nga fakti se personi është autori “i njohur” krimesh ose nga përfundimi i pavarur i oficerit të ndjekjes penale.

Në parim kërcënimi është një krim në vetvete; rrjedhimisht agjencitë e ndjekjes penale janë të detyruara të zbulojnë atë, por edhe ta parandalojnë, ashtu siç ndodh me krimet e tjera. Burimi tjetër i informacionit për kërcënime vjen nga lidhje të veçanta midis viktimës dhe autorit të krimit dhe këto janë raste si ato të dhunës në familje. Personat përgjegjës për ndjekjen penale duhet të hartojnë një plan të përshtatshëm veprimi bazuar në vlerësimin nga ana e tyre të kërcënimit të mundshëm, ku do të përfshihen: Vlerësimi i kërcënimit dhe plani për të larguar kërcënimin, i cili duhet të përfshijë masat e mbrojtjes dhe të ndihmës, një metodë për të kontaktuar personin që është nën kërcënim dhe realizimin e veprimeve me pjesëmarrjen e vetë personit; këtu mund të përfshihet veçanërisht sigurimi i informacionit, njohja e kërcënimit, dhënia e dëshmisë. Këtu duhet të përfshihen edhe planifikimi i procesit dhe procedimi para gjyqit, mbrojtja e të dhënave, veprimet që kryhen në rast se nxirret një informacion i rëndësishëm dhe çdo gjë tjetër që kërkohet në procesin e planifikimit, me qëllim largimin e kërcënimit ndaj dëshmitarit. Një kusht paraprak për bashkëpunim është largimi i shkakut të kërcënimit. Një gjë e tillë kërkon vëmendje gjatë gjithë veprimeve procedurale, veçanërisht ato që angazhojnë dëshmitarët personalisht.

6.3 Kategoritë individuale të dëshmitarëve të kërcënuar

Kriteret bazë për përfshirjen e personit në kategorinë e dëshmitarëve të kërcënuar përfshijnë llojin e krimit, lidhjen me autorin e krimit, lidhjen midis autorit të krimit e krimit dhe rolin e tyre të veçantë në grumbullimin e provave. Bazuar në kriteret e lartpërmendura, por vetëm me këtë kusht, personat që

mund të klasifikohen kështu janë dëshmitarët e krimit të organizuar, dëshmitarët që janë kërcënuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga autori i krimit, pavarësisht nga lloji i krimit, dëshmitarë të frikësuar për shkak të rrethanave të veçanta, siç mund të jenë, p.sh., bashkëjetesa me autorin e krimit në rastet e dhunës në familje, afërsisë së banimit dhe dëshmitarët që janë në autoritetin e autorit të krimit si kujdestarët, mësuesi, punëdhënësi etj. Të gjitha kriteret, të marra së bashku, duhet t'i detyrojnë organet e ndjekjes penale ta konsiderojnë kërcënimin si një arsye të mundshme reale dhe serioze që mund të pengojë një dëshmitar të japë dëshmi. Në bazë të përvojës, krimet e kryera brenda familjes ndaj fëmijëve, krimi i organizuar, krimet e dhunshme sjellin kërcënime që pengojnë bashkëpunimin edhe dhënien e lirë të dëshmive nga dëshmitarët.

6.4 Elementet që shërbejnë si bazë për të përcaktuar llojin e mbrojtjes

Mbrojtja e dëshmitarëve dhe viktimave të krimit caktohet në bazë të vlerësimit të kërcënimit që mbështetet në vlerësimin e kërcënimit dhe në vlerësimin e rrezikut. Vlerësimi i kërcënimit është një veprimtari operacionale dhe analitike për policinë dhe prokurorinë, qëllimi i së cilës është të përcaktojë vërtetësinë e kërcënimit²² dhe, në rast kur një kërcënim i tillë ekziston, të përcaktojë nivelin e kërcënimit, si dhe lidhjen midis kërcënimit dhe faktit se personi zotëron informacion me rëndësi për ndjekjen penale ose sepse ai po bashkëpunon me organet e prokurorisë. Procedurat e duhura mbrojtëse mund të përcaktohen në bazë të rezultateve të vlerësimit. Krahas vlerësimit të kërcënimit bëhet edhe një lloj tjetër vlerësimi, vlerësimi i rrezikut dhe në të përfshihet analiza dhe vlerësimi i kërcënimit, ndaj të cilit dëshmitari do të ishte i ekspozuar në rast se s' do të merreshin masa mbrojtëse.

Veprimet e realizuara gjatë një kërcënimi janë në vetvete krime dhe ato duhet të vlerësohen në përputhje me dispozitat e së drejtës penale, por edhe

²² Vrij, A. 2000 "Zbulimi i gënjeshtreve dhe mashtrimit", Chichester: Wiley

nën dritën e rrethanave që i lidhin këto veprime me kërcënimin. Rrethanat e veçanta, që lidhin kërcënimin me frikën, në kuptimin normativ ligjor e përcaktojnë krimin si një krim të veçantë, pra si një vepër penale që pengon përpjekjet për të provuar krimin.

Krahas këtij elementi, kur përcaktohen masat e veçanta mbrojtëse, analiza duhet të vlerësojë, gjithashtu, rrezikun ndaj bashkësisë ku do të vendoset personi që merret në mbrojtje. Zyrtarët në polici dhe prokurori angazhohen në procesin e vlerësimit të kërcënimit dhe rrezikut dhe, bazuar në këtë vlerësim, përcaktojnë formën e përshtatshme për mbrojtje.

6.5 Hartimi i raporteve, marrja e vendimeve dhe mbrojtja e të dhënave

Në procesin e marrjes së vendimeve, si dhe në fazën e hartimit të tyre mund të marrin pjesë vetëm personat e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe, gjatë gjyqit gjyqtari përgjegjës. Mbrojtja e informacionit duhet të përqendrohet në parandalimin e nxjerrjes së tij, sepse pasojat e nxjerrjes janë të pamundura të menaxhohen. Në to mund të përfshihet refuzimi për të bashkëpunuar me agjencitë e ndjekjes penale ose në rastin e gabimeve të rënda në zhdukjen e fizik të dëshmitarit.

7. MASAT MBROJTËSE PROCEDURALE

7.1 Masat mbrojtëse procedurale

Këto masa janë: masat që lidhen me njoftimet për thirrje në gjyq, paraqitjen dhe sigurimin e një vendi për dëshmitarin në gjyq; masat për të mbajtur rendin dhe qetësinë në seancën gjyqësore; masat për të mos lejuar ndjekjen nga publiku të seancës, masat për të ndaluar regjistrimin audio dhe video gjatë seancës; masat për të larguar dëshmitarin nga salla; masat që lidhen me mënyrën e pyetjes; masat për të marrë në pyetje dëshmitarin nëpërmjet lidhjeve në video etj.

Mënyra e pyetjes së një dëshmitari dhe rrjedhimisht fshehja e plotë ose e pjesshme e identitetit të tij, janë masat më të rëndësishme mbrojtëse për

dëshmitarët “e preکشëm” dhe të frikësuar brenda procesit penal.

Vendimet për zbatimin e disa masave mbrojtëse procedurale duhet të merren nga gjykata. Disa prej këtyre masave, në veçanti masat që lidhen me njoftimet e thirrjeve në gjyq, ardhjen në gjyq, paraqitjen dhe sigurimin e një vendi për dëshmitarin në gjyq - kërkojnë pjesëmarrjen e administratës së gjykatës për planifikimin dhe zbatimin e tyre. Në rast se gjatë procesit para seancave gjyqësore disa rrethana tregojnë se një dëshmitar mund të rrezikohet, duhet të merren masat mbrojtëse joprocedurale. Zakonisht gjykata duhet të njoftohet për masat e marra sapo fillon procedimi penal, me qëllim që gjatë procesit të zgjidhen masat e përshtatshme. Prokurori propozon një urdhër për masat paraprake dhe të sigurisë. Nëse ai njoftohet nga një seancë e mëparshme se dëshmitari është në rrezik, prokurori paraqet propozimin për të urdhëruar sigurimin e personit, së bashku me kërkesën hetimore.

Rastet kur zbatohen masat e veçanta mbrojtëse janë të gjitha ato që lidhen me krimet e luftës, si dhe me shumicën e atyre kundër krimit të organizuar. Por ka edhe raste kur ka gjyqe me nuanca politike, pra që kanë pasoja politike, krime financiare etj.

Masat e përgjithshme mbrojtëse duhet të zbatohen si për dëshmitarët e propozuar nga mbrojtja edhe për ata të akuzës.

7.2 Zbatimi i masave mbrojtëse

Masat e sigurisë

Masat e sigurisë dhe mbajtja në arrest përpara gjyqit, së bashku me thirrjen në gjyq, sjelljen në gjyq, marrjen nën hetim, ndalimin, arrestimin dhe lirin me garanci pasurore, janë masa për të siguruar praninë e të pandehurit gjatë procesit penal.

Masat paraprake

I pandehuri i nënshtrohet kufizimit të të drejtave dhe lirive të tij vetjake gjatë gjendjes së arrestit. Një prej këtyre është ndalimi për të vizituar vende dhe persona të caktuar. Kjo masë zbatohet në mbrojtje të dëshmitarëve,

veçanërisht të viktimave. Me qëllim që kjo masë të zbatohet, duhet të ekzistojë dyshimi i arsyeshëm se i pandehuri mund të prishë procedurën, duke ndikuar te dëshmitari.

Paraburgimi, që ka të bëjë me rrezikun e aferave, lidhet me mbrojtjen e dëshmitarit. Kodi i Procedurës Penale e përcakton këtë rrezik si një mundësi për të pandehurin për të zhdukur, fshehur, ndryshuar ose falsifikuar provat, ose shenjat e rëndësishme për procesin penal, ose për të penguar hetimin duke ndikuar te dëshmitarët, bashkëpunëtorët ose bashkëfajtorët.

Masa të përgjithshme procedurale

Shumë masa procedurale mund të zbatohen për të rritur sigurinë e dëshmitarit, megjithëse objektivi i tyre nuk është mbrojtja e dëshmitarit. Këto masa janë largimi i publikut nga seanca gjyqësore: ndalimi për të bërë fotografi, për të regjistruar në video ose audio në seancën gjyqësore.

Rregulli dhe qetësia në seancën gjyqësore.

Kodi i Procedurës Penale parashikon rrethana, kur i pandehuri largohet nga salla e gjyqit.

Marrja në pyetje e dëshmitarit

Thirrja e dëshmitarëve

Kodi i Procedurës Penale parashikon që fletëthirrjet për gjyq si rregull dërgohen me postë. Por ato u dorëzohen dëshmitarëve nga një korrier në rastet kur kërkohen masa më të shumta për mbrojtjen e dëshmitarit. Administrata e gjykatës përveç thirrjes së dëshmitarëve, do të organizojë edhe transportimin e tyre në gjykatë.

Pritja dhe akomodimi i dëshmitarëve në gjykatë

Marrja në pyetje e dëshmitarit është veprimtaria kryesore, suksesi i së cilës është qëllimi i të gjitha masave mbrojtëse për dëshmitarin, për këtë arsye ne mendojmë të trajtojmë aspektet e veçanta të marrjes në pyetje të një dëshmitari gjatë hetimit dhe gjyqimit.

Gjatë hetimit. — Gjatë gjyqit.

7.3 Marrja në pyetje e dëshmitarit, identiteti i të cilit është fshehur

Marrja në pyetje e dëshmitarëve, identiteti i të cilëve është fshehur pjesërisht ose plotësisht, është masa më e rëndësishme mbrojtëse për dëshmitarin gjatë ndjekjes penale.

Vendimi për t'i dhënë dëshmitarit anonimitetin e pjesshëm ose të plotë duhet të kushtëzohet nga fakti nëse i pandehuri e njeh identitetin e vërtetë të dëshmitarit si dhe/ose pamjen e tij. Megjithatë, nëse i pandehuri njeh pamjen e jashtme të dëshmitarit, por nuk njeh informacionin e tij vetjak, p.sh., kur dëshmitari është një agjent i fshehtë, identiteti real i të cilit nuk njihet nga i pandehuri, por vetëm pamja e tij, dëshmitari duhet të mbrohet duke i dhënë atij një emër të rremë, por nuk është nevoja të ndryshohet zëri apo pamja e tij gjatë marrjes në pyetje.

Mosnxjerrja e informacioneve vetjake për dëshmitarin (anonimiteti i pjesshëm)

Nëse autoritetet vendosin që masat e veçanta të marrjes në pyetje duhet të jenë vetëm për fshehjen e informacionit vetjak të dëshmitarit, dëshmitari duhet të merret në pyetje me emrin e rremë që do t'i caktohet atij. Dëshmitari i rrezikuar thirret nëpërmjet organit që merret me menaxhimin e programit të mbrojtjes së dëshmitarëve. Thirrja për gjyq duhet të mbajë emrin e rremë të dëshmitarit. Në gjithë komunikimin e mëtejshëm gjykata duhet t'i drejtohet dëshmitarit me emrin e rremë. Nëse gjyqtari do të ketë dyshime për identitetin e dëshmitarit, krahasuar me personin që është pyetur më parë, gjyqtari duhet të lejohet të verifikojë identitetin e dëshmitarit. Marrja në pyetje e dëshmitarit të rrezikuar me një emër të rremë duhet të ndjekë të njëjtën procedurë si çdo marrje tjetër në pyetje e dëshmitarit. I vetmi përjashtim është se gjykata nuk duhet të lejojë pyetje, përgjigjja e të cilave mund të zbulojë identitetin e tij. Dëshmitari i rrezikuar mund të ballafaqohet, gjithashtu, me dëshmitarë të tjerë ose me të pandehurin.

Fshehja e informacioneve vetjake dhe e pamjes së dëshmitarit

Nëse personat që mund të kërcënojnë dëshmitarin nuk kanë dijeni për informacionin e tij vetjak ose për pamjen e tij, por ekziston mundësia që duke dhënë dëshminë dëshmitari të rrezikojë veten ose personat e afërt me të, informacioni vetjak, pamja dhe zëri i dëshmitarit duhet të mbahen të fshehta gjatë marrjes në pyetje. Marrja në pyetje e një dëshmitari të rrezikuar që i është dhënë anonimitet i plotë duhet të bëhet me anë të mjeteve të transmetimit audio dhe video që lidhin dhomën ku është dëshmitari me sallën e gjyqit dhe duke ndryshuar pamjen dhe zërin e tij. Dhoma ku është vendosur dëshmitari gjatë marrjes në pyetje duhet të jetë në shumicën e rasteve në gjykatë, ku duhet të qëndrojnë edhe gjyqtari që zhvillon marrjen në pyetje. Ky dëshmitar nuk mund të ballafaqohet me dëshmitarë të tjerë ose me të pandehurin.

Administrata e gjykatës ka kompetenca të rëndësishme në zbatimin e masave mbrojtëse procedurale

Kodi i Procedurës Penale parashikon raste të marrjes së dëshmitarëve në pyetje jashtë sallës së gjyqit. Marrja në pyetje e një dëshmitari nëpërmjet një lidhjeje video mund të justifikohet kur ka arsye që nuk i lejojnë palët të jenë në një sallë. Një arsye mund të jetë nëse dëshmitari ndjehet i kërcënuar nga prania e të pandehurit. Një zgjidhje mund të jetë marrja në pyetje me anë të një pajisjeje për transmetim audio dhe video. Një shqyrtim i tillë do t'i mundësojë palët dhe gjykatën t'i drejtojnë pyetje dëshmitarit sipas rregullit. Në qoftë se dëshmitari është vendosur jashtë juridiksionit të gjykatës që po gjykon çështjen, marrja në pyetje mund të zhvillohet me praninë e një gjyqtari të gjykatës që ka juridiksion, i cili do të verifikojë identitetin e dëshmitarit dhe instalimin e videos. Marrjet në pyetje me një lidhje nëpërmjet videos janë veçanërisht të rëndësishme për proceset që angazhojnë dëshmitarë që përfshihen në një program mbrojtjeje, të cilët janë transferuar në një vend tjetër. Çështjet që dalin nga situata të tilla duhet të zgjidhen me anë të marrëveshjeve ndërkombëtare që i referohen këtyre masave ekstraprocedurale të mbrojtjes së dëshmitarëve.

8. PRAKTIKA E INSTITUCIONEVE SHQIPTARE DHE REKOMANDIME MBI PËRMIRËSIMIN E SAJ DHE TË LEGJISLACIONIT.

8.1 Përfundime për veprimtarinë e prokurorisë dhe të policisë

Studimi i rasteve të shqyrtuara nga ana jonë rezultoi se rastet më tipike janë ato të agjentëve të infiltruar dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë. Sigurisht që duhet të punohet më shumë nga ana e Drejtorisë, por edhe e prokurorisë në fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve, pasi aktualisht vendi ynë përballet me krimin e tmerrshëm të dhunës në familje dhe viktimat e këtij krimi që janë dëshmitarët e prekshëm si gratë dhe fëmijët nuk janë futur asnjëherë në programin e mbrojtjes. Ose rastet e trafikimit të qenieve njerëzore që, gjithashtu, aktualisht zë një numër të madh të çështjeve të Gjykatës së Krimeve të Rënda nuk janë futur asnjëherë në programin e mbrojtjes. Në këtë kontekst, policia dhe prokuroria duhet të bashkëpunojnë për të shmangur dhe vlerësuar kërcënimin dhe frikësimin ndaj kësaj kategorie dëshmitarësh, për t'iu siguruar atyre mbrojtjen e nevojshme.

8.2 Përfundime për veprimtarinë e Gjykatës së Krimeve të Rënda

Pavarësisht nga sa u theksua më lart, duke pasur parasysh kohën e shkurtër dhe problemet e numrit të punonjësve të Gjykatës së Krimeve të Rënda, mendojmë se në fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve duhet të bëhet më shumë për të arritur standardet europiane dhe ndërkombëtare. Kështu, Gjykata duhet të krijojë kushte për fshehjen e identitetit të dëshmitarëve. Aktualisht dëshmitarët e rrezikuar paraqiten në të njëjtën sallë me të pandehurin. Nuk ka kushte teknike për të mundur fshehjen e identitetit të dëshmitarit të rrezikuar dhe kërcënuar. Edhe ndaj krimeve të tilla si trafikimet e qenieve njerëzore, e dëmtuara që është dëshmitare paraqitet në një mjedis me tutorin e saj, duke u shkaktuar atyre trauma të mëtejshme.

Gjykata nuk është në gjendje të vlerësojë kërcënimin ndaj dëshmitarëve,

referuar vendimit nr.16, datë 20.3.2007 të Gjykatës së Krimeve të Rënda që është apeluar dhe ka marrë formë të prerë, megjithëse e dëmtuara ka arritur të ndryshojë dëshminë e saj ndaj të pandehurve që kanë qenë tutorët e saj. Në këtë rast Gjykata duhet të kishte ndërprerë seancën dhe t'i kërkonte prokurorit të verifikonte nëse kishte kërcënim ndaj të dëmtuarës. Patjetër duhet të ketë pasur kërcënim, derisa ajo dëshmon se të pandehurit nuk i kanë bërë gjë dhe ndryshon akuzën ndaj të pandehurve duke i quajtur ata të pafajshëm. Në këtë rast e dëmtuara është e frikësuar dhe nuk dëshiron të dëshmojë. Të njëjtin gabim bën edhe Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda, duke lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë. Shteti duhet t'u ofrojë ndihmë dëshmitarëve, për të mundësuar ndëshkimin e drejtë të autorëve të krimit. Pra, këtu del qartë pengesa reale dhe e pranishme për administrimin e drejtësisë. Gjykata duhet të marrë parasysh praktikën që ka konsoliduar në këtë fushë Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila ka përcaktuar një numër përjashtimesh nga rregulli i përgjithshëm se "...të gjitha provat duhet të administrohen në gjyq, në praninë e të akuzuarit, në respekt të argumentit kundërvënës", të cilat i kemi paraqitur në këtë studim.

Në Republikën e Shqipërisë përcaktimi i anonimitetit të plotë ose të pjesshëm ose edhe vetë futja në programin e mbrojtjes bëhet me kërkesë të Prokurorit të Përgjithshëm dhe miratohet nga Komisioni. Ndërkohë që Gjykata për të Drejtat e Njeriut nga praktika e saj ka përcaktuar se kompetente për marrjen e këtyre lloji vendimesh duhet të jetë gjykata, natyrisht me propozimin e prokurorit. Rekomandojmë që të bëhen rregullimet e nevojshme.

8.3 Disa rekomandime për përmirësime të ligjit nr. 9205, datë 15.3.2004 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë"

1. Lidhur me nenin 2 pika 3 vërejmë se përkufizimi aktual është shumë i gjerë dhe kjo ka krijuar probleme në praktikë për futjen në programin e mbrojtjes së personave të afërm. Sugjerojmë të riformulohet si vijon:

“Persona të afërm konsiderohen ata persona që janë në rrezik aktual, konkret dhe serioz për shkak të lidhjeve të gjakut, të martesës ose bashkëjetesës me dëshmitarin ose me bashkëpunëtorin e drejtësisë.”

2. Lidhur me nenin 2 pika 4 përkufizimi nuk është i qartë. Duhet të përcaktohet lidhja që mund të ketë një person me dëshmitarin ose me bashkëpunëtorin e drejtësisë. Sugjerohet të riformulohet si vijon:

“ Persona të lidhur konsiderohen ata persona që janë në rrezik aktual, konkret dhe serioz për shkak të lidhjeve vetjake të ngushta me dëshmitarin ose bashkëpunëtorin e drejtësisë.”

3. Bazuar në terminologjinë e akteve ndërkombëtare, sugjerohet që në të gjithë projektligjin termat masa të posaçme dhe të përkohshme” të zëvendësohen me “programi i mbrojtjes”.

4. Bazuar në rekomandimin nr. Rec. (97) 13 që i referohet frikësimit të dëshmitarit dhe të drejtave të mbrojtjes (10 shtator 1997) të Këshillit të Europës, megjithëse është një instrument jodetyrues, sugjerohet që ligji të përmirësohet me përkufizime të tjera konkretisht për termat “frikësim” dhe “anonimitet”.

5. Në nenin 5 pika 1/a sugjerohet të shtohet një paragraf si vijon:

“Kryen një vlerësim të gjendjes psikologjike dhe fizike të personit të propozuar për t’u marrë në mbrojtje dhe një vlerësim gjithëpërfshirës të rreziqeve ndaj tij.”

6. Për të mundësuar realizimin e kompetencave të saj Drejtoria e MDBD-së ka nevojë për mbështetjen e institucioneve të tjera të administratës shtetërore. Sugjerohet që të formulohet një nen ku të përcaktohet detyrimi i institucioneve të administratës, për të bashkëpunuar me Drejtorinë për dhënien e informacioneve etj. Njëkohësisht të detyrojë institucionet e tjera të mbajnë sekret informacionet e dhëna. Përcaktimi me ligj i detyrimit të institucioneve të administratës, për të kryer detyrat që kërkohen nga Drejtoria si në rastin e krijimit të një identiteti të rremë, do t’i përjashtojë ata nga përgjegjësia penale sipas nenit 21 të Kodit Penal.

7. Gjithashtu, jemi të mendimit që të shtohet një nen në ligj që të përcaktojë kriteret e emërimit dhe të largimit nga puna në Drejtori, për të mundësuar një staf të trajnuar dhe për të shmangur largime ose transferime të pa përligjura. Sugjerohet që Drejtoria të ketë në staf punonjës socialë dhe psikologë.

8. Duke pasur parasysh që programet e mbrojtjes janë një mjet i skajshëm i kushtueshëm, që mund të përdoren vetëm kur nuk ka asnjë mënyrë tjetër, për të siguruar jetën e një dëshmitari ose bashkëpunëtori. Nga ana tjetër, dëshmia e personit duhet të jetë e një rëndësie vendimtare dhe mendojmë se qëllimi i programit zgjerohet së tepërmi nëse mbrohen edhe dëshmitarë që japin të dhëna për parandalimin e veprave penale që nuk janë kryer ose produktet e veprës penale. Prandaj sugjerohet të riformulohet neni 8 pika 1 si vijon:

“Kur zbatimi i masave të zakonshme të mbrojtjes për dëshmitarin e drejtësisë nuk është i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm, zbatohet programi i mbrojtjes sipas këtij ligji, nëse ai pranon të bashkëpunojë me vullnet të lirë me organin e prokurorisë dhe të policisë gjyqësore, nëpërmjet dëshmisë së vet të plotë, të bërë pa kushte dhe rezerva, jep të dhëna të bazuara që përbëjnë burime të rëndësishme prove ose prova themelore për zbulimin, hetimin dhe gjykimin e krimeve të rënda dhe të autorëve të tyre.”

9. Po për këto arsye jemi të mendimit që neni 9 pika 1 të riformulohet si vijon:

“Kur zbatimi i masave të zakonshme të mbrojtjes për bashkëpunëtorin e drejtësisë nuk është i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm, zbatohet programi i mbrojtjes sipas këtij ligji, nëse ai pranon të bashkëpunojë me vullnet të lirë me organin e prokurorisë dhe të policisë gjyqësore, nëpërmjet dëshmisë së vet të plotë, të bërë pa kushte dhe rezerva, jep të dhëna të bazuara që përbëjnë burime të rëndësishme prove ose prova themelore për zbulimin, hetimin dhe gjykimin e krimeve të rënda dhe të autorëve të tyre.”

Njëkohësisht mendojmë që në nenin 10 pas pikës 4 të shtohet një pikë si

vijon:

“Drejtoria për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë dhe asnjë institucion shtetëror nuk përgjigjen për detyrimet financiare që personat e mbrojtur kanë në momentin e pranimit në programin e mbrojtjes.”

Në nenin 17 pika 1 sugjerojmë të shtohet edhe një shkronjë tjetër si vijon:

“Marrëveshja e mbrojtjes nuk është marrëveshje detyrimi në kuptim të Kodit Civil. Personi i mbrojtur ose trashëgimtarët e tij nuk mund të kërkojnë në gjykatë ekzekutimin e kësaj marrëveshjeje dhe as dëmshpërblim në rastet kur marrëveshja nuk është ekzekutuar ose ai pretendon se i janë shkaktuar dëme.”

Mendojmë që ekzistenca e këtij parashikimi është thelbësore për mbarëvajtjen e një programi për mbrojtjen e dëshmitarëve. Nëse çëshjte të tilla do t’i nënshtroheshin shqyrtimit gjyqësor, shumë detaje të programit do të bëhen të ditura publikisht, duke krijuar një rrezik serioz për sistemin e mbrojtjes së dëshmitarëve.

Neni 17 pika 3 sugjerojmë të riformulohet si vijon:

“Bashkëpunëtori i drejtësisë detyrohet të informojë Drejtorinë me hollësi për llojet dhe masën e pasurive të zotëruara prej tij. Nëse ndonjë nga pasuritë që zotërohen nga bashkëpunëtori i drejtësisë është produkt i veprave penale, e ardhur ose përfitim nga produktet e veprës penale, ose pasuritë me të cilat janë përzier këto produkte, atëherë personi duhet ta deklarojë këtë fakt, si dhe të japë miratimin për konfiskimin e kësaj pasurie. Në rastet kur bëhet një deklaram i tillë, Drejtoria njofton menjëherë Prokurorin e Përgjithshëm.

Qëllimi i marrjes së miratimit personit është që të mënjanohej ankimmimet e tij gjatë procedurave të sekuestrimit e konfiskimit. Qenia e tij në program mund ta bëjë të pamundur pjesëmarrjen në këto procedura.

Në nenin 17 pika 4 sugjerojmë të riformulohet si vijon:

“Nëse personi, ndaj të cilit zbatohet programi i mbrojtjes vritet ose humbet aftësinë për të punuar për shkak të dëshmtimit të masave të mbrojtjes, me propozim të Drejtorisë, Komisioni mund t’i caktojë personit ose anëtarëve të familjes në ngarkim të tij mbështetje financiare të posaçme.”

Mendojmë që pas nenit 19 të shtohet një nen i ri 19/1:

“Personi mund t’i drejtohet Komisionit me një kërkesë me shkrim, duke kërkuar rishikimin e vendimit për programin e mbrojtjes së tij, brenda 5 ditëve. Ankimi nuk pezullon zbatimin e masës së zgjedhur. Komisioni shprehet me vendim brenda 10 ditëve. Vendimi i tij është i formës së prerë.”

Qëllimi i këtij neni nuk është që Komisioni të kontrollojë punën e Drejtorisë në lidhje masat konkrete që do të merren, por vetëm të sigurohet që nuk janë lënë mënjanë rrethana të rëndësishme për pranimin e personit në program.

Gjithashtu, duhet të specifikohet se dokumentimi i shpenzimeve dhe kontrolli financiar i veprimtarisë së Drejtorisë të bëhet në mënyrë të tillë që të mos lejojë identifikimin e të dhënave me natyrë sekrete.

Duhet të specifikohet në ligj si një kompetencë e Drejtorit, që të lidhë marrëveshje dypalëshe me njësi të ngjashme në vendet ku parashikohet zbatimi i programeve të mbrojtjes. Edhe këto marrëveshje përbëjnë informacion të klasifikuar.

Ndoshta në nenin 14 mendojmë të përcaktohet një nen i ri ku bashkëpunëtori i drejtësisë të detyrohet të informojë Drejtorinë për çdo shkelje të mëparshme të ligjit të kryer prej tij, pavarësisht nëse është dënuar ose jo. Në këto raste Drejtoria duhet të njoftojë prokurorin.

Njohja e këtyre fakteve përbën një aspekt themelor të besueshmërisë së dëshmisë së tij.

Për të përmirësuar ligjin sugjerojmë që të paraqiten në ligj rekomandimet e Këshillit të Europës si ai i 97 dhe 2005, të cilat japin përkufizime të detajuara për termat si “kërcënim” dhe “frikësim”. Ky i fundit nuk parashikohet në

ligjin aktual. Pra, sugjerojmë që ligji të rishikohet në tërësi dhe të reflektojë standardet europiane dhe ndërkombëtare.

Njëkohësisht mendojmë që të përmirësohen edhe aktet nënligjore:

Kështu rekomandohet që personi i mbrojtur të ketë një person kontakti te Drejtoria dhe të komunikojë vetë me të. Kjo është e domosdoshme jo vetëm për vendosjen e kontaktit psikologjik, por edhe për përgjegjësinë në rastin e shkeljes së sekretit, pra lind nevoja e përcaktimit të një subjekti të tillë.

BIBLIOGRAFIA

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Kodi i Procedurës Penale, Kodi Penal.

- Ligji nr. 9205, datë 15.3.2004 “Për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe të Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë”.

- “Reagimi ligjor ndaj fenomenit të terrorizmit sipas legjislacionit shqiptar dhe ndërkombëtar”, 2007, R. Balla, bot. “E drejta Parlamentare dhe Politikat Ligjore”.

- Terrorizmi, mbrojtja e dëshmitarit dhe e bashkëpunëtorit të drejtësisë , 2006, Maklu, Antwerp-Apeldoorn.

- Raportet shpjeguese të rekomandimeve të ndryshme të Këshillit të Europës, G.Vermuelen (Ed.)

- Standardet e BE në raport me mbrojtjen e dëshmitarit dhe të bashkëpunëtorit me drejtësinë, 2005.

- V. Hysi “Kriminologjia”, 2005, Tiranë.

- Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut.

- “Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Rruga për në Gjykatën e Strasburgut”, Qendra Europiane , Tiranë 2003.

- Standardet e BE-së në mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, 2005, G.Vermuelen, Maklu, Anwerp-Apeldoorn, 50-64.

- Van Dijk “Caring for Crime Victims” Criminal Justice Press, Mensey, New York, 1999.

- Elezi, I., Kacupi, S., Haxhia, M. “Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë”, GEER, Tiranë, 2006
- “E Drejta Civile për Korrupsionin dhe Çështje të Përafrimit të Legjislacionit”, 2006, R. Balla, bot. “E drejta Parlamentare dhe Politikat Ligjore”.
- Bianku, L. “Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut, botim i Qendrës Europiane, Këshillit të Europës dhe Komisionit European, Tiranë, 2005
- Ligj nr. 8984, datë 23.12.2002 “Për ratifikimin e Statutit të Romës për Gjykatën Ndërkombëtare Penale”.
- “Marrja e dëshmisë më të mirë në Procedimin Penal” udhëzim për dëshmitarët e rrezikuar dhe të frikësuar, Home Office 2002.
- Aldridge, M., Wood, J., 1998 “Intervistimi i fëmijëve Guidë për kujdesin e fëmijëve”, Chichester: Wiley
- Kebell, M.R. and Hatton , C. 1999 “Njerëzit me zhvillim të vonuar mendor si dëshmitarë në gjykatë”.
- Vrij, A. 2000 “Zbulimi i gënjeshtreve dhe mashtrimit”, Chichester: Wiley

Sistemi i menaxhimit të çështjeve CCMIS si pjesë e reformës në sistemin shqiptar të drejtësisë

*Rovena Qose
Juriste*

HYRJE


Reformimi i sistemit shqiptar të drejtësisë është një çështje e ditës në bisedat dhe diskutimet tona, në epiqendër të debateve politike, po aq sa dhe në planet e punës së autoriteteve shtetërore. Ndërmarrja e reformave duhet parë edhe si pjesë e arritjes së standardeve kundrejt qëllimit të rritjes së transparencës ndaj publikut. Korrupsioni në organet e drejtësisë, veçanërisht në gjykata, është një temë e prekshme për publikun dhe si e tillë, prej vitesh ka iniciuar marrjen e masave për të ofruar një standard transparence sistem gjyqësor-publik.

Në këtë shkrim për reformën në sistemin e drejtësisë do të përqendrohemi në një aspekt, atë të ndikimit të shkencës informatike në rritjen e transparencës dhe të besueshmërisë në sistem. Punimi paraqet konstatimet e deritanishme të sistemit të ri elektronik të gjykatave, të Shkallës së Parë dhe të Apelit, në përpjekje të bërjes së mundur të unifikimit të praktikave të punës dhe lehtësimit të komunikimit gjykatë- gjykatë dhe gjykatë-publik.

Reforma e ndërmarrë në këtë linjë të sistemit të drejtësisë në Shqipëri ka ndikime, nga njëra anë mbi personelin e gjykatave (kryesisht mbi gjyqtarët dhe sekretarët) dhe, nga ana tjetër, mbi publikun (qytetarë dhe palë në procedimin gjyqësor).

Statistikat vazhdimisht tregojnë sesi mendojnë njerëzit (publiku) për korrupsionin në sistemin e tyre të gjykatave dhe sesa i fuqishëm është besimi që ata kanë në një sistem të frytshëm dhe transparent drejtësie. Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit¹ tregon që besimi është i ndryshëm në sistemet gjyqësore të vendeve të ndryshme europiane. Vendet europiane lindore dhe jugore kanë një tregues më të ulët besimi në sistemin e frytshëm të drejtësisë.

Indeksi varion nga 0-10 ku 0 do të thotë i ulët dhe 10 do të thotë sistem drejtësie tepër transparent dhe i frytshëm. 10 është treguesi me korrupsionin




¹ Burimi: *Transparency International* (TI) në Berlin, Gjermani

më të ulët.

Siç mund shihet, Shqipëria është ende në zonën e vendeve më të korruptuara dhe ka, gjithashtu, shumë më pak çështje të regjistruara për qytetar. Kjo varet, nga njëra anë, nga mungesa e besimit të qytetarëve shqiptarë në sistemin e drejtësisë dhe, nga ana tjetër, nga mundësitë ekzistuese të formave të tjera për të zgjidhur probleme. Kështu, mund të themi që organizatat sociale, mentaliteti familjar apo fisnor (edhe vetëgjyqësia disi) kanë ende një pozitë të fuqishme në Shqipëri.

Raporti më i fundit i TI² për korrupsionin në drejtësi sërish e paraqet Shqipërinë në vend problematik. Kështu:



Source: TI Global Corruption Barometer 2006

Figure 2: The percentage of respondents that have paid a bribe to the police by regional grouping²

Siç mund të shihet në këtë grafik, vetëm një pjesë e vogël e pjesëmarrësve në pyetësor nga vendet e Amerikës Veriore dhe të Bashkimit European kanë paguar ryshfet. Dhe grupimet e tjera, në më shumë se gjysma në vende si

² TI = Transparency International

Afrika, kanë paguar një të tillë. Midis dy skajeve, grupimet e tjera rajonale paraqesin nivele shqetësuese korrupsioni. Vendet e Europës Jug-Lindore³ vari

Table 1: (Continued)

Country rank	Country	2006 CPI score ^a	Surveys used ^b	Standard deviation ^c	High-low range ^d	Confidence range ^e
	Uganda	2.7	7	0.5	2.1-3.5	2.4-3.0
111	Albania	2.6	5	0.3	2.3-2.8	2.4-2.7
	Guatemala	2.6	5	0.5	2.3-3.5	2.3-3.0
	Kazakhstan	2.6	6	0.4	2.1-3.2	2.3-2.8
	Laos	2.6	4	1.0	1.9-4.0	2.0-3.1
	Nicaragua	2.6	6	0.4	2.3-3.2	2.4-2.9
	Paraguay	2.6	5	0.8	2.3-4.0	2.2-3.3
	Timor-Leste	2.6	3	0.6	2.1-3.2	2.3-3.0
	Vietnam	2.6	8	0.4	1.9-3.5	2.4-2.9
	Yemen	2.6	4	0.2	2.3-2.7	2.4-2.7
	Zambia	2.6	6	0.7	1.6-3.5	2.1-3.0
121	Benin	2.5	6	0.6	1.8-3.2	2.1-2.9

Pyetëtori ka, sikurse tregohet edhe në tabelën e mësipërme, një renditje jo shumë pozitive për Shqipërinë, përkatësisht në vendin e 111.

PROJEKTI CCMIS 2007

INFRASTRUKTURA TEKNIKE NË GJYKATA

Edhe nga politikëbërësit mund të dëgjojmë shpesh që korrupsioni është problem i madh në Shqipëri dhe organizatat ndërkombëtare e konfirmojnë,

³ Vendet e Europës Juglindore të përfshira në pyetësor janë: Shqipëria, Bullgaria, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Rumania, Serbia and Turqia.

⁴ James H. Anderson, Cheryl W. Gray "Antikorrupsioni në tranzicion 3". Tabela tregon kompanitë e biznesit me përvojën e tyre. Për studimin e plotë shikoni <http://web.worldbank.org/WEBSITE/EXTERNAL/COUNTRIES/ECAEXT/0..contentMDK:20989777~pagePK:146736~piPK:146830~theSitePK:258599.00.html>

gjithashtu, këtë mendim⁴. Në mënyrë të vazhdueshme bëhen shumë përpjekje për të reduktuar korrupsionin dhe për të rritur transparencën e sistemit shqiptar të drejtësisë. Një nga këto përpjekje është, gjithashtu, instalimi i një sistemi IT në të gjitha gjykatat e vendit. Gjyqtarët do të përcillen gjatë punës së tyre dhe çështjet do të ruhen në mënyrë transparente në një sistem elektronik, që bën të mundur kontrollimin e personelit të gjykatës dhe veprimet e tyre në procedimet gjyqësore.

Megjithatë, duhet thënë se shumë gjyqtarë në Shqipëri nuk janë të korruptuar. Arsyeja e opinionit publik për korrupsion në sistemin shqiptar të drejtësisë është, gjithashtu, fakti që publiku e përsërit vazhdimisht që në rast se vendimi nuk është në favor të një pale, pa dyshim që gjyqtari është i korruptuar. Një masë e rëndësishme për të fituar besimin në sistemin gjyqësor shqiptar është që publikut t'i tregohet se do të ketë më shumë kontroll mbi këtë sistem drejtësie.

Deri në muajin gusht 2006 në shumicën e gjykatave shqiptare nuk kishte një sistem të unifikuar IT dhe as Rrjet. 6 nga 38 gjykatave u ishte siguruar rrjet me sistemin e menaxhimit të çështjeve Ark IT nga Fondacioni Soros dhe USAID. 3 gjykatave u ishte siguruar rrjet dhe sistemi i menaxhimit të çështjeve CCMIS nga Banka Botërore. Pjesa tjetër e gjykatave shqiptarë nuk kishin as sistem IT, as infrastrukturën e nevojshme për të.

Në muajin shtator 2006, në kuadër të Projektit CARDS 2003 (EuropeAid/122786/C/AL)⁵, dhe nën bashkërendimin e misionit EURALIUS, filloi shpërndarja e 20 rrjeteve LAN, 20 serverëve, 176 kompjuterëve dhe 46 printerëve në rrjet në të gjitha gjykatat, të shkallës së parë dhe të apelit. Në bashkëpunim me Bashkimin Europian u parashikua gjithashtu instalimi i sistemit të menaxhimit të çështjeve CCMIS në të gjitha gjykatat shqiptare që trajtojnë çështje civile (35 gjykata në mbarë vendin). Në fund të vitit 2007 u realizua infrastruktura e nevojshme për sistemin IT edhe për çështjet penale,

⁵ "Pajisje IT dhe Trajnimi Përkates për Administratën Gjyqësore"

duke bërë të mundur një kompletim të sistemit. Të gjitha gjykatat tashmë kanë një server për të dhënat vendore, çdo gjyqtar dhe çdo sekretar ka një kompjuter dhe çdo kompjuter lidhet me anë të kabllor së Rrjetit Vendor të Zonës (LAN) me serverin vendor. Prandaj, mbulimi i pajisjeve dhe sistemit në gjykatat civile është 100 për qind (= 35 gjykata civile nga 35 gjithsej, janë të pajisura) dhe mbulimi i pajisjeve dhe sistemit në total të të gjitha gjykatave është 92.1 për qind (= 35 gjykata civile nga 39 gjykata gjithsej). Mbulimi i sekretarëve dhe gjyqtarëve me kompjuterë tani është, gjithashtu, 100 për qind, edhe pse një pjesë e personelit të gjykatave duhet të punojë me kompjuterë më të vjetër.

Me projektin CCMIS 2007, Shqipëria rrit ndjeshëm sofistikimin e përdorimit elektronik deri në gjendjen 50 për qind -75 për qind. Infrastruktura për një sistem informacioni në mbarë vendin është përgatitur dhe programi IT do të sigurojë informacion për çështjet dhe procedimet e tyre. Gjithashtu, ndërveprimi i njëanshëm do të mundësohet shpejt me anë të faqeve të internetit të gjykatave (orari publik i gjykatave dhe transparenca e vendimeve të formës së prerë të gjykatës)⁶.

FUNKSIONET E SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE CCMIS NË MBARË VENDIN

Dokumentimi elektronik i çështjeve do të thotë që të bëhet lehtësisht i gjindshëm çdo veprim i personelit të gjykatës. Gjyqtarët do të kenë më shumë kontroll mbi veprimet e tyre. Data dhe ora e çdo hyrjeje do të regjistrohet dhe çdo veprim në sistem mund të gjendet dhe të riprodhohet. Në këtë

⁶ Projekti i ri i financuar nga BE: Shtirja e sistemit CCMIS edhe në fushën penale, lidhja me internet, publikimi i vendimeve dhe orareve të seancave, krijimi i faqeve të internetit dhe ofrimi i shërbimit teknik kompjuterik për një vit. Tashmë ka nisur furnizimi me internet i disa gjykatave, si ato të Tiranës (shkallë e parë dhe apel), Durrësit (shkallë e parë), Kavajë, Kurbin dhe dy gjykatat e Shkodrës.

mënyrë do të ketë më shumë kontroll dhe transparencë.

Shpërndarja e çështjeve bëhet nga sistemi me short. Kështu sigurohet caktimi i paparashikueshëm dhe jo i dyshimtë e gjyqtarëve në çështje të caktuara. Nuk mund të parashikohet nga palët ose nga avokati se kujt gjyqtari do t'i takojë çështja përpara ngritjes së padisë në gjykatë dhe përpara regjistrimit të çështjes nga sekretari. Kështu do të bëhet një shpërndarje e pavarur dhe e sigurt e çështjeve.

Futja e të dhënave dhe procesverbaleve të seancave parashikohet të bëhet, ndërsa procesi publik bëhet në sallën e gjyqit. Gjykatat duhet të kenë një kompjuter në sallën e gjyqit. Çdo ndryshim i procesverbalit pas seancës është i mundur, por duhet të regjistrohet dhe të jetë, gjithashtu, lehtësisht i gjindshëm. Kështu, nuk mund të ketë ndryshime të pakontrolluara të procesverbaleve të seancave.

Lidhja me Internet parashikohet të ofrohet për një vit nga fondet e projektit të BE dhe më tej nga Ministria e Drejtësisë dhe zyra e buxhetit gjyqësor. Kjo është e nevojshme për ndjekjen e çështjeve në gjykata të tjera dhe në shkallët e tjera (Gjykatë e apelit dhe Gjykatë e Lartë). Kështu, aksesi në të gjitha çështjet në mbarë vendin do të jetë i mundur.

Arkivimi i unifikuar i çështjeve lejon që çështje të mbyllura të gjenden shpejt në sistem dhe jep informacion për datën dhe kohën e padive të ruajtura në dosjet e çështjeve. Në këtë mënyrë personeli i gjykatës mund të punojë me më shumë frytshmëri.

EFEKTET MBI KOHËZGJATJEN E PROCEDIMEVE DHE MBARTJEVE GJYQËSORE

Zbatimi i sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve CCMIS do të kontribuojë në shkurtrimin e kohëzgatjes së procedimeve dhe në shmangien e mbartjeve gjyqësore.

Procedura e shortit që kërkon shumë kohë, e cila në shumë gjykata zhvillohet në praninë e të gjithë gjyqtarëve, nuk do të përdoret më, pasi shorti

do të bëhet në mënyrë elektronike. Të dhënat mund të prodhohen drejtpërdrejt gjatë seancave, që do të thotë se sekretarët nuk do të kërkojnë kohë shtesë për transkriptimin dhe gjyqtarët do të mund t'i përdorin menjëherë për punën e tyre të mëtejshme për çështjet. Gjyqtarëve do u duhet më pak kohë për të organizuar punën e tyre, sepse mund të kontrollojnë vetë lehtësisht gjendjen e të gjitha çështjeve kurdoherë, pa pasur dosjen fizike përpara tyre. Për të njëjtën arsye, rreziku për të humbur afatin ligjor ose të vetëcaktuar do të jetë pothuajse zero.

Statistikat prodhohen vazhdimisht nga sistemi. Kështu, gjyqtarët (dhe kryetarët) mund të njohin mbartjet gjyqësore në zhvillim në një fazë të hershme, kur është ende e lehtë të merren masat e duhura që luftojnë grumbullimin e mbartjeve gjyqësore.

Koha që nevojitet për komunikim ndërmjet gjyqtarëve dhe sekretarëve për gjendjen aktuale të çështjes ose vendndodhjen aktuale të dosjes do të reduktohet shumë.

Sekretarët do të kërkojnë shumë më pak kohë për të nxjerrë thirrjet për një gjyq, gjykimet dhe dokumente të tjera, sepse mund të përdorin formate standarde, funksione kopjo-zëvendëso për të bërë plotësime.

NDIKIMI MBI PERSONELIN E GJYKATËS

Personeli i gjykatës, i trajnuar më së miri, po kontribuon, gjithashtu, shumë për një sistem të frytshëm drejtësie. Sekretarët dhe gjyqtarët janë trajnuar për të përdorur teknologjinë e informacionit (njohuri bazë kompjuterike) dhe për të përdorur sistemin e menaxhimit të çështjeve CCMIS (trajnim i hollësishëm për sistemin IT). Ata do të jenë në gjendje të trajtojnë më shpejt kërkesat për informacion për çështjet nga avokatët ose palë të tjera të interesuara. Nuk do të jetë gjithmonë e nevojshme të ekzistojë dosja fizike për të punuar me çështjen pasi shumica e të dhënave dhe veprimeve të çështjes, ruhen në dosjen elektronike.

Procesverbalet e seancave gjyqësore dhe vendimet e gjykatës ruhen në

sistem. Ato mund të rishikohen gjithmonë nga personeli i gjykatës në çdo fazë të çështjes. Gjykata cakton afatet kohore të dokumenteve dhe datat e seancave gjyqësore. Personeli i gjykatës mund të shohë këto të dhëna në çdo kohë dhe nuk ka gjithmonë nevojë për dosjen fizike të çështjes. Gjyqtarët duhet të jenë në gjendje të lexojnë edhe vendime të tjera. Kështu do të jenë në dijeni sesi është vendosur për çështje të ngjashme.

NDIKIMI MBI PUBLIKUN

Publiku do të fitojë besimin në sistemin transparent dhe të frytshëm të drejtësisë, sepse mund të mbështetet te personeli i trajnuar dhe gjykatat e pajisura më së miri që merren me çështjet e tyre. Palët mund të kërkojnë printimin e procesverbaleve të seancave dhe rishikim nëse seancat gjyqësore janë regjistruar me korrektësi.

Palët, avokatët dhe shtetas të tjerë të interesuar mund të shohin vendimet e gjykatës, të cilat botohen nga kjo e fundit. Kështu do të rritej niveli i diskutimit gjyqësor dhe do të kontribuohet për doktrinën juridike më të unifikuar në Shqipëri. Shtetasit shqiptarë do të fitojnë besim, duke pasur më shumë barazi përpara gjykatave dhe duke u trajtuar të barabartë përpara ligjit. Dhe transparenca dhe besimi në sistemin e drejtësisë do të rritet ndjeshëm.

PËRFUNDIME

Edhe pse sigurisht do të duhet kohë për t'u familjarizuar me teknologjinë e Informacionit, përdorimi i Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve CCMIS në gjykata do të rrisë transparencën dhe është një masë e rëndësishme për të luftuar korrupsionin në sistemin e drejtësisë.

Gjykatat duhet të jenë në gjendje t'i sigurojnë publikut një shërbim më profesional dhe zbatim më të unifikuar të së drejtës në të gjithë vendin.

Ndër planet afatgjata në lidhje me CCMIS-in mund të përmendim:

- Ngritja e një sistemi të besueshëm, të frytshëm dhe të qëndrueshëm për menaxhimin e çështjeve civile në gjykata.

· Dhënia e raporteve të nevojshme të menaxhimit për gjykatat dhe MD-në për të marrë vendimet e nevojshme;

· Hapja e sistemit për të përfshirë dhe integrimi i një sistemi për prokurorinë, një sistem për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe një lidhje me shërbimin e përmbarimit.

Dhe sigurisht ky është një hap paraprak në reformat që mund të ndërmerren në sistem, siç mund të përmenden, së pari, ato lidhur me hartimin e legjislacionit përkatës rregullues të çështjes në fjalë dhe më tej. Nuk mund të lihet pa përmendur hapi i ndërmarrë në vjeshtën e vitit 2007 me mbylljen e 8 gjykatave të ashtuquajtura “të vogla” të shkallëve të para dhe përshtatja e sistemit elektronik CCMIS të tyre ndaj gjykatave përthithëse, si pjesë e reformimit të sistemit.

BIBLIOGRAFIA

- Raporti i TI 2005

- Raporti i TI 2007

- James H. Anderson, Cheryl W. Gray “Antikorrupsioni në Tranzicion 3”, Website of World Bank

- Rekomandimi i misionit EURALIUS: Për rritjen e transparencës së sistemit gjyqësor me anë të teknologjisë së informacionit

Investigim mbi situatën e IT në gjykatat shqiptare, të shkallës së parë dhe të apelit.

Reforma gjyqësore dhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese

Dr. Fehmi Abdiu

1. TË SHMANGEN PASAKTËSITË, KONTRADIKTAT E TJERA DHE TË REFLEKTOHET PRAKTIKA E GJYKATËS KUSHTETUESE MBI KONTROLLIN NË GJYKATA

Ligji nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” dhe ligji nr. 8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” janë përgatitur thuajse në një kohë dhe janë miratuar brenda një harku kohor 5-ditor. Megjithëkëtë, ato dallojnë ndjeshëm në mënyrën sesi janë konceptuar dhe si kanë zgjidhur mjaft probleme me rëndësi si për kontrollin për dhënien e drejtësisë, ashtu edhe në lidhje me kontrollin për administrimin e saj.

Para së gjithash vihet re se ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” i ka dhënë këtij institucioni një vend që del tej misionit të një dikasteri, brenda ekzekutivit, duke e konceptuar këtë institucion gati-gati si një garant për respektimin e Kushtetutës: “Ministria e Drejtësisë ka për qëllim të kërkojë respektimin e Kushtetutës, të ligjeve, realizimin dhe mbrojtjen e dinjitetit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore...”¹

Me pak fjalë Ministria e Drejtësisë është konceptuar si një lloj Gjykate Kushtetuese, që sipas nenit 124 të Kushtetutës garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj.²

¹ Shih nenin 5 të ligjit nr.8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”.

² Shih nenin 124 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë

Veç kësaj, nuk janë përcaktuar në mënyrë të qartë kompetencat e këtij institucioni dhe raportet e tij me gjyqësorin. Nga njëra anë Ministria e Drejtësisë, sipas nenit 5 të ligjit “bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë e saj me organet e pushtetit gjyqësor dhe me prokurorinë, duke respektuar parimin e ndarjes së pushteteve dhe të pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe të prokurorisë”, nga ana tjetër, ushtron funksione dhe ka kompetencë hartimin dhe ndjekjen e politikave, përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe ushtrimin e shërbimeve të nevojshme lidhur me sistemin gjyqësor, sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale a civile, sistemin e shërbimeve të lira juridiko-profesionale. Te kjo dispozitë konceptuale për kontrollin gjyqësor nuk flitet për kontroll ligjor e as për kontroll mbi administrimin e drejtësisë, por për ushtrimin e shërbimeve lidhur me sistemin gjyqësor etj.

2.MBI KONTROLLIN GJYQËSOR

Problemi i kontrollit mbi gjykatat e gjyqtarët është diskutuar gjatë dhe për këtë janë bërë përpjekje për të gjetur një qëndrim bashkëkohor. Ndryshe nga si konceptohej ky problem vite më parë, me Kushtetutën e re ky problem u harmonizua me disa parametra europianë.

Veprimtaria e gjykatave, ose e thënë ndryshe veprimtaria gjyqësore në përgjithësi, lidhet me dhënien e drejtësisë. Kjo përbën boshtin e veprimtarisë së gjykatave për ushtrimin e të cilës ato bazohen te Kushtetuta e ligji, por që i zbatojnë në mënyrë të pavarur nga çdo ndikim i të tjerëve. Në këtë veprimtari gjykatat kontrollohen vetëm nga institucionet brenda gjyqësorit dhe vetëm nëpërmjet shqyrtimit në shkallë më të larta të vendimeve të tyre, bazuar mbi ankimin ose rekursin konkret.

Nga ana tjetër, e parë më gjerë, veprimtaria e gjykatave përfshin edhe aspekte të një veprimtarie administrative që, ndonëse e lidhur me të parën, edhe dallon nga ajo, pasi ka të bëjë më tepër me administrimin ose me shërbimet e saj ndihmëse.

Nga këto aspekte natyrisht më i rëndësishëm është kontrolli mbi

vendimmarrjen ose dhënien e drejtësisë për të cilin ekziston një praktikë e konsoliduar e Gjykatës Kushtetuese, e cila duhet të gjej pasqyrim në legjislacionin e përpunuar.

Sipas nenit 16 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” vendimet gjyqësore mund të jenë objekt shqyrtimi vetëm mbi bazën e ankimeve ose rekurseve në rrugë gjyqësore, sipas përcaktimeve në kodet e procedurave ose në ligje të veçanta³. E thënë ndryshe, përmbajtja e kësaj dispozite ka përcaktuar vetëm dy rrugë nëpërmjet të cilave mund të bëhen objekt gjykimi vendimet e gjykatave. Kjo frymë e ligjit, që ka gjetur detajime të hollësishme në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit të Procedurës Civile është e lidhur ngushtë me dispozitën konceptuale kushtetuese, sipas së cilës “pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj”.

Për kontrollin gjyqësor, që është bërë objekt debati mbi kërkesa të paraqitura në Gjykatën e Lartë e më pas në Gjykatën Kushtetuese, kjo e fundit në disa vendime të saj ka krijuar praktikë, duke u shprehur se “Këshilli i Lartë i Drejtësisë, duke i hyrë vlerësimit të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së këtyre vendimeve gjyqësore, të dhëna nga kërkuesi në një kohë që këto kishin marrë formë të prerë, ka vepruar në kundërshtim me përmbajtjen e nenit 135 pika 1 të Kushtetutës.

Vendimet gjyqësore të formës së prerë, për çështjen konkrete që zgjidhin, kanë fuqinë e ligjit. Kjo do të thotë se për sa kohë ato nuk janë ndryshuar ose prishur nga një gjykatë më e lartë, asnjë organ tjetër shtetëror nuk mund të mospërfillë përmbajtjen e tyre dhe të ngarkojë me përgjegjësi gjyqtarin e

³ Shih nenin 16 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”

⁴ Neni 135 i Kushtetutës

çështjes”⁵. Me poshtë Gjykata Kushtetuese është shprehur: “Ky pushtet ushtrohet sipas parimit të kontrollit të vendimeve gjyqësore të gjykatave më të ulta nga gjykatat më të larta, prandaj asnjë organ tjetër, qoftë KLD-ja ose Ministria e Drejtësisë nuk kanë të drejtë të kontrollojnë e vlerësojnë bazueshmërinë në ligj të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të mospërfillin përmbajtjen e tyre e të ngarkojnë me përgjegjësi gjyqtarin e çështjes”⁶.

Ky është rregulli, sepse Gjykata Kushtetuese ka lejuar edhe një përjashtim, kur në vendimin e saj ajo është shprehur se “Megjithatë, problemi ndryshon në rastet kur këto vendime janë shoqëruar me shkelje që diskreditojnë rëndë pozitën ose figurën e gjyqtarit dhe që cenojnë, në përgjithësi, prestigjin dhe autoritetin e pushtetit gjyqësor. Në raste të tilla KLD-ja ka kompetenca të plota të marrë çdo lloj mase disiplinore ndaj gjyqtarëve, pa e kushtëzuar atë me faktin nëse kjo kategori vendimesh kanë marrë formë të prerë dhe kanë fituar autoritetin e gjësë së gjykuar. Madje, ndaj akteve të kësaj natyre, të kryera gjatë ushtrimit të detyrës, ai mund të reagojë në çdo kohë edhe kur nuk ka përfunduar shqyrtimi i çështjes...”⁷

Ky vendim është shoqëruar me të njëjtat argumente me vendime të mëvonshme, por pavarësisht nga këto, në praktikën e Ministrisë së Drejtësisë dhe të KLD-së ende vihen re raste që dëshmojnë për vlerësime negative të bëra nga inspektorët mbi vendime të formës së prerë. Ndonëse vendimi i parë është marrë më parë se Kuvendi të miratonte ligjin nr.9678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” dhe ligjin nr.8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, në të vërtetë, në këto dy ligje nuk është evidentuar ky qëndrim i Gjykatës Kushtetuese dhe as është reflektuar lidhur me të në praktikën e punës së përditshme.

⁵ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, nr.29, datë 30.04.2001

⁶ Po aty

⁷ Po aty

Pra, nga përmbajtja e vendimeve të lartpërmendura të Gjykatës Kushtetuese është zgjidhur një problem me shumë rëndësi, se kontrolli mbi legjitimitetin dhe bazueshmërinë e vendimeve gjyqësore mund të bëhet vetëm nga gjykata më e lartë, vetëm mbi bazën e ankimit ose të rekursit.

Veç kësaj, vlerësime negative e më pas masa disiplinore, lidhur me bazueshmërinë e vendimeve të formës së prerë, nuk mund të bëhen as nga inspektimi i KLD-së e as nga ai i Ministrisë së Drejtësisë, veç rasteve kur këto vendime janë shoqëruar me shkelje që diskreditojnë rëndë pozitën ose figurën e gjyqtarit dhe që cenojnë në përgjithësi prestigjin dhe autoritetin e pushtetit gjyqësor.

3. PËR KONTROLLIN MBI ADMINISTRIMIN E DREJTËSISË

Edhe në lidhje me kontrollin mbi administrimin e drejtësisë ka mjaft probleme me karakter ligjor dhe praktik. Fillimisht këtij problemi i ka bërë jehonë ligji nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” që ka përcaktuar se inspektorët e KLD-së ngarkohen të inspektojnë gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit, për të verifikuar ankesat e shtetasve dhe të institucioneve, organizimet e shërbimeve gjyqësore, të bëjnë evidentimin e aftësive profesionale të gjyqtarëve në kuptim të nenit 45 të tij, ngarkesën në punë dhe në tërësi, efikasitetin e gjykatave⁸. Ky problem është trajtuar disi ndryshe nga dy ligjet e tjera që janë miratuar më vonë. Kështu ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” pranon se Ministria e Drejtësisë kryen inspektime dhe procedimin disiplinor të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit.⁹ Idenë e inspektimeve e thellon më tej dhe e çon deri te gjyqtari edhe neni 11 i ligjit që përcakton se Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë autorizohet që të kryej inspektime në gjykata dhe gjyqtarë të veçantë.

⁸ Shih nenin 17 parag.II i ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”

⁹ Shih nenin 6 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”

Ndryshe është konceptuar ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”. Sipas nenit 1 të këtij ligji “KLD-ja është autoriteti shtetëror përgjegjës për mbrojtjen, emërimin, transferimin, shkarkimin, edukimin, vlerësimin moral e profesional, karrierën dhe për kontrollin e veprimtarisë së gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit”.¹⁰

Pa synuar për të qëndruar me hollësi për këto aspekte, për të cilat është konsideruar përgjegjës KLD-ja, e shohim me vend të nënvizojmë faktin se ai sipas kësaj dispozite, është përgjegjës edhe për kontrollin e veprimtarisë së gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit.

Por, pavarësisht nga si pranohet ky fakt më lart, dispozitat e tjera duket sikur nuk janë në harmoni me të parën, sepse neni 2 i këtij ligji, që përcakton detyrat që ka KLD-ja, nuk e përmend kontrollin mbi veprimtarinë e gjykatave ose të gjyqtarëve si një ndër detyrat e tij. Qëndrim tjetër mbahet në dispozita të tjera që trajtojnë detyrat e inspektoratit të KLD-së.¹¹

Pra, edhe kjo dispozitë nuk bën fjalë për kontroll të veprimtarisë së gjykatave dhe të gjyqtarëve, ashtu siç është konceptuar te dispozita e parë, por për verifikime. Për këto, inspektorati i tij ngarkohet që t’i verifikojë vetë ose t’i dërgojë Ministrisë së Drejtësisë për trajtime ankesat që kanë të bëjnë me mospërbushjen e rregullt të detyrës, si dhe të pranojë e të verifikojë ankesa të tilla që i vijnë nga Ministria e Drejtësisë, sepse Ministri i Drejtësisë ka çmuar se ato duhet të verifikohen nga ky inspektorat. Siç del nga përmbajtja e dispozitës, për verifikime të ankesave të tilla, secili organ ka të drejtë që ta kryej këtë detyrë vetë, ashtu siç ka të drejtë ta largojë nga vetja dhe t’ia dërgojë tjetrit.

Më ndryshe nga ato dispozita, neni 31 i ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 i njeh Ministrisë së Drejtësisë të drejtën të kryej inspektimin e gjykatave të

¹⁰ Shih nenin 1 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së”

¹¹ Shih nenin 16 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e KLD”

shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit për organizimin, punën e shërbimeve gjyqësore dhe administrimin gjyqësor.

Nga ky ballafaqim ligjesh dhe dispozitash që rregullojnë veprimtarinë e këtyre organeve kaq të rëndësishme, vërehet se ato në lidhje me kontrollin nuk janë harmonike, sepse te disa bëhet fjalë për verifikime, diku për inspektime e diku për kontroll mbi veprimtarinë e gjykatave ose të gjyqtarëve. Po ashtu, inkoherenca ekzistojnë edhe brenda tyre, për këtë problem, sepse përmbajtja e dispozitave konceptuale, që trajtojnë misionin ose qëllimin e ligjit, nuk është zbrërthyer në dispozita të tjera me vërtetësi e me korrektësi juridike.

Nga studimi i tyre duket se te këto ligje nuk është përdorur e njëjta teknikë legjislative dhe janë përzier problematikat e kompetencat e organeve të ndryshme, që shpesh dublojnë njëra-tjetrën. E themi këtë sepse në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së” ka dispozita që trajtojnë kompetencat e Ministrit të Drejtësisë ose se në ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” gjejmë dispozita që trajtojnë problematikë që nuk lidhet vetëm me atë pushtet.

Pirja për të dubluar veprimtarinë e disa institucioneve duket edhe te një kërkesë tjetër, lidhur me aftësimin profesional të gjyqtarëve. Fillimisht në nenin 45 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” është përcaktuar se KLD-ja bën vlerësimin e aftësive profesionale të gjyqtarëve për periudha kohe jo më të gjata se 2 vjet, duke u bazuar mbi disa kritere. Kjo dispozitë ka përcaktuar edhe mënyrën se si i komunikohet akti i vlerësimit gjyqtarit, si mund të ankimohet ai pranë KLD-së dhe si hetohet ky ankim nga KLD-ja.

Ky qëndrim ka gjetur pasqyrim edhe në pikën “dh” të nenit 16 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së”, sipas së cilës Inspektorati i KLD-së përgatit vlerësimin për aftësinë profesionale të gjyqtarit. Po ashtu, në këtë dispozitë është pasqyruar dhe e drejta e gjyqtarit për të paraqitur me shkrim opinionin e tij, por hollësitë e parashtruara lidhur me këtë ndryshojnë, sepse, ndërsa dispozita e ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit

gjqësori në Republikën e Shqipërisë” ka përcaktuar detyrimin e Inspektoratit për t’ia komunikuar vlerësimin gjyqtarit, duke i siguruar të drejtën për të paraqitur kundërshtimet e tij (të drejtën për t’u ankuar kundër aktit përfundimtar, si dhe procedurat e rregullat e shqyrtimit të ankimit); në fakt neni 16 i ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së” nuk i pasqyron këto hollësi, por vetëm që lejon Inspektoratin e KLD-së të përgatisë vlerësimin për aftësinë profesionale të gjyqtarit. Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” kundërshton të drejtën e Ministrisë së Drejtësisë për të bërë vlerësimin profesional, duke përcaktuar se “Ministri i Drejtësisë vë në dispozicion të grupeve të inspektimit specialistët e Ministrisë së Drejtësisë për të urdhëruar e ndihmuar në kryerjen e detyrave të mësipërme (është fjala për verifikimin e ankesave) me përjashtim të atyre që kanë të bëjnë me aftësitë profesionale të gjyqtarëve”.

Sa u parashtrua, nga këto dispozita me mjaft kundërshti nuk janë saktësuar e qartësuar disa probleme me rëndësi që janë:

1. Kontrolli mbi vendimet e formës së prerë si rregull nuk mund të ushtrohet as nga Inspektorati i KLD-së e as nga ai i Ministrisë.

2. Në ligjet që diskutohen, megjithëse flitet për kontroll, për inspektime ose për verifikime, nuk jepet kuptimi i secilës prej tyre, me qëllim që të parandalohet çdo veprim i papajtueshëm me konceptin kushtetues ose edhe me atë ligjor.

3. Paqartësi ka pasur në lidhje me kuptimin e shprehjes “organizim i shërbimeve gjyqësore dhe me efikasitetin e gjykatave”, prandaj ligji duhet të shprehet se çfarë duhet kuptuar me organizim të shërbimeve dhe efikasitetin gjyqësor.

4. Veç këtyre, mbetet e diskutueshme (problemi më i rëndësishëm për organin ligjvënës), përse duhet të ekzistojnë dy organe që bëjnë të njëjtën gjë, të bëjnë inspektime dhe verifikime mbi ankesa të ndryshme, për më tepër kur secili prej tyre nuk detyrohet ta bëjë verifikimin vetë, por lejohet që edhe t’ia dërgojë organit tjetër. Duke qenë kështu, është e domosdoshme që

të reflektohet në ligj qëndrimi i Gjykatës Kushtetuese që është shprehur se: “ekzistenca e inspektorateve që duket se dublojnë njëri- tjetrin, përcaktimi i qarte i nocioneve inspektim, kontroll, verifikim, evitimi i ndërthurjes se kompetencave midis dy inspektorateve lidhur me administrimin e drejtësisë e të shërbimeve, si dhe vendosjes së kufijve të qartë mbi kontrollin në gjykatat dhe gjyqtaret, janë disa çështje që kanë nevojë për rishikim dhe reflektim”¹².

4.TË PASQYROHET NË LIGJ PRAKTIKA E GJYKATËS KUSHTETUESE NË LIDHJE ME MASAT DISIPLINORE DHE TË DREJTËN E ANKIMIT NDAJ GJYQTARËVE E PROKURORËVE

Kushtetuta në nenin 147 ka përcaktuar se organi kompetent për shkarkimin e gjyqtarëve nga detyra është KLD-ja. Ai vendos, gjithashtu, edhe për masat disiplinore. Si shkak për shkarkimin e gjyqtarit, sipas Kushtetutës, janë: kryerja e një krimi, paaftësia mendore ose fizike, kryerja e akteve ose e sjelljeve që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, ose pamjaftueshmëria profesionale¹³. Nga përmbajtja e dispozitës kuptohet se rastet ose shkaqet e shkarkimit janë taksative dhe, duke qenë të tilla, nuk lënë hapësirë për ta zgjeruar kuptimin e Kushtetutës në legjislacionin përkatës.

Ky koncept kushtetues nuk ka gjetur pasqyrim me seriozitet në ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Neni 42 i tij bën fjalë për masat disiplinore. Sipas tij, për shkelje të disiplinës dhe akte e sjellje të tjera diskredituese, merren këto masa: vërejtje, vërejtje me paralajmërim, ulje në pagë deri në masën 25 për qind për një periudhë 3-6 muaj, pezullim nga detyra dhe kalim në një detyrë tjetër brenda gjykatës për një periudhë nga 6 muaj deri në një vit, transferim në një gjykatë tjetër dhe shkarkim nga detyra¹⁴.

¹² Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.11, datë 27.5.2004

¹³ Shih nenin 147 pika 6 të Kushtetutës

¹⁴ Shih nenin 42 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”

Pa nënvlerësuar përmbajtjen e nenit 43, sipas të cilit masat disiplinore ndaj gjyqtarëve merren nga KLD-ja në bazë të vlerësimit të llojit dhe të karakterit të shkeljes së kryer, nuk është vështirë për të kuptuar se shkarkimi nga detyra mund të merret për shkelje të disiplinës dhe për akte e sjellje të tjera diskredituese.

Sipas nenit 41 konsiderohen shkelje të disiplinës: kryerja e veprave që sipas ligjit janë të papajtueshme me funksionin e gjyqtarit, nxjerrja e sekretit të hetimit të dhomës së këshillimit ose të dhomave të tjera me karakter intim, zvarritjet e rënda ose sistematike në kryerjen e detyrës, mosrespektimi i rregullave të solemnitetit, mungesa pa arsye në punë, kryerja e veprimeve të paligjshme ose amorale brenda dhe jashtë kohës së punës, kryerja e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës ose moskryerja e veprimeve të detyrueshme procedurale, kur nuk përbën vepër penale ose moszbatimi pa arsye i masës së dhënë disiplinore.¹⁵

Duke ballafaquar përmbajtjen e dy dispozitave me frymën e Kushtetutës, vërehet se nuk dallohen rastet që konsiderohen si shkelje disiplinore, të cilat shërbejnë si shkak për shkarkimin nga detyra, me rastet e tjera, të cilat shërbejnë si shkak për marrjen e masave të tjera disiplinore.

Së dyti, lejohet shkarkimi i gjyqtarit nga detyra edhe për raste të tjera, veç atyre për të cilat bën fjalë në mënyrë taksative neni 147 (pika 6) i Kushtetutës.

Ndodhur para një situatë të tillë, në praktikë në disa raste janë shkarkuar nga detyra gjyqtarë të veçantë për shkaqe për të cilat nuk bëhet fjalë shprehimisht në Kushtetutë, por që trajtohen si të tilla nga ligji i lartpërmendur.

Kjo kontradiktë e ka shpjegimin e vet mbasë dhe në faktin se ligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” është miratuar në fund të vitit 1998, por është përgatitur para hyrjes në fuqi të Kushtetutës.

¹⁵ shih nenin 41 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”

Pas kësaj kohe, megjithëse janë vërejtur probleme e shqetësime rreth zbatimit të Kushtetutës dhe ligjit, këto nuk janë vlerësuar seriozisht dhe as nuk është menduar për të harmonizuar plotësisht ligjin e lartpërmendur me Kushtetutën.

Edhe për të drejtën që gëzon gjyqtari, ndaj të cilit është marrë një masë disiplinore për t'u ankuar në lidhje masën e dhënë ndaj tij, vihen re inkonsequenca që dëshmojnë për mosharmonizim të përmbajtjes së dy ligjeve. Kështu, sipas ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" gjyqtari, i shkarkuar nga detyra për një nga arsyet e parashikuara nga Kushtetuta, ka të drejtë të ankohet në Gjykatën e Lartë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit të KLD-së. Por, ndërsa kjo dispozitë i jep të drejtë gjyqtarit të ndëshkuar të ankohet vetëm kundër vendimit të shkarkimit, sipas nenit 34 të i ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së" ai mund të ankohet pranë Gjykatës së Lartë jo vetëm ndaj vendimit për shkarkimin nga detyra, por dhe për çdo masë tjetër me karakter disiplinor. Gjykata e Lartë parashtrroi para Gjykatës Kushtetuese pretendimet e saj për papajtueshmërinë me Kushtetutën të nenit 34.1 të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë" dhe Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar shprehjen "si dhe çdo masë tjetër me karakter disiplinor" të dispozitës së lartpërmendur duke arsyetuar se përmbajtja e saj përbën një tejkalim të dispozitës kushtetuese në dy drejtime: në aspektin e zgjerimit të masave të tjera disiplinore dhe në atë të tejkalimit të juridiksionit të Gjykatës së Lartë. Pra, sipas këtij vendimi, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë duhet të shqyrtojnë vetëm kërkesat për shkarkimin nga detyra e jo ato që kanë të bëjnë me masa të tjera disiplinore.

5. MBI TË DREJTËN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE PËR TË USHTRUAR ANKIMIM

Për këtë problem kontributet e Gjykatës Kushtetuese, se kundër masës së shkarkimit gjyqtarët kanë të drejtë të ankohen në Kolegjet e Bashkuara, kanë përvijuar më tej, duke u nisur nga përmbajtja e pikës 6 të nenit 147 të

Kushtetutës, sipas të cilit kundër vendimit të shkarkimit gjyqtarët mund të ankohen në Gjykatën e Lartë, e cila në këtë rast vendos në Kolegje të Bashkuara.

Para së gjithash, në praktikën e saj për këtë qëllim, Gjykata Kushtetuese ka përsëritur qëndrimin e saj të mëparshëm, sipas të cilit e drejta e prokurorëve për t'u ankuar buron nga Kushtetuta, e cila ndonëse nuk përcakton për prokurorët ndonjë procedurë të veçantë gjykimi, siç bën për gjyqtarët, nuk i përjashton ata nga e drejta për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të kundërshtuar aktet administrative sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, ashtu siç e kanë këtë të drejtë të gjithë personat e tjerë fizik e juridikë.¹⁶

- Së dyti, Gjykata Kushtetuese ka deklaruar se nga qëndrimi i lartpërmendur dhe sidomos nga përmbajtja e interpretimi i nenit 147/7 të Kushtetutës del se edhe gjyqtarët duhet të gëzojnë pa tjetër të drejtën e ankimit kundër vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

- Me tej, në lidhje me këtë problem, kjo gjykatë është deklaruar se vetë neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut nuk ndalojnë edhe për gjyqtarët të drejtën për të bërë ankim dhe në gjykatë, sepse e shohin të lidhur ngushtë me të drejtën për një proces të rregullt ligjor si një standard kushtetues bashkëkohor.

- Për këtë problem, Gjykata Kushtetuese nuk ka lënë pa përmendur dhe një fakt që ajo e ka përmendur si argument pro qëndrimin të saj, se në legjislacionin shqiptar në ligjin “Për shërbimin civil”, të drejtën për t'u ankuar e kanë të gjithë punonjësit e shërbimit civil konform dispozitave të Kodit të Procedurës Civile.¹⁷

Për sa më lart kjo gjykatë ka arritur në përfundimin se gjyqtarët duhet të gëzojnë të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës për t'u ankuar kundër masave disiplinore që merren ndaj tyre nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

¹⁶ Venidmi nr.38, datë 23.12.2003 i Gjykatës Kushtetuese

¹⁷ Vendimi nr.5. datë 13.6.2007 I Gjykatës Kushtetuese

Me këtë qëndrim ka lindur dhe një problem tjetër që kërkon zgjidhje, pasi, siç arsyetohet në vendimin e saj, nuk mund të luaj rolin e ligjvënësit, prandaj është ky i fundit që duhet të përcaktojë organin gjyqësor kompetent, ku duhet të ankohen gjyqtarët në raste të tilla.

Për të drejtën e prokurorëve për t'u ankuar paraqitet kjo situatë:

Në nenin 3 të ligjit për prokurorinë, në lidhje me masat disiplinore që merren ndaj prokurorëve, ligjvënësi ka mbajtur dy qëndrime të ndryshme që nuk mund të justifikohen ligjërisht e kushtetutshmërisht. Kështu, sipas pikës 1 të nenit të lartpërmendur, për masat disiplinore vërejtje, vërejtje me paralajmërim, pezullim nga detyra, që jepen nga Prokurori i Përgjithshëm lejohet e drejta e ankimit pranë Gjykatës së Apelit, ndërsa për masën e shkarkimit nga detyra që merret me dekret të Presidentit, prokurorët nuk kanë të drejtë të ankohen. Ky qëndrim ishte i paargumentuar e i papërligjur sepse për masa me të lehta disiplinore lejohej ankimi, ndërsa për një masë më të rëndë, si ajo e largimit nga detyra, nuk lejohej ankimi.

Mbi kërkesën Gjykatës së Shkallës së Parë të Skraparit, Gjykata Kushtetuese ka kontrolluar pajtueshmërinë e pikës 2 të nenit 34 të ligjit nr.8737, datë 12.2.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", sipas të cilit dekreti i Presidentit të Republikës për shkarkimin nga detyra është i paankimueshëm dhe ka vërejtur se përmbajtja e saj bie ndesh me Kushtetutën.

Gjykata Kushtetuese e ka pranuar se pika 2 e nenit 34 të ligjit të lartpërmendur binte ndesh me Kushtetutën. Për ato janë paraqitur për zgjidhje tri probleme, nëse e drejta kushtetuese e ankimit nuk mohohet tërësisht, por ajo për të njëjtin subjekt parcelizohet pa pasur asnjë bazë kushtetuese dhe, së fundi, nëse të drejtën e ankimit ligji e lidh me cilësitë e subjektit që merr masën.

- Si argument për këtë qëndrim ka qenë dhe fakti se prokuroria organizohet dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor, pranë gjyqtarëve, të cilëve Kushtetuta në nenin 147 të saj ua lejon ankimin.

Në këtë vendim vihet theksi në disa argumente të tjera me karakter juridik që janë:

a. E drejta e ankimit pranohet si e drejtë themelore edhe nga Konventa Evropiane për të Drejtat e njeriut (neni 13) dhe ushtrimi i kësaj të drejte është i pakufizuar.

b. Kufizimi i kësaj të drejte për një kategori të caktuar zyrtarësh nuk mund të argumentohet as me përmbajtjen e nenit 17 të Kushtetutës që lejon një gjë të tillë vetëm kur një qëndrim i tillë bëhet për të mbrojtur një interes publik ose për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve.

c. Një fakt tjetër me rëndësi, që mendoj se pati rëndësi e ndikim në lidhje me këtë qëndrim, ishte ai që kishte të bënte me një vështrim historik, sepse në ligjin “Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese” që ishte në fuqi para Kushtetutës së tanishme, lejohej e drejta e ankimit kundër vendimeve të KLD-së për shkarkimin nga detyra¹⁸.

6. TË NDRYSHOHET LIGJI “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E MINISTRISË SË DREJTËSISË” DHE PËR RAPORTET ME PROKURORINË

Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” në nenin 5 bën fjalë për misionin e saj. Atje janë përcaktuar rregullat për organizimin, funksionimin dhe fushat e veprimtarisë së saj dhe pranohet, gjithashtu, se Ministria e Drejtësisë ka në kompetencë ushtrimin e shërbimeve të nevojshme lidhur me sistemin gjyqësor etj.

Veç kësaj, Ministria e Drejtësisë, mbështetur te Kushtetuta, duke respektuar parimet e ndarjes së pushteteve, të pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe të Prokurorisë, mbështet, bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë e saj me organet e pushtetit gjyqësor dhe Prokurorinë¹⁹.

¹⁸ Vendimi nr.38, datë 23.12.2003

¹⁹ Shih nenin 5 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”

Duke mbetur vetëm te përmbajtja e kësaj dispozite, Ministria e Drejtësisë së pari ushtron shërbimet e nevojshme në lidhje me sistemin gjyqësor, nga ana tjetër ajo bashkërendon punën me këto organe.

Në të vërtetë, nga përmbajtja e dispozitave të tjera që trajtojnë drejtime të tjera të veprimtarisë së këtij institucioni, vërehet se Ministri i Drejtësisë “vishet” me attribute shumë më të mëdha, të cilat është vështirë të thuash se mund të jenë përfshirë brenda përmbajtjes së dispozitës që lidhet me misionin e Ministrisë së Drejtësisë dhe aq më tepër me frymën e Kushtetutës për organin e Prokurorisë.

Ja disa prej tyre:

Sipas nenit 6 pika 10 e këtij ligji, Ministri i Drejtësisë kontrollon organin e Prokurorisë dhe raporton te Presidenti i Republikës dhe në Kuvend rreth saj.

Nga ballafaqimi i përmbajtjes së pikës 3 të nenit 5, lidhur me misionin e Ministrisë së Drejtësisë, ku flitet për bashkëpunim dhe bashkërendim të veprimtarisë së këtij organi me organet e pushtetit gjyqësor dhe nenit 6 pika 10, ku flitet për kontroll sipas ligjit për organin e Prokurorisë, është vështirë të pranosh se këto dy koncepte, që gjejnë pasqyrim në dispozitat e përmendura²⁰, harmonizohen me njëra-tjetrën.

Në të vërtetë duket qartë se ato kundërshtojnë njëra-tjetrën, sepse bashkërendimi dhe bashkëpunimi ndërinstitucional nënkupton njohjen e pavarësisë së njëri-tjetrit. Së dyti, kontrolli nënkupton së paku vartësi, në mos në tërësi, së paku në drejtime ose aspekte të caktuara të njërit organ nga tjetri. Veç kësaj, neni 12 pika 3 shkronja “c” duke e çuar më tej idenë e kontrollit mbi Prokurorinë e thellon atë më tej, duke i dhënë të drejtë Drejtorisë së Përgjithshme të Çështjeve të Drejtësisë që të kontrollojë dhe të përgatisë rekomandime për Ministrinë e Drejtësisë lidhur me çështjet objekt inspektimi.

Përmbajtja e dispozitave të lartpërmendura duket sikur paraqet probleme kur e ballafaqojmë atë me përmbajtjen e nenit 148 të Kushtetutës ku është

²⁰ Shih nenin 6 pika 1 të tij.

përcaktuar se Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson çështjen në gjyq në emër të shtetit ose se në ushtrimin e kompetencave të tyre prokurorët u nënshtrohen Kushtetutës e ligjeve. Për natyrën e karakterin e këtij organi me rëndësi është dhe praktika e Gjykatës Kushtetuese, e cila duke interpretuar Kushtetutën dhe ligjin për Prokurorinë ka pranuar për disa aspekte të rëndësishme për këtë organ, si vijon: Prokuroria është organ me pavarësi të plotë në ushtrimin e funksioneve, duke iu nënshtuar vetëm Kushtetutës dhe ligjeve, objekti dhe fusha e veprimit të komisioneve hetimore duhet të respektojë parimet kushtetuese dhe normat e të drejtës ndërkombëtare, duke mos cenuar pavarësinë dhe duke mos penguar veprimtarinë e organeve të tjera.²¹

Sipas Kushtetutës, duket qartë se Prokuroria nuk është konceptuar si organ ose si pjesë e ekzekutivit, por organizohet dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor si organ i centralizuar dhe, mbi të gjitha, prokurorët në ushtrimin e kompetencave të tyre i nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve.

Ky qëndrim është mbajtur edhe në ligjin për Prokurorinë, si dhe në Kodin e Procedurës Penale. Bazuar në urdhërimet e Kodit të Procedurës Penale urdhrat dhe udhëzimet e prokurorit më të lartë janë të detyrueshme për prokurorët më të ulët. Veç kësaj, prokurori më i lartë ka të drejtë të vendosë ndryshimin ose shfuqizimin e vendimeve të marra nga prokurori më i ulët, me përjashtim të rasteve kur ligji procedural ia njeh gjykatës.²² Në shumë aspekte veprimtarinë e organit të Prokurorisë, për çështje konkrete, konform Kushtetutës e dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, e kontrollojnë gjykatat. Duke qenë kështu, mund të dyshojmë se dispozitat e ligjit për Ministrinë e Drejtësisë, për ushtrimin e kontrollit mbi organin e Prokurorisë, duken si të papajtueshme me frymën e Kushtetutës sonë, prandaj duhet të

²¹ Vendimi Gjykatës Kushtetuese nr.26, datë 4.12.2006

²² Neni 24 i Kodit të Procedurës Penale

rishikohen gjatë kohës që do të përpunohet legjislacioni në kuadër të reformës për drejtësinë.

7. TË PLOTËSOHET DHE TË PËRSOSET LIGJI QË RREGULLON ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KLD-SË DHE ZGJEDHJEN E ANËTARËVE NGA KONFERENCA GJYQËSORE.

Kushtetuta në nenin 147 përcakton numrin e anëtarëve të KLD-së, mënyrën e zgjedhjes së tyre, afatin për të cilin ata zgjidhen etj.

Për zgjedhjen e anëtarëve të KLD-së dispozita saktëson se 9 gjyqtarët e të gjitha niveleve zgjidhen nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare.²³ Kjo, para se të realizojë këtë kompetencë nëpërmjet hallkave të saj, bën seleksionimin e kandidaturave që plotësojnë kushtet për t'u zgjedhur si anëtarë të KLD-së. Konferenca Gjyqësore, pasi merr sigurinë se kandidaturat e paraqitura para saj plotësojnë kushtet për t'u zgjedhur si të tillë, voton për secilin prej tyre, mbështetur në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i cili ka përcaktuar se anëtarët e KLD-së që zgjidhen nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare duhet të jenë gjyqtarë me jo më pak se 10 vjet në profesion. Në këtë ligj përcaktohet se afati i qëndrimit në detyrë për anëtarët e KLD-së fillon nga data e zgjedhjes së tyre. Por me kaq ky proces sipas ligjit nuk mund të quhet përfundimtar.

Pas zgjedhjes së anëtarëve që plotësojnë vendet vakante, në mbledhjen e tij më të afërt KLD-ja zgjedh një komision të përbërë prej tre anëtarësh, për të verifikuar zgjedhjen ose papajtueshmërinë (në ushtrimin në përputhje) me ligjin të detyrës së anëtarit të KLD-së.

Ky komision, që verifikon mandatet, i paraqet KLD-së raportin me prova dhe argumente ligjore për pajtueshmërinë me ligjin të procesit të zgjedhjes ose të papajtueshmërisë. Në përfundim, ai i paraqet KLD-së propozimet konkrete përkatëse.

²³ Shih nenin 147-1 i Kushtetutës

KLD-ja, kur vëren se zgjedhja dhe qëndrimi në detyrë i anëtarit të KLD-së nuk është në përputhje me ligjin, me vendim të arsyetuar pezullon ushtrimin e mandatit dhe i kërkon, sipas rastit, Konferencës Gjyqësore Kombëtare ose Kuvendit zhvillimin e zgjedhjeve të reja.

Kjo zgjidhje duket se është e diskutueshme.

Së pari, Kushtetuta ka përcaktuar se organet që i zgjedhin anëtarët e KLD-së janë Kuvendi ose Konferenca Gjyqësore Kombëtare. Ajo nuk ka vendosur asnjë rregull për verifikimin e mandateve, por këtë e ka vendosur ligji.

Së dyti, një komision prej tre anëtarësh e më pas një vendim i KLD-së pezullon një vendim të Konferencës Gjyqësore Kombëtare.

Së treti, ligji përcakton se KLD-ja pezullon ushtrimin e mandatit dhe kërkon zhvillimin e zgjedhjeve të reja, por nuk përcakton se kush duhet ta anulojë atë mandat e me çfarë procedure. Kjo ka ngjallur debate rreth faktit nëse mund të zgjidhet një anëtar tjetër, pa u anuluar mandati i fituar, ushtrimi i të cilit tashmë është pezulluar. Pra, në një kohë kur nuk është zgjidhur përfundimisht “fati” i mandatit të anëtarit të zgjedhur nga konferenca, lejohet të bëhen zgjedhje të reja.

Me pas lindin dhe pyetje të tjera që kanë të bëjnë me ballafaqimin e kompetencave të dy organeve: Konferencës Gjyqësore Kombëtare dhe të KLD-së, që verifikojnë plotësimin e kriterëve për zgjedhjen e anëtarëve të KLD-së. Veç këtyre, ligji nuk bën fjalë për të drejtën e të interesuarit, për të bërë ankim kundër vendimit të KLD-së, ashtu siç nuk bën fjalë për procedurat që duhen të ndiqen kur zëvendësohen njëherësh disa anëtarë të saj, siç nuk sqarohet se cili anëtar i porsazgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare duhet të marrë pjesë në diskutimin e votimin rreth raportit të komisionit, që verifikon mandatet e kolegëve të tij që sapo janë zgjedhur nga Konferenca.

Së katërti, për të përcaktuar më saktësisht raportet midis Ministrisë së Drejtësisë dhe gjykatave e gjyqtarëve, të harmonizojë konceptet që kanë të

bëjnë me termat: inspektim, shërbim gjyqësor, administrim i drejtësisë, verifikim kërkesash, efikasitet e gjyqtarëve, kontroll etj. Po ashtu, duhet të shmangen përsëritjet pa vend në ligje të ndryshme, por edhe të ligje të veçanta.

Së pesti, nisur nga shumë rrethana e faktorë kushtetues, ligjorë, politikë, ekonomik etj., Kuvendi duhet të diskutojë e vendosë nëse do të lejojë që institucionet e ndryshme të dublojnë njëra-tjetrën me organe inspektimi e verifikimi, me të drejtën për të angazhuar njëra-tjetrën dhe për të çmuar nëse e drejta e nismës për procedimin disiplinor të mbetet te njëri organ dhe te cili prej tyre.

Mbi bazën e një kërkesë të paraqitur para saj, Gjykata Kushtetuese ka vërejtur se “Këshilli i Lartë i Drejtësisë në datën 31.1.2004, në zbatim të neneve 9 e 10 të ligjit nr.8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, ka proceduar në verifikimin e mandateve të 5 (pesë) anëtarëve të rinj të zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare. Me vendimin nr.151/1, datë 31.01.2004, Këshilli i Lartë i Drejtësisë konstaton se katër anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë janë zgjedhur në përputhje me ligjin, ndërsa përse i përket kërkuarit, është konstatuar dhe çmuar se zgjedhja e tij është bërë në kundërshtim me nenin 4, paragrafi i parë i ligjit të lartpërmendur, për arsye se ai ka ushtruar detyrën e gjyqtarit për më pak se 10 (dhjetë) vjet. Prandaj, Këshilli i Lartë i Drejtësisë i ka kërkuar Konferencës Gjyqësore Kombëtare zhvillimin e zgjedhjeve të reja.”

* * *

Për sa kemi parashtruar, për problemet konkrete të përmendura, por edhe për shumë të tjera që mund të vërehen, mendojmë se është e nevojshme që Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet organizmave që kanë të drejtën për ta vënë në lëvizje atë, duhet të bëjë objekt diskutimi e debati ligjet e lartpërmendura, të grupuara në formë të një pakete dhe t’u japë zgjidhje disa problemeve.

Së pari, të shmangë çdo keqkuptim për papajtueshmëri me Kushtetutën të dispozitave të ndryshme, duke i harmonizuar ato me të.

Së dyti, të harmonizohen, te secili ligj konkret, dispozitat që trajtojnë qëllimin ose misionin e ligjit (ose të institucionit) me dispozitat vijuese që i zbërthejnë ato.

Së treti, të reflektojë në ligjet përkatëse praktikën e Gjykatës Kushtetuese në këto dhe në të tjera drejtime.

Gjykata Kushtetuese ka arritur në përfundimin se vendimi i KLD-së nuk është përfundimtar, duke iu referuar përmbajtjes e kuptimit të dispozitave kushtetuese dhe veçanërisht nenit 147 të Kushtetutës, si dhe dispozitave të ligjit nr.8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”. Duke shqyrtuar raportet kushtetuese e ligjore midis Konferencës Gjyqësore Kombëtare dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Gjykata Kushtetuese ka arritur në përfundimin se Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka në rastin e dhënë, në kuptim të nenit 10 të ligjit, vetëm të drejtën e pezullimit të ushtrimit të mandatit dhe të kërkimit të zgjedhjeve të reja.

Si përfundim, Gjykata Kushtetuese ka pranuar se “Në këto kushte, kur Vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë nuk është përfundimtar, lidhur me të drejtën e kërkuesit për të qenë anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ajo e gjen kërkesën e paraqitur jashtë juridiksionit të saj të përcaktuar nga dispozitat kushtetuese, sepse shqyrton vetëm mbi kushtetutshmërinë e vendimeve përfundimtare. Edhe pse kërkesa është drejtuar për një proces të parregullt ligjor, përderisa ajo është e lidhur pazgjidhshmërisht me aktin objekt konflikti kushtetues, është e domosdoshme që ai të jetë përfundimtar”²⁴.

Sipas logjikës dhe argumentit të sipërpërmendur duhet të arrijmë në përfundimin se në raste të tilla është Konferenca Gjyqësore Kombëtare ajo që duhet të thotë fjalën e saj të fundit për mandatin që ka pezulluar Këshilli

²⁴ Shih vendimin nr.5, datë 11.3.2004

i Lartë i Drejtësisë. Për pasojë, vetëm nëse ajo e anulon mandatin në fjalë, mund të zhvillohen zgjedhje të reja. Si veprohet kur ajo nuk bindet për një gjë të tillë? Këtë përgjigje duhej të jepte ligji, i cili duhet të autorizonte një organ gjyqësor për ta shqyrtuar atë problem mbi bazën e gjyqtarit të interesuar. Pra, edhe ky problem duhet të gjejë zgjidhjen e vet në ligjin përkatës.

Sistemi zgjedhor ndërmjet kushtetutshmërisë dhe politikës

Sokol SADUSHI
Anëtar i Gjykatës Kushtetuese

Gjatë hartimit të një kushtetute, një filozofi politike e caktuar gjen shprehjen dhe realizimin e vet fillestar në dispozitat e saj. Mirëpo, pas miratimit të këtij akti themelor, partitë politike, si bartëse e flamurtare të kësaj filozofie, arrijnë të ndërgegjësohen se sa e kanë kufizuar vetveten, nëpërmjet ngritjes së barrierës të *kushtetutshmërisë*, parim i cili formulon për çdo subjekt, për çdo institucion politik, madje edhe për vetë krijuesin e saj kërkesën për nënshtrim ndaj saj.

Kjo lloj autonomie, me të cilin vishet kushtetutshmëria përballë interesave momentale të politikës, krijon një konflikt ndërmjet tyre, i cili nuk mund të vazhdojë pafundësisht. Përvoja e konstitucionalizmit ka dëshmuar për ekzistencën edhe të disa zgjidhjeve, të dallueshme njëra nga tjetra, por që në të vërtetë të shpien në pajtueshmërinë midis kushtetutshmërisë dhe politikës.

Aspekti i parë i kësaj pajtueshmërie shprehet me nënshtrimin e politikës së momentit ndaj rregullave afatgjatë të kushtetutës. Kjo zgjidhje, që është karakteristike e demokracive të zhvilluara, imponon një kushtetutshmëri të stabilizuar dhe autoritare. Zgjidhja e dytë, që shmang konfliktin dhe që është e përhapur kryesisht në vendet në tranzicion, është nënshtrimi i kushtetutshmërisë ndaj politikës, ç'ka sjell njëkohësisht dhe ndërhyrjet me ndryshime të shpeshta të ligjit themelor të shtetit. Mënyra e interpretimit të normës kushtetuese dhe përpunimi i mëtejshëm juridik i saj kanë qenë dhe

mbeten zgjidhje të rëndësishme për harmonizimin e raporteve ndërmjet kushtetutshmërisë dhe politikës dhe që shpesh herë kanë shërbyer si mjete përcaktues për kapërcimin e konfliktit midis tyre.¹

Studiuesit ndahen në grupe sipas pikëpamjes që ata mbështesin për zgjidhjen e marrëdhënies konfliktuale që krijohet ndërmjet kushtetutshmërisë dhe politikës. Si studiues, i lejoj vetes të përfshihem në grupin e atyre që mbrojnë idenë e zhvillimit dhe të përsosjes së jurisprudencës nëpërmjet përdorimit të interpretimit kushtetues si instrument i frytshëm dhe shumë i rëndësishëm për zgjidhjen e krizave, në dallim nga amendamenti kushtetues, që cilësohet, nga shumica e studiuesve, si instrument i skajshëm dhe i zbatueshëm vetëm në ato raste kur nuk ka asnjë mjet tjetër për të zgjidhur konfliktin.

Personalisht, nuk jam i mendimit se çdo kërkesë e re për ndërhyrje me përmasa kushtetuese duhet përmbushur domosdoshmërisht nëpërmjet rishikimit të tekstit të Kushtetutës, por mbështes idenë e zhvillimit të doktrinës zyrtare, që mbetet një funksion kryesor i drejtësisë kushtetuese. Ajo kushtetutë që vazhdon të mbijetojë falë ndryshimeve të herëpashershme dhe të pastuduara ka prirjen të shndërrohet në një ligj të zakonshëm.

Nisur nga vendi që kushtetuta zë në hierarkinë e normave, nga konsiderimi i saj si ligji themelor i shtetit, nga vendosja e barrierave normative të forta për amendimin e pareshtur të saj, edhe ndërhyrjet për ndryshim, pa u mbështetur mjaftueshëm në motive ligjërish të justifikuara, vështirësohen.

Kushtetuta, si ligji më i lartë i shtetit, është dhe duhet të jetë një akt i qëndrueshëm. Stabiliteti i kushtetutës është një vlerë e madhe kushtetuese, një nga parakushtet e vazhdimësisë së shtetit dhe të respektimit të rendit kushtetues e ligjor. Nga kjo pikëpamje, interpretimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i doktrinës kushtetuese, në përputhje me kushtet përherë në ndryshim të shoqërisë, nxjerr në pah potencialin dhe vlerat që mbart në vetvete kushtetuta, si dhe siguron stabilitetin e tekstit dhe jetëgjatësinë e saj.

¹ Saliu, Kurtsh. E drejta Kushtetuese, Prishtinë 2004.

Pikëpamjet dhe qëndrimet për stabilitetin e kushtetutës nuk mund të shërbejnë për t' u bërë pengesë rrethanave që e imponojnë domosdoshmërisht rishikimin e saj. Një kushtetutë e brishtë që jep mundësi dhe krijon hapësira për ndërhyrje në tekstin e saj, do të krijonte premisa për t' i hequr përmbajtjen nocionit për kushtetutën. Nga ana tjetër, ashpërsia dhe ngurtësia e tepruar mbart rrezikun e prishjes së ekuilibrave institucionalë. Nëse kuptohet qartësisht se ndryshimet në kushtetutë kryhen me hapa të matur, të kujdesshëm dhe thellësisht të motivuar, për rrjedhojë, shumë më të vështirë se ndryshimet në legjislacionin e zakonshëm, një ngurtësi e këtyllë nuk duhet të shkojë deri atje sa të krijojë një bllokim të panevojshëm e të rrezikshëm të institucioneve.²

E rëndësishme për një kushtetutë moderne është që rruga për rishikimin e saj të mbetet e hapur në mënyrë të arsyeshme. Këtë vizion kanë pasur edhe hartuesit e Kushtetutës, të cilët sanksionuan një procedurë të rreptë për rishikimin e saj, me qëllim që, nga njëra anë, ta mbrojnë atë nga ndryshimet e shpeshta e të panevojshme dhe, nga ana tjetër, të mos ngrenë barriera të pakapërcyeshme për rishikimin e saj.

* * *

Çështja kryesore e ditës, që evidenton në të njëjtën kohë dhe ekzistencën e mospërputhjes midis kushtetutshmërisë dhe politikës, është fokusuar te sistemi zgjedhor. Pikërisht ky konflikt ndërmjet tyre imponon gjetjen e zgjidhjeve, që të jenë jo vetëm sa më të drejta, por dhe afatgjata.

Gjatë punës përgatitore për hartimin e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, një ndër çështjet e debatueshme lidhej pikërisht me ngritjen ose jo deri në nivelin kushtetues të sistemit zgjedhor. Parashikimi i drejtpërdrejtë si normë kushtetuese i sistemit zgjedhor mendohej se do të mënjanonte prirjen paszgjedhore të politikës për ndryshim të sistemit ekzistues, si dhe do të krijonte më shumë garanci për qëndrueshmërinë e tij.

² Duhamel, Olivier. "E Drejta Kushtetuese-Demokracitë", Logosa.

Një ngurtësim i këtyllë i sistemit zgjedhor, nëpërmjet sanksionimit të tij në një normë kushtetuese, ka nxitur në vijimësi aktorët politikë që, për pamundësi të ndryshimit të Kushtetutës, të përqendrojnë vëmendjen në gjetjen e zgjidhjeve të momentit, nëpërmjet amendimit të pashtrur të dispozitave të Kodit Zgjedhor.

Pavarësisht nga lloji i sistemit zgjedhor, të sanksionuar në ligjin themelor të shtetit, gjatë këtij dhjetëvjeçari kushtetues, në çdo prag zgjedhesh parlamentare ose vendore është bërë ndërhyrje, për të ndryshuar Kodin Zgjedhor në disa çështje mjaft thelbësore që përmbanin edhe një dimension kushtetues. Pra, nëse mendohej se amendimi i Kushtetutës ishte i vështirë për t'u bërë, për shkak të rregullave rigoroze për rishikimin e saj, nuk vështirësohej situata për aktorët politikë që të eksperimentonin mbi ligjin zgjedhor. Ajo që ka ndodhur në të vërtetë është se amendimet ligjore kanë shkuar aq larg sa është debatuar se mund të kenë tejkaluar ndonjë element thelbësor kushtetues të sistemit zgjedhor.

Në Kodin Zgjedhor, që u zbatua për zgjedhjet parlamentare të vitit 2001, parashikohej votimi me dy raunde zgjedhore, pranohej zbatimi i listave shumëmemërore të pandryshueshme (lista të bllokuara, të mbyllura), lejohej që numërimi i fletëve të votimit të kryhej pranë çdo qendre votimi, Gjykata Kushtetuese shndërrohej në një gjykatë fakti, duke ia imponuar asaj dhe vetëm asaj verifikimin e rasteve të pavlefshmërisë së zgjedhjeve etj.

Një situatë krejt e ndryshme ligjore u paraqit në prag të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2005. Nga aktorët politikë u mendua se çelësi për arritjen e një progresi në zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike ishte amendimi rrënjësor i dispozitave të Kodit Zgjedhor. Nëpërmjet konsensusit politik dhe arritjes së shumicës së cilësuar kushtetuese (prej 3/5) u ra dakord të shmangej zhvillimi i zgjedhjeve me dy raunde zgjedhore, pavarësisht se vetë raundi përbën një element kushtetues përcaktues për llojin e sistemit zgjedhor, i parashikuar në nenin 64 të Kushtetutës dhe, për të cilin, mbetej e diskutueshme nëse mund të zhvendosej aq lehtësisht nëpërmjet normimit të tij në dispozitat e një ligji të posaçëm.

Sanksionimi ligjor i listave shumemërore të hapura, të cilat e ndryshonin renditjen përfundimtare të kandidatëve, falë ekzistencës së marrëveshjes së subjektit zgjedhor, shqyrtimi i ankimeve zgjedhore nga një kolegji zgjedhor pranë Gjykatës së Apelitit të Tiranës, ndërkohë që neni 131, shkronja “e” i Kushtetutës pranonte kompetencën e Gjykatës Kushtetuese për verifikimin e zgjedhjes së deputetëve, përfshirja e partive politike me një rol përcaktues në procedurat kushtetuese të zgjedhjes së anëtarëve të KQZ-së, mosnumërimi i votave nga komisionet e qendrave të votimit, por nga grupet e numërimit në mjedise publike etj., përbënin disa nga risitë e këtij sistemi zgjedhor që komentoheshin si një shpërfytyrim, pavarësisht sanksionimit të tij drejtpërsëdrejti në Kushtetutë.

Pra, stabiliteti me të cilin vishej sistemi zgjedhor, duke e ngritur qëllimisht në rangun e një norme kushtetuese, formati që tashmë kishte marrë Kushtetuta, që sipas doktrinës klasifikojë në “kushtetutat e forta”, nuk arritën të parandalonin dhe të mënjanonin vrullin e aktorëve politikë që me pretendimin e arritjes së standardeve për zgjedhje të lira e demokratike, eksperimentonin të tjera amendime të Kodit Zgjedhor. Zgjedhjet përfundonin dhe menjëherë pas nxjerrjes së rezultatit përfundimtar, vetë aktorët politikë kontestonin legjislacionin dhe hidhnin ide “të reja” për një tjetër reformë zgjedhore.

Që pas zhvillimit të zgjedhjeve të fundit parlamentare, kushtetutshmëria dhe politika ndodhen përpara të njëjtës situatë konfliktuale ndërmjet tyre. Dhe ja disa nga arsyet e kësaj situatë:

- Për shkak të parregullsive të rënda që kanë shoqëruar deri më tash tërë proceset zgjedhore,
- për arsye të keqadministrimit shumë problematik të tyre,
- për mosnjohje të rezultatit të zgjedhjeve menjëherë pas përfundimit të tyre,
- për zgjatje të tejskajshme të procedurave ligjore të ankimeve administrative dhe gjyqësore,

- për arsye të mospasjes së një rezultati të drejtë dhe korrekt për të lexuar objektivisht votën nëpërmjet përfaqësimit zgjedhor të çdo subjekti zgjedhor (*i ashtuquajtur* “*Fenomeni Dushk*”),

- për shkak të kritikave të vazhdueshme nga organizmat ndërkombëtarë, të adresuara ndaj autoriteteve shtetërore, aktualisht, e gjithë vëmendja politike, juridike dhe mediatike është e përqendruar tek “*e keqja e madhe*” që i vjen Shqipërisë nga ky sistem zgjedhor. Pra, duket se jemi para përsëritjes së të njëjtit ritual, ku shkak për mospërbushjen e standardeve demokratike në zhvillimin e zgjedhjeve nuk kërkohet në administrimin e procesit, por në llojin e sistemit zgjedhor.

* * *

A ËSHTË VËRTET PROBLEMATIK SISTEMI ZGJEDHOR SHQIPTAR?

Sistemit zgjedhor të pranuar nga Kushtetuta i janë vënë etiketime dhe emërtime të ndryshme. Ai ka marrë emrin e një sistemi *proporcional të personalizuar*, duke iu referuar sistemit gjerman, i cili duket se ka shërbyer si pikënisje për formalizimin e nenit 64 të Kushtetutës, por, për të qenë i saktë, mendoj se ky cilësim ndryshon, madje jo pak, nga sanksionimi i tij në Kushtetutë. Fakti që modeli i ndjekur nuk është saktësisht ai gjerman, përbën ndoshta një problem që ka të bëjë me teknikën jokorrekte të mënyrës se si hartohet legjislacioni.

Numri i kufizuar i deputetëve (140), pra, ajo që rëndom emërtohet si “*tavan*” dhe pragu zgjedhor prej 2.5 përqind nuk e lejojnë sistemin zgjedhor shqiptar që të etiketohet si proporcional dhe aq më pak si sistem i pastër gjerman. Numri 40 i vendeve në Kuvend, që shpërndahen sipas listës shumë-mërore, kundrejt 100 vendeve të zonave një-mërore, nuk arrin të barazojë numrin e votave të vlefshme të marra prej partive me numrin e përgjithshëm të deputetëve. Mënyra e votimit, më pak proporcionale sa

thuhet, por më shumë mazhoritare sa besohet, nxit një strukturë mazhoritare të zgjedhësve. Pikërisht, kjo karakteristikë e mënyrës së votimit sipas këtij sistemi zgjedhor ka detyruar kushtetutëbërësit që në dispozitën përkatëse ta specifikojnë atë me frazën “*në raport sa më të afërt*”.

Këtë përfundim për emërtimin e sistemit ka pranuar edhe Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj, e cila është shprehur se “...komponentët përbërës e karakterizojnë këtë sistem zgjedhjesh si të përzier (miks) si me elemente të sistemit mazhoritar, ashtu edhe të atij proporcional... Duke dhënë nocionin e raportit sa më të afërt dhe jo atë të raportit saktësisht të barabartë, Kushtetuta ka parasyrsh që sistemi i zgjedhjeve, i pranuar prej saj, nuk është proporcional, por i kombinuar me zgjedhjet mazhoritare në 100 zonat, nga të cilat jo vetëm del shumica e mandateve të Kuvendit, por mund të përcaktohen edhe drejtpërdrejt partitë fituese.”³

Për etiketimin e sistemit zgjedhor janë përdorur edhe emërtime të tjera, si ai i një sistemi *mazhoritar të proporcionalizuar*,⁴ ose si sistem me një *proporcionale të mazhoritarizuar*, për ta afruar me atë gjerman.

Qëllimi në këtë punim nuk është nxjerrja në pah e vlerave ose e defekteve, si të sistemit zgjedhor që ka njohur Kushtetuta, ashtu edhe të llojeve të ndryshme të sistemeve që zbatohen në demokracitë e sotme moderne. Shpreh dyshimin në gjykimin tim se çdo sistem zgjedhor që na serviret si më i përshtatshëm, vjen më tepër si orvatje për të kënaqur interesat partiakë të çastit dhe jo si rrjedhojë e një analize të thelluar e të saktë shkencore, për të përputhur zbatimin e sistemit me faktorë të tillë të rëndësishëm si tradita, kultura zgjedhore, mendësia, emancipimi i shoqërisë etj. Nëse një pohim i këtillë rezulton të jetë i vërtetë, duhet të theksoj se ky pozicion është shumë shqetësues për të ardhmen e një demokracie që kërkon të konsolidohet.

³ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të RSH, nr. 49, datë 2.6.2001.

⁴ Ibrahim, Gent. “Sistemi zgjedhor dhe stabiliteti në qeverisje”, botuar në revistën “E drejta Parlamentare dhe politikat ligjore”, nr. 6/2005.

Diskutimet e shumta të bëra nga koha e hartimit të Kushtetutës dhe në vijimësi gjatë këtyre viteve, janë fokusuar kryesisht në dy tipet bazë të sistemeve zgjedhore: në sistemin proporcional dhe në atë mazhoritar, me të gjitha format e përziera që ato shfaqen. Pikëpamjet e ithtarëve të të dy sistemeve përplasen midis vlerave dhe dyshimeve që ato shpalosin për secilin prej tyre.

Proporcionali është pranuar si sistemi që prodhon ndjeshëm përfaqësimin, por jo qeverisjen e qëndrueshme. Votimi proporcional, sidomos ai rajonal, e bën më të dukshme përfaqësimin kombëtar, formëson parti mbi baza qoftë dhe të ndasive sociale, fetare, krahinore, etnike etj., duke vështirësuar konstituimin e shumicës së qëndrueshme parlamentare. Ky sistem e fragmentarizon hartën zgjedhore në shumë miniparti, duke sjellë në parlament edhe grupe të parëndësishme a të sajuara, të cilat u shtohen aktorëve të rëndësishëm politikë dhe që e copëzojnë parlamentin.

Sistemi proporcional i përfaqësimit vepron në mënyrë përcaktuese ndaj numrit dhe strukturës së formacioneve politike. Ai shpie domosdoshmërisht në shtimin e partive, duke i dhënë secilës prej tyre një strukturë monolitike, jashtëzakonisht të hierarkizuar dhe të disiplinuar, nën autoritetin e drejtuesve të tyre. I zgjedhuri vihet nën varësinë e udhëheqjes partiake në mënyrë autoritare dhe shumë të tepruar, ndërsa zgjedhësit, duke mos arritur të votojnë drejtpërdrejt për fituesit, por për partinë, tentojnë t'i largohen kutisë së votimit. Monolitizmi i partive dhe i grupeve parlamentare është aq i madh, sa parlamenti humbet madje thelbin e rolit të tij, në dobi të drejtuesve të këtyre formacioneve.

Nga ana tjetër, zgjedhja me votim mazhoritar i kundërvihet zgjedhjes me një përfaqësi të pastër proporcionale. Votimi në sistemin mazhoritar krijon bipolarizim ose bipartizim të skenës politike. Mazhoritari ka prirjen të zgjerojë së shumti fitoren e fitimtarëve, ç'ka bën të mundur sigurimin e një mazhorance të qëndrueshme parlamentare. Këto veçori, që mbart ky sistem votimi, të shpien në formimin parazgjedhor të aleancave partiake, të cilat i japin më tepër identitet mazhorancave zgjedhore, parlamentare dhe qeveritare.

Sistemi mazhoritar i votimit, përderisa kërkon njohjen e drejtpërdrejtë të kandidatit nga zgjedhësit, favorizon personalizimin e përballjes zgjedhore, ndikon në mbijetesën e një lokalizmi dhe njëkohësisht nxit më tepër dobësimin e hallkave të varësisë së kandidatit nga tutela e udhëheqjes partiake.⁵

Bipolarizimi, mbipërfaqësimi mazhoritar (ose ndryshe - ekzagjerim i shumicave parlamentare), nënpërfaqësimi i pakicave, homogjeniteti i shumicave i përcaktuar nga zgjedhësit dhe personalizimi i vazhdueshëm përbëjnë disa nga veçoritë e zgjedhjes mazhoritare. Ndërkohë, ekzagjerimi i shumicave dhe nënpërfaqësimi i pakicave, në sistemin e përfaqësimit proporcional shuhen, sepse ky është qëllimi parësor i këtij sistemi. Sipas një studiuesi të sistemeve zgjedhore, “sistemi i votimit mazhoritar vepron, ai proporcional paralizon.”⁶

Çdo sistem zgjedhor, që kërkohet të zbatohet, zgjidhet në varësi të synimit që dëshirohet të arrihet. Sistemi mazhoritar konsiderohet si sistemi që prodhon qeverisje të qëndrueshme, por ai zhduk përfaqësimin.⁷ Nga ana tjetër, përfaqësimi proporcional është një sistem që ka suksesin e vet në vendet me përmasa të vogla, por me traditë të konsoliduar në demokraci, që kanë nivel të lartë zhvillimi dhe që kanë arritur t’u japin prej kohësh zgjidhje të perfeksionuara problemeve të tyre sociale.

Shqipëria nuk e ka atë komoditet infrastrukturor dhe, për më tepër, nuk ka arritur të krijojë as traditë për të përqafuar dhe zbatuar në rrugë eksperimentale një sistem që nuk e ka zbatuar ndonjëherë. Qëllimi imediat i politikës shqiptare do të duhet të jetë zhvillimi i zgjedhjeve të lira e demokratike dhe jo tipi i sistemit që duhet zgjedhur, për një arsye mjaft të

⁵ Duhamel, Olivier. “E Drejta Kushtetuese-Demokracitë”, Logosa.

⁶ Nicolas Denis. “Kundër përfaqësimit proporcional”, artikulli i botuar në revistën e përmuajshme Appel, nr. 42, janar 1978, f.11-15. Marrë ky citim nga Revista “E drejta parlamentare dhe politikat ligjore”, nr. 6/2005, faqe 97.

⁷ Citim nga artikulli i Blendi Kajsio, botuar në Revistën “:E drejta parlamentare dhe politikat ligjore” nr.6/2005.

thjeshtë, sepse ne e kemi tashmë sistemin. Dhe kemi një sistem që ka dëshmuar për qëndrueshmëri dhe stabilitet në qeverisje në jo pak vende me demokraci të zhvilluar. Një sistem që prodhon si qëndrueshmërinë në qeverisje, ashtu edhe përfaqësimin e gjerë, nuk i lë hapësira as krijimit të supermazhorancave. Dukuritë e parregullsive, të manipulimit të zgjedhjeve ose të deformimit të rezultatit përfundimtar nuk vijnë drejtpërdrejt nga ky sistem zgjedhor, por nga prirja e vazhdueshme e aktorëve politikë, për të mos hequr dorë nga përdorimi i mjeteve që ua lejon sistemi, por që më shumë krijohen nëpërmjet manovrave të amendimeve ligjore. Pikërisht, problemi që ka lindur nuk vjen nga sistemi zgjedhor, por nga amendimi i herëpashershëm i dispozitave të Kodit Zgjedhor, i bërë në mënyrë të pastudiuar, shpesh herë kontradiktor dhe i debatueshëm nga pikëpamja kushtetuese. Prandaj, hartimi i një Kodi Zgjedhor brenda standardeve kushtetuese dhe jo përmes ndryshimit të llojit të sistemit zgjedhor ose eksperimentimit të sistemeve të pazbatuara më parë, është një rrugëzgjidhje, drejt së cilës duhet të orientohemi.

* * *

Çështja nuk shtrohet për të analizuar dhe që këtej për të nxjerrë përfundime, se cili nga sistemet zgjedhore është më i përshtatshëm për Shqipërinë. Nisur nga një tjetër këndvështrim, do të vlerësoja se qëndrimi më i drejtë, që korrespondon edhe me statusin e një gjyqtari kushtetues [që mendon se në një regjim të rregullt, ndërrimi i ligjit është i thjeshtë, kurse ndryshimi i Kushtetutës më i komplikuar], është dhe mbetet vizioni për një stabilitet kushtetues që çmohet si atribut mjaft i rëndësishëm për një demokraci në konsolidim.

Arsyeja kryesore që evidentohet si e justifikuar për të rishikuar Kushtetutën lidhet me sistemin zgjedhor. Pikërisht, prania e një mendësie ende të pakonsoliduar për një Kushtetutë të qëndrueshme është e

mjaftueshme për të përmbysur çfarëdo lloj sistemi zgjedhor, sado lart që të jenë ngritur barrierat procedurale kushtetuese nga të cilat ai mbrohet. Fatkeqësisht, kësaj mendësie nuk mund t'i bëjë ballë asnjë kushtetutë, e fortë apo e ngurtë qoftë ajo.

Në këtë kontekst, nuk mund të trumbetojë pandryshueshmërinë e Kushtetutës, ndërkohë që, në varësi të rrethanave të reja dhe evoluimit shoqëror brenda vendit dhe në planin ndërkombëtar, mund të paraqitet si domosdoshmëri rishikimi i saj. Nëse mendohet dhe gjykohet se shkaktari kryesor, që në Shqipëri nuk arrihet të zhvillohet një proces i drejtë zgjedhor dhe i pa kontestuar, është vetë sistemi zgjedhor aktual, atëherë le të ndryshohet edhe Kushtetuta.

Megjithatë, për t'i prerë rrugën kësaj prirjeje të politikës, që parregullsitë e procesit zgjedhor ia ka "faturuar" dhe sigurisht që edhe në të ardhmen sërish do t'ia "faturojë" këtij sistemi dhe aspak administrimit të zgjedhjeve, por edhe për të shmangur në të ardhmen konfliktin ndërmjet kushtetutshmërisë dhe politikës, në favor të tezës së ithtarëve të ndryshimeve kushtetuese, mund të shkonte argumenti për mosmbajtje të llojit të sistemit zgjedhor deri në rang kushtetues. Përderisa aktorët politikë arrijnë të bien në ujdi për të siguruar jo vetëm shumicën e cilësuar prej 3/5 për të miratuar ligjet që e kërkojnë një shumicë të tillë, por edhe shumicën prej 2/3 për amendime kushtetuese, atëherë ngurtësia e Kushtetutës nuk është pengesë për ta për të bërë çdo zgjidhje konsensuale.

Prandaj, për të mos hapur "kutinë e Pandorës" me lojën e amendimeve të parreshtura kushtetuese, për të ruajtur të paprekur, por edhe për të respektuar Kushtetutën në çështjet e tjera thelbësore, përcaktimi i llojit të sistemit zgjedhor mund t'i mbetet ligjit, ashtu si rëndom ekziston në shumicën e kushtetutave të vendeve të tjera. Nga kjo pikëpamje, kushtetutshmëria nuk konfliktohet në çdo kohë dhe as nuk cenohet, ashtu si dhe politika e ka më të lehtë që, sa herë t'i dalin probleme me procesin zgjedhor, të hedhë vështrimin nga rishikimi i ligjit, por jo i Kushtetutës.

Sidoqoftë, për shkak të konceptit që kam dhe mbroj për të pasur një demokraci kushtetuese përkundër një demokracie procedurale⁸ që imponon një Kushtetutë të pandryshueshme lehtësisht, e cila nuk mund të shndërrohet në një akt që amendohet më lehtë se një ligj i zakonshëm, duhet të vetedukohemi dhe të pranojmë se shkak i parregullsive nuk është as sistemi zgjedhor dhe as Kushtetuta.

Sistemi zgjedhor përbën një nga institucionet themelore të shtetit demokratik dhe të qëndrueshmërisë së tij, prandaj konsiderohen të vlerësueshme dhe serioze përpjekjet për ta konsoliduar dhe aspak për ta ndryshuar atë sipas drejtimit që marrin “erërat” e interesave të çastit të politikës. Ndryshimet e shpeshta dhe të pastudiuara të sistemit sjellin destabilitet politik, mungesë qëndrueshmërie, krijojnë kosto të madhe politike, financiare dhe administrative. Duke bërë ndërhyrje në disa aspekte formale pa i prekur thelbin, këtij sistemi zgjedhor mund t’i bëhen amendime të kujdesshme ligjore, me qëllim shmangien, në radhë të parë, të fenomenit “*Dushk*” dhe të problemeve të tjera që lidhen me deformimin a mosleximin e drejtë të votës, reduktimin e ankimeve të tejzgjatura administrative dhe gjyqësore vetëm në çështje thelbësore, vënien në funksion dhe rritjen e përgjegjshmërisë ligjore të komisioneve e të komisionerëve zgjedhorë, si dhe administrimin e drejtë në tërësi të të gjithë procesit zgjedhor. Me zgjidhje të rangut ligjor, por jo domosdoshmërisht kushtetues, do të arrihet të shmanget që faji t’i vishet Kushtetutës, do të eliminohet papajtueshmëria e krijuar për shkak të sistemit zgjedhor ndërmjet kushtetutshmërisë dhe politikës, do të konsolidohet stabiliteti kushtetues institucional, si dhe vetë sistemi demokratik i qeverisjes.

⁸ Rawls, John. “Drejtësia si paanshmëri”, botim ISP & DITA 2000.

Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend

Filip Lako
Jurist

Ligj 9525, 25.4.2006 “Për një ndryshim në ligjin nr.7819, datë 27.4.1994 “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar”. Me ligjin e lartpërmendur, ndryshohet vetëm neni 94 i ligjit nr.7819, date 27.4.1994 “Për pronësinë industriale”. Këtij neni i është bërë edhe një ndryshim më përpara dhe konkretisht ky ndryshim i është bërë me ligjin nr.8477, datë 22.4.1999, pra, tani po këtij neni i bëhet ndryshimi i dytë.Me ndryshimin që i bëhet sot, neni 94 ka këtë përmbajtje: “Drejtoria e Patentave dhe Markave

1. Drejtoria e Patentave dhe Markave është institucion publik në varësi të ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Drejtori është përfaqësuesi i saj në marrëdhënie me të tretët.

2. Struktura dhe organika e Drejtorisë së Patentave dhe Markave përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

3. Veprimtaria e Drejtorisë së Patentave dhe Markave përcaktohet dhe rregullohet me këtë ligj dhe me aktet nënligjore në zbatim të tij.

4. Drejtori i Drejtorisë së Patentave dhe Markave emërohet dhe lirohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.”

Sipas nenit 94, të miratuar me ligjin nr.8477, datë 22.4.1999, Drejtoria e Patentave dhe Markave ka qenë në varësi të Këshillit të Ministrave,

kurse ashtu si përmendet më lart, sot kjo Drejtore është në varësi të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Sipas nenit 84 (të ligjit të vitit 1999) struktura dhe organika miratohej nga Kryeministri, kurse me ndryshimin që bëhet sot, struktura dhe organika e Drejtorisë së Patentave dhe Markave përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Drejtore i Drejtorisë së Patentave dhe Markave emërohej dhe shkarkohej nga Këshilli i Ministrave, kurse sot ai emërohet dhe lirohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 1.6.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.48 të vitit 2006, në faqen 1430.

Ligj nr.9526, datë 15.5.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar për projektin e spitalit të Kavajës”. Projekti, sipas kësaj Marrëveshjeje synon të sigurojë shërbime mjekësore me nivel të pranueshëm për popullsinë e qytetit të Kavajës dhe periferisë së tij nëpërmjet ndërtimit të një spitali të ri, si dhe sigurimit të pajisjeve dhe të aparaturave moderne mjekësore. Punimet civile (ndërtimi) përfshijnë ndërtimin e dy godinave që do të zënë një sipërfaqe totale prej rreth 5600 m². Pajisjet dhe aparaturat mjekësore konsistojnë në sigurimin e 181 artikujve, pajisje dhe aksesore mjekësore, duke përfshirë dy autoambulanca të kujdesit intensiv, si dhe dy ambulanca emergjence. Kredia është në shumën 2.420.000 dollarë amerikanë dhe për këtë kredi, huamarrësi (Republika e Shqipërisë) do të paguajë një interes prej 2.275 për qind në vit mbi shumën e principalit të tërhequr dhe të mbetur herë pas here. Interesi dhe tarifa e shërbimit do të paguhet në dollarë çdo gjashtë muaj. Ripagimi i principalit të kredisë do të bëhet në dollarë, ose në një monedhë tjetër lehtësisht të konvertueshme në një shumë të barasvlershme me shumën e përcaktuar në dollarë, sipas kursit të këmbimit të tregut që dominon në kohën dhe vendin e riparimit. Në Marrëveshje është

parashikuar, gjithashtu, që huamarrësi merr përsipër të sigurojë se asnjë borxh tjetër i jashtëm nuk do të ketë përparësimbi këtë kredi në alokim, realizimin ose shpërndarjen nga konvertimi i monedhës të mbajtur nën kontroll ose për përfitime të huamarrësit. Kjo Marrëveshje dhe çdo marrëveshje shtesë ndërmjet palëve të saj do të përjashtohet nga taksat, tatimet ose detyrimet e vëna nga ose në territorin e Huamarrësit, mbi ose në lidhje me zbatimin, livrimin ose regjistrimet sipas Marrëveshjes. Është parashikuar, gjithashtu, edhe mënyra e zgjidhjes së konflikteve ndërmjet palëve. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 27.6.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.58 të vitit 2006, në faqen 1639. Ligjit i bashkëlidhet Marrëveshja e Kredisë dhe 3 shtojca.

Ligj nr.9527, date 11.5.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane për realizimin e programit për zhvillimin e sektorit privat, me anën e një kredie ndihme për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe sigurimin e asistencës teknike për to””. Qëllimi i përgjithshëm i programit është të kontribuojë dhe në forcimin e marrëdhënieve ekonomike të saj me Bashkimin Europian, kurse qëllimi i veçantë i tij është të mbështesë ndërmarrjet e vogla e të mesme me anë të ndërhyrjeve që synojnë krijimin e një mjedisi të favorshëm për zhvillimin e tyre, duke iu referuar kryesisht sektorit të kreditimit. Sipas Marrëveshjes, Qeveria e Republikës Italiane merr përsipër të financojë Programin në shumën e 30 milionë euro, nga të cilat 27 500 000 euro janë kredi ndihme dhe 2 500 000 euro janë dhuratë. Kredia do të shlyhet pas 38 vjetësh dhe vlera e interesit do të jetë 0.0 për qind. Objektivi i përgjithshëm i Programit është të kontribuojë në rritjen ekonomike të Shqipërisë dhe në zgjerimin e marrëdhënieve tregtare me BE-në. Qeveria Shqiptare duhet të garantojë zbatimin e programit në përputhje me Marrëveshjen dhe do të jetë përgjegjëse për mbikëqyrjen e

veprimtarive, dhe do të ndërmarrë veprimet e nevojshme dhe detyrat e fillimit të vendosura në “kuadrin logjik” të Programit, ashtu si tregohet me shumë hollësi në shtojcat 1 e 2. Në Marrëveshje janë përcaktuar strukturat e drejtimit për zbatimin e Programit, përdorimi i linjës së kredisë, livrimin, menaxhimin dhe kontrollin e kredisë dhe në përfundimin e të gjitha operacioneve, Ministria e Ekonomisë e Shqipërisë do të prezantojë një raport përfundimtar, të verifikuar, nga shoqëria e auditivit. Një raport i tillë duhet të miratohet edhe nga Ministria e Punëve të Jashtme të Italisë. Në Marrëveshje është parashikuar edhe dhënia, drejtimi dhe kontrolli i dhuratës prej 2 500 000 euro, duke ndarë edhe zërat përse do të përdoret. Në rast se do të lindin mosmarrëveshje gjatë zbatimit të programit, është parashikuar që ato të zgjidhen nga palët me anë të këshillimit me Ministrinë e Ekonomisë të Shqipërisë e Ministrinë e Punëve të Jashtme të Italisë përmes Ambasadës Italiane. Marrëveshja ka edhe dy shtojca të cilat përmbajnë në mënyrë shumë të detajuar përmbledhjen e programit dhe vijat udhëzuese për realizimin e Programit. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 29.6.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.60 të vitit 2006, në faqen 1671. Ligji i bashkëlidhen marrëveshja dhe dy shtojcat.

Ligj nr.9528, datë 11.5.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa S.P.A. për programin e zhvillimit të sektorit privat, nëpërmjet mbështetjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe sigurimit të asistencës teknike për to””. Qëllimi i huasë është financimi i zhvillimit të sektorit privat nëpërmjet një kredie në mbështetje të SMS-ve dhe të asistencës teknike. Huaja është e ndarë në dy pjesë: shuma prej 25 000 000 eurove do të përdoret për financimin e projekteve të SMS-ve, kurse shuma prej 2 500 000 eurove, për ngritjen e një fondi garancie (AGF). Për këtë hua është lidhur “Marrëveshja qeveritare” midis

palëve të përmendur më lart, hua e cila do të ketë një kohëzgjatje prej 38 vjet e do të ripaguhet me 40 këste të njëpasnjëshme, të barabarta, çdo gjashtëmuajor të principalit, i pari i të cilëve kthehet në detyrim për paguar 216 muaj nga data e lëvrimit të parë. Kjo hua e butë do të përdoret për përfitimin e mallrave dhe shërbimeve me origjinë italiane. Një shumë maksimale prej 30 për qind e shumës së lidhur me huanë e butë prej 25 000 000 euro, mund të përdoret për të mbuluar koston lokale dhe importet e mallrave dhe të shërbimeve me origjinë nga vende të tjera në zhvillim. Marrëveshja përmban edhe hyrjen në fuqi të Marrëveshjes Financiare, probleme që kanë të bëjnë me kompaninë e auditivit, afatet e lëvrimit të huasë së butë për financimin e fondit shqiptar të garancisë (AGF). Për financimin e projekteve të SMS-ve huaja do të jepet në 3 këste, kurse për financimin e fondit shqiptar të garancisë do të jepet në dy këste. Një vend të veçantë janë në Marrëveshje edhe problemet që lidhen me pagimin e huasë së butë. Kështu parashikohet që 60 ditë nga data e fundit e skadimit të lëvrimit të huasë së butë, huamarrësi do të lëshojë për Artigiancassa, “njohjen e të qenit në borxh”. Me këtë rast, angazhimi i huamarrësit për të paguar shumat detyrim sipas kësaj Marrëveshjeje dhe sipas “njohjes së të qenit në borxh” lidhur me të është i pavarur, absolut, i pakushtëzuar dhe i pakthyeshëm. Janë parashikuar, gjithashtu, edhe rastet e pezullimit të lëvrimeve, të taksave, të ligjit të zbatueshëm, të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve etj. Për këtë të fundit përparësore është zgjidhja e mosmarrëveshjeve me mirëkuptim, e në rast se kjo nuk jep rezultat, mosmarrëveshjet do të zgjidhen në nivel qeveritar dhe, nëse edhe kjo dështon, mosmarrëveshjet do të zgjidhen sipas rregullores së Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris, nga një gjykatë abritrazhi. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 26.6.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.60 të vitit 2006, në faqen 1689. Marrëveshjes i bashkëlidhen dy shtojca.

Ligj nr. 9529, datë 11.5.2006 “Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar”. Neni 15 i ligjit në fuqi përmban në mënyrë taksative llojet e interesave private, që deklarohen periodikisht. Në pikën 5 shkronja “a” të këtij neni thuhet se në rastin e deklarimit para fillimit të punës deklarohen vetëm “pasuritë, detyrimet financiare, si dhe të gjitha kërkesat e përcaktuara në nenin 4 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin e kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (shkronja “a” pika 1 e nenit 15) përjashtuar burimet e kufizimit të tyre. Sipas nenit 1 të ligjit të lartpërmendur, pra të ligjit nr.9529, datë 11.5.2006, fjalët “Përjashtuar burimet e krijimit të tyre”, zëvendësohen me fjalët “dhe burimet e kufizimit të tyre.” Neni 28 i ligjit në fuqi, tregon se cilat janë kufizimet për deputetin. Përveç atyre që janë sot, me ligjin nr.9529, datë 11.5.2006 shtohen fjalët “të avokatisë”, “ekspertit të licencuar”, “të konsulentit”. Ligji në fuqi nuk ka dispozitë kalimtare. Tani shtohet kjo dispozitë, e cila ka këtë përmbajtje: “Zyrtarët që kanë filluar punë për herë të parë në njërin nga funksionet që mbartin detyrimin për deklarim dhe e kanë kryer deklarimin para fillimit të punës në zbatim të nenit 15 të ligjit, plotësojnë justifikimin e burimeve të krijimit të interesave private, të deklaruara brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Ky detyrim nuk zbatohet për ata zyrtarë, që i kanë justifikuar vullnetarisht burimet.” Ligji ka 4 nene dhe ka hyrë në fuqi më 23.6.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.56 të vitit 2006, në faqen 1603.

Ligj nr. 9530, datë 11.5.2006 “Për një shtesë në ligjin nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar. Në nenin 3 të ligjit në fuqi, janë përcaktuar në mënyrë laksative, të gjithë subjektet që mbartin detyrimin për deklarim në

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive. Në ligjin nr.9530, datë 11.5.2006 bëhet një shtesë në ligjin në fuqi (nr.9049, datë 10.4.2003) dhe konkretisht, pas nenit 8 shtohet neni 9 me këtë përmbajtje:

“Neni 9

Deklarimi para fillimit të punës. Të gjitha subjektet e përcaktuara në nenin 3, që mbartin detyrimin për deklarim, duhet të deklarojnë para fillimit të punës të gjitha pasuritë e akumuluar, detyrimet financiare dhe burimet e origjinës së tyre.” Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 23.6.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.56 të vitit 2006, në faqen 1604.

Ligj nr. 9531, datë 11.5.2006 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. Shtesat e ndryshimit, sipas ligjit të lartpërmendur, kanë të bëjnë kryesisht me përbërjen, përzgjedhjen dhe procedurat e zgjedhjes të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit dhe të Këshillit Drejtues të Radios e Televizionit Shqiptar. Gjithashtu, ndryshime ka edhe për sa i përket numrit të përbërjes të këtyre organeve. Kështu, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (KKRT) përbëhet nga Kryetari, Zëvendëskryetari dhe 3 anëtarë nga radhët e personaliteve në fushat e politologjisë, të drejtësisë, medias, sociologjisë apo shkencave të tjera humanitare. Këta zgjidhen nga Kuvendi për një periudhë 5-vjeçare dhe propozohen nga Komisioni për edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik me 2 kandidatura alternative. Kandidaturat fillimit propozohen nga shoqatat dhe grupimet e mediave elektronike, nga shoqatat e medias së shkruar, nga profesorati dhe shoqatat e inxhinierisë elektrike dhe elektronike, nga profesorati i së drejtës, shoqatat e juristëve dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe nga subjektet parlamentare. Të gjithë këto subjekte që u përmendën më lart, kanë të drejtë për të propozuar nga 1 kandidat (me dy alternativa) dhe nga secila nga këto subjekte, që janë pesë, do të zgjidhen 5 anëtarë, pra nga 1 për secilin subjekt. Në nenin

12 shtohet një profesor i cili ka të bëjë me hartimin e një projektfondi për shpenzimet operative, që KKRT ia paraqet për miratim këshillit të Ministrave. Në nenin 14 të ligjit në fuqi trajtohen papajtueshmëritë, pra tregohet rrethi i personave që nuk lejohen të jenë anëtarë të KKRT-së. Pikat 1 dhe 2 të këtij neni ndryshojnë dhe konkretisht, në pikën 1 përcaktohet se anëtarët e KKRT-së nuk lejohen të jenë anëtarë të partive politike dhe shoqatave politike, si dhe të kenë ushtruar detyrën e kryetarit të bashkisë, deputetit, anëtarit të Këshillit të Ministrave ose të prefektit gjatë 2 legjislaturave të fundit ose të kenë konkurruar për to. Gjithashtu, nuk lejohet të jenë aksionerë, anëtarë të organeve drejtuese, të punësuar. Në rastet e lirimit nga detyra të Kryetarit, Zëvendëskryetarit e anëtarëve të KKRT-së të parashikuara në nenin 15 të ligjit në fuqi, ligji nr.9531, datë 11.5.2006 shton si rast edhe faktin kur në mënyrë të përsëritur mbi 2 herë radhazi me dashje apo me neglizhencë pengon formimin e kuorumit të nevojshëm për mbledhjen e KKRT-së. Kërkesa për lirim nga detyra i drejtohet Kuvendit. Ndryshime ka edhe në nenet 17 (kuorumi), 20 (dispozita të përgjithshme për licencimet), 87 (Këshilli Drejtues i RTSH-së) përbërja dhe procedura. Në ligjin në fuqi neni 90 përmban papajtueshmëritë për të qenë anëtarë të Këshillit Drejtues të RTSH-së. Edhe ky nen ndryshon krejtësisht, ashtu si ndryshon edhe neni 98 që rregullon shpërblimin financiar të Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues të RTSH-së. Ligji ka 14 nene dhe ka hyrë në fuqi më 13.7. 2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 65 të vitit 2006, në faqen 1783.

Ligj nr.9532, datë 15.5.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Marrëveshjen e Strasburgut për klasifikimin ndërkombëtar të patentave, 1979”. Palët në këtë marrëveshje e konsiderojnë miratimin universal të një sistemi uniform të klasifikimit të patentave, certifikatave të shpikësve, certifikatat e modeleve të përdorimit në interesin e përgjithshëm si kusht për të vendosur një bashkëpunim më

të ngushtë në fushën e pronësisë industriale, duke kontribuar mbi harmonizimin e legjislacionit kombëtar në këtë fushë. Vendet për të cilat kjo Marrëveshje zbatohet përbëjnë një bashkim special dhe miratojnë një klasifikim të përbashkët për patentat për shpikje, certifikatat e shpikësve, certifikatat e modeleve të përdorimit dhe certifikatat e përdorimit, i njohur si “Klasifikim Ndërkombëtar i Patentave”. Klasifikimi përmban tekstin e vendosur në lidhje me dispozitat e Konventës Europiane për Klasifikimin Ndërkombëtar të Patentave për shpikjet, të 19 dhjetorit 1954 e njohur si “Konventa Europiane” dhe që ka hyrë në fuqi dhe që është bërë publike nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës më 1 shtator 1968. Klasifikimi do të vendoset në gjuhët angleze dhe franceze, por edhe tekstet zyrtare të klasifikimit në gjermanisht, japonisht, portugalisht, rusisht, spanjisht dhe në gjuhë të tjera, do të vendosen nga Byroja Ndërkombëtare e Organizatës, në konsultim me qeveritë e interesuara, ose mbi bazën e përkthimit të depozituar nga këto qeveri, ose përmes mjeteve të tjera që nuk krijojnë pasoja financiare për Buxhetin e Bashkimit Special ose për Organizatën. Çdo vend i Bashkimit Special (Unionit Special) ka të drejtë të përdorë klasifikimin si sistem kryesor ose dytësor, por gjithsesi klasifikimi do të jetë vetëm i karakterit administrativ. Në secilin nga vendet e Bashkimit Special do të ngrihet një Komitet Ekspertësh për ta përfaqësuar atë. Bashkimi Special do të ketë një asamble që përbëhet nga vendet e Bashkimit Special, kurse qeveritë e secilit vend të Bashkimit Special do të përfaqësohen nga një delegat, që mund të asistohet nga delegatë të alternuar, këshilltarë dhe ekspertë. Detyrat administrative që kanë të bëjnë me Bashkimin Special do të paraqiten nga Byroja Ndërkombëtare. Në mënyrë të veçantë kjo e fundit do të përgatisë mbledhjet dhe do t’i sigurojë kushte optimale Sekretariatit të Asamblesë, Komitetit të Ekspertëve dhe komiteteve të tjera ose grupeve të punës që mund të vendosen nga Asambleja ose Komiteti i Ekspertëve. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 28.6.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.59 të vitit 2006, në faqen

1659. Ligjit i bashkëlidhet Marrëveshja.

Ligj nr.9533, datë 15.5.2006 “për disa ndryshime në ligjin nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor””. Ndryshimet që bëhen në shumë nene lidhen vetëm me emërtimin e disa institucioneve. Kështu në nenet 4, 8, 16, 19, 21, 26, 27, 35, 40, 42, emërtimet “Ministër i Bujqësisë dhe Ushqimit” dhe “Drejtor i Shërbimit Pyjor” zëvendësohen me emërtimin “Ministër i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave”. Në nenet 5, 7, 10, 12, 15, 16, 18, 19, 21, 23, 25, 26, 31, 35 emërtimet “Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit” dhe “Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Pyjor” zëvendësohen me emërtimin “Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.” Në nenin 13 pika 3 emërtimi “Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit” zëvendësohet me emërtimin “Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.”. Në nenin 9 “Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit pyjor” bëhen këto ndryshime: hiqet titulli i lartpërmendur i nenit 9. Pika 1 e nenit 9 ndryshohet si vijon: “Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave është organi më i lartë administrativ i shërbimit Pyjor. Drejtorët e drejtorive rajonale të shërbimit pyjor emërohen nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.” Pika 2 ndryshohet si vijon: “Ministria e Mjedisit, pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe drejtoritë rajonale të shërbimit pyjor, në varësi të saj, përgjigjen për sigurimin e mbrojtjes, për qeverisjen, për sigurimin e mbrojtjes, për qeverisjen e qëndrueshme të fondit pyjor dhe kullësor kombëtar”. Në nenin 21 pika 12 bëhet ky ndryshim: “Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave jep lejen për ushtrimin e veprimtarive në fondin pyjor, duke bashkërenduar punën me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e cila, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ka të drejtë të pajisë subjektet fizike e juridike me lejet përkatëse të ushtrimit të veprimtarive në fushën që mbulon.” Pika 3 e nenit 40 ndryshohet si vijon: “Urdhri i Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit

të Ujërave përbën titull ekzekutiv. Kundër urdhrin të Ministrin ose kur ky i fundit nuk përgjigjet brenda afatit 30-ditor, bëhet ankim brenda 30 ditëve në gjykatën e rrethit gjyqësor përkatës.” Ligji ka 5 nene dhe ka hyrë në fuqi më 23.7.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.56 të vitit 2006, në faqen 1604.

Ligj nr.9534, datë 15.5.2006 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9198, datë 1.7.2004 “Për barazinë gjinore në shoqëri”. Në ligjin në fuqi neni 7 ka këtë titull: “Autoriteti publik përgjegjës për barazinë gjinore në fushën e punës.” Me ndryshimin e fundit ky titull bëhet: “Autoriteti përgjegjës për barazinë gjinore”. Paragrafi i parë i nenit 7 i ligjit në fuqi përcakton se ministri përkatës është autoriteti publik përgjegjës për të zbatuar dhe kontrolluar respektimin e këtij ligji në fushën e punësimit. Me ndryshimin që i bëhen këtij paragrafi ai riformulohet si vijon: “Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta është autoriteti përgjegjës për barazinë gjinore.”. Në paragrafin e dytë të po këtij neni, emërtimi “Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale”, zëvendësohet me emërtimin “Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta”. Në nenin 12 të ligjit në fuqi tregohen se cilat janë strukturat shtetërore përgjegjëse për të realizuar politikën për barazi gjinore, dhe si krijohen këto struktura. Ky nen, me ligjin nr.9534, datë 15.5.2006 është shfuqizuar. Neni 13 i ligjit në fuqi, tregon detyrimet e Komitetit Ndërministror, si një organ i strukturës shtetërore përgjegjëse për të realizuar politikën e barazisë gjinore, kurse neni 14 tregon se si emërohet Kryetari i Komitetit Ndërministror, sa vazhdon mandati i tij dhe cilat janë detyrat e këtij kryetari. Edhe nenet 13 dhe 14 janë shfuqizuar me ligjin nr.9534, datë 15.5.2006. Ligji ka 3 nene dhe ka hyrë në fuqi më 23.6.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.56 të vitit 2006, në faqen 1606.

Ligj nr.9535, datë 15.5.2006 “Për faljen e kamatëvonesave të

kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore, të papaguara, të ndërmarrjeve dhe shoqërive me kapital tërësisht shtetëror të ujësjellës-kanalizimeve”. Sipas këtij ligji, ndërmarrjeve dhe shoqërive me kapital tërësisht shtetëror të ujësjellës-kanalizimeve u falen kamatë-vonesat e kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore, të papaguara deri më datë 31.12.2005, me kushtet që detyrimet për kontributet të arkëtohen brenda datës 31.12.2006. Kamatëvonesat e papaguara falen edhe kur kontributet për sigurimet e detyrueshme shoqërore janë paguar para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të gjykatave, që kanë formë të prerë deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, pushohet për pjesën e kamatëvonesave të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore të papaguara, të cilat falen me këtë ligj. Kamatëvonesat e kontributeve për sigurimet e detyrueshme shoqërore të paguara para hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk kthehen. Ligji ka 4 nene dhe ka hyrë në fuqi më 23.6.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.56 të vitit 2006, në faqen 1607.

Ligj nr.9536, datë 15.5.2006 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7667, datë 28.1.1993 “Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare”” Në ligjin në fuqi, në nenin 24 përcaktohet se gjyqtari vendos për kërkesat e regjistrimit dhe kërkesat e tjera, brenda 30 ditëve nga data e deponimit të kërkesës në gjykatë. Ai, gjithashtu, vendos edhe për problemet e nevojshme. Vendimi për regjistrimin jepet nga gjyqtari edhe në rastin kur një gjykatë tjetër ka marrë vendim për këtë. Me ligjin nr.9536, datë 15.5.2006 neni 24 i përmendur më lart ka ndryshuar dhe ka këtë përmbajtje: “Gjyqtari vendos për regjistrimin e kërkesës në gjykatë, si dhe për publikimet e nevojshme, brenda 8 ditëve pune nga data e depozitimit të kërkesës. Kur gjatë shqyrtimit të kërkesës dhe të dokumenteve bashkëlidhur gjyqtari vëren se përmbajtja nuk është e plotë, pasthirrjes dhe dëgjimit të kërkuësit, vendos për çështje që duhet

të plotësohen, duke përcaktuar një afat për plotësimin e tyre.” Ndryshim ka pësuar edhe neni 32 i ligjit në fuqi, sipas të cilit çdo regjistrim i njoftohet atij që e ka kërkuar dhe dhomës së tregtisë. I interesuari mund të heqë dorë nga e drejta për t’u njoftuar. Pas ndryshimit që bëhet me ligjin nr.9536, datë 15.5.2006, neni 32 ka këtë përmbajtje: “Çdo regjistrim i njoftohet personit që e ka kërkuar, organeve tatimore dhe Dhomës së Tregtisë .” Ligji ka 3 nene dhe ka hyrë në fuqi më 23.6.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.56 të vitit 2006, në faqen 1608.

Ligj nr.9537, datë 18.5.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme” Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë normat që rregullojnë administrimin e sigurt të mbetjeve të rrezikshme, grumbullimin, transportin, ruajtjen e përkohshme, përpunimin, trajtimin, asgjësimin, importimin dhe eksportimin e tyre. Ky ligj nuk zbatohet për mbetjet urbane, përveç rastit kur ato shfaqin ndonjërin nga karakteristikat e mbetjeve të rrezikshme. Ligji përmban parimet e administrimit të mbetjeve të rrezikshme, dhe urdhëron që ministri përkatës, brenda 3 vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të paraqesë për miratim në Këshillin e Ministrave planin kombëtar për administrimin e mbetjeve të rrezikshme. Ky miratim do të bëhet pasi të jetë bërë këshillimi me publikun dhe takimet publike me organet e pushtetit vendor. Në ligj janë përcaktuar në mënyrë të detajuar detyrat e prodhuesve dhe zotëruesve të mbetjeve të rrezikshme, si dhe dokumentacioni e procedurat për pajisjen e personave me leje për grumbullimin, transportimin dhe magazinimin e përkohshëm të këtyre mbetjeve. Përveç kësaj leje, sipas ligjit, kërkohet edhe leja mjedisore për sheshin e mbetjeve të rrezikshme dhe sqarohet procedura e aplikimit, si dhe çfarë kërkohet për garancitë financiare. Për dhënien e lejes mjedisore, sipas nenit 15 të ligjit, kërkohen të plotësohen 14 kushte. Leja mjedisore për sheshin e mbetjeve të rrezikshme, e lëshuar sipas këtij ligji, mund të transferohet vetëm me miratim të Ministrit. Ky i fundit nuk miraton lejen

mjedisore për sheshin e mbetjeve të rrezikshme, nëse personi i propozuar, tek i cili do të bëhet transferimi, nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë ligj. Gjithashtu, Ministri ka kompetenca për të ndryshuar, pezulluar ose anuluar lejet për grumbullimin dhe/ose transportimin e mbetjeve të rrezikshme në çdo kohë, kur këtë e kërkon mbajtësi i lejes, kur mbajtësi i lejes nuk përmbush kushtet e parashikuara në leje, kur mbajtësi i lejes është dënuar për një vepër penale lidhur me këtë ligj, kur ai ka shkelur dispozitat e këtij ligji dhe kur ai nuk ka paguar gjobat administrative, të vëna në bazë të këtij ligji apo të akteve të tjera normative mjedisore. Vend i veçantë i jepet në ligj problemeve lidhur me importin dhe eksportin e mbetjeve të rrezikshme. Lidhur me importin, sipas ligjit, ai ndalohe në të gjitha rrethanat, ashtu si ndalohe në të gjitha rrethanat edhe tranziti ndërkufitar i këtyre lëndëve. Kurse eksporti lejohet të bëhet vetëm me leje mjedisore të dhënë nga Ministri dhe kjo leje jepet në përputhje me rregullat dhe kërkesat e Kontratës së Bazelit. Në ligj janë përcaktuar se kush janë kundërvajtjet administrative dhe masat e gjobave për këto kundërvajtje. Ky ligj shfuqizon pikën 8 të nenit 3 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe zëvendësohet me përkufizimin e mbetjeve të rrezikshme, sipas parashikimeve të këtij ligji. Ligji ka 29 nene dhe ka hyrë në fuqi më 23.6.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.56 të vitit 2006, në faqen 1609. Ligj nr.9538, datë 22.5.2006 “Për një shtesë në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”” Ligji nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” ka pësuar disa ndryshime me ligjet që shënohen më poshtë:

1. Ligjin nr.8710, datë 15.12.2000
2. Ligjin nr.8846, datë 11.12.2001
3. Ligjin nr.8968, datë 7.11.2002
4. Ligjin nr.8980, datë 12.12.2002
2. Ligjin nr.9160, datë 18.12.2003

3. Ligjin nr.9333, datë 6.12.2004

Me ligjin 9538, datë 22.5.2006, në ligjin në fuqi në nenin 30, pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje: “Organet tatimore, brenda pesë ditëve nga hedhja e të dhënave në regjistrin kombëtar të tatimpaguesve, duhet të dërgojnë në regjistrin tregtar një kopje të numrit të identifikimit si subjekt fiskal”. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 24.6.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.57 të vitit 2006, në faqen 1627.

Ligj nr.9539, datë 22.5.2006 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8498, datë 10.6.1999 “Për ratifikimin e “Konventës së Këshillit të Europës për ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale” dhe të protokollit të saj shtesë”. Konventa Europiane e Ndhmës Juridike në Fushën Penale është miratuar me ligjin nr.8498, datë 10.6.1999. Këtij ligji i janë bërë disa ndryshime me ligjin e lartpërmendur (nr.9539, datë 22.5.2006). Ndryshimet janë bërë në nenin 2, pikat 2 dhe 3. Sipas ndryshimeve, këto pika kanë këtë përmbajtje: Pika 2 e nenit 2: “Lidhur me nenin 16 paragrafi i dytë, kërkesa për ndihmë të ndërsjellë dhe dokumentet që u bashkëlidhen shoqërohen me përkthimin autentik zyrtar në gjuhën shqipe dhe, kur nuk është e mundur, në gjuhën angleze. Republika e Shqipërisë, për dokumente më të gjata, si dhe në rastin kur marrësi është shtetas shqiptar ose kur vendbanimi i tij/saj është në Shqipëri, rezervon të drejtën për të kërkuar një përkthim autentik zyrtar në gjuhën shqipe, e përcaktuar kjo rast pas rasti.” Pika 3 e nenit 2: “Autoritetet gjyqësore, në kuptim të nenit 24 të kësaj Konvente, janë Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit, gjykatat e shkallës së parë, Prokuroria e Përgjithshme, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë.” Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 24.6.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.57 të vitit 2006, në faqen 1627.

Ligj nr.9540, datë 22.5.2006 “Për një ndryshim në ligjin nr.9314,

datë 11.11.2004 “Për privatizimin e aksioneve, pronë e shtetit shqiptar, të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë”. Në nenin 4 pika 1 të ligjit nr.9314, datë 11.11.2004 “Për privatizimin e aksioneve, pronë e shtetit shqiptar, të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë”, thuhet: “Nëse shitja e aksioneve, pronë e shtetit shqiptar, të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë, nuk realizohet brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, sipas parashikimeve të nenit 2 të këtij ligji, Ministria e Financave ka të drejtën t’ia shesë ato, nëpërmjet tenderit të hapur, një investitori strategjik të njohur në sektorin bankar, i cili ofron garanci financiare. Procedurat e përzgjedhjes së investitorit strategjik, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, miratohen nga Këshilli i Ministrave.” Me ligjin nr.9540, datë 22.5.2006 fjalët “brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji” zëvendësohen me fjalët “brenda datës 31.12.2006” Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 24.6.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.57 të vitit 2006, në faqen 1628.

Ligj nr. 9541, datë 22.5.2006 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””. Në ligjin në fuqi, pas nenit 1 shtohet neni 1/1 “Fusha e veprimit” dhe në nenin 2 “Përkufizime” shtohen disa përkufizime. Neni 1/1 ka këtë përmbajtje: “Ky ligj zbatohet për të gjitha institucionet shtetërore, qendrore ose të varësisë për organet e drejtësisë, prokurorisë dhe/ose personat juridikë/fizikë, personat me imunitet, kur për ushtrimin e detyrave të tyre duhet të kenë akses në informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” Në nenin 2 shtohen këto përkufizime: “INFOSEC” është zbatimi i masave të sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë përpunimit, arkivimit ose transmetimit në sistemet e komunikimit, sistemet e informacionit dhe sistemet e tjera elektronike nga cenimi aksidental ose i qëllimshëm i objektivave të sigurisë, konfidencialitetit, integritetit dhe disponibilitetit. “Konfidencialiteti” është mbrojtja e informacionit nga akses i paautorizuar. “Integriteti” është mbrojtja e informacionit nga modifikimi

i paautorizuar. “Disponibiliteti” është vënia e informacionit në dispozicion të përdoruesve të autorizuar, kur kërkohet. Në nenin 3 në fjalinë e parë, fjalët “tri nivelet”, zëvendësohen me fjalët “katër nivelet”. Pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje. “ç) “i kufizuar”, kur ekspozimi i paautorizuar mund të dëmtojë veprimtarinë ose efektivitetin e institucioneve shtetërore në fushën e sigurisë kombëtare.” Në nenin 9, shkronja “a” fjalët “tri nivelet” zëvendësohen me fjalët “katër nivelet”. Në nenin 21 pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje: “ç) personi ka zotësi për të vepruar.” Neni 23 ndryshohet plotësisht dhe ka këtë përmbajtje:

“Neni 23

Siguria në rrjetet informatike dhe në pajisjet e komunikimit

Masat e sigurisë: sigurimi fizik, sigurimi i personelit, sigurimi i informacionit dhe INFOSEC zbatohen për të krijuar një mjedis të sigurt për funksionimin e sistemeve të komunikimit, të sistemeve të informacionit dhe sistemeve të tjera elektronike. DSIK është Autoriteti Kombëtar i Akreditimit të Sigurisë.

Drejtoria e Shifrës është Autoriteti Kombëtar për Sigurimin e Komunikimeve dhe Autoriteti Kombëtar i Shpërndarjes.” Në nenin 24 ndryshohet paragrafi i dytë dhe, pas paragrafit të dytë, shtohet një paragraf. Edhe në nenin 27, që trajton sistemin e zyrave të regjistrimit, janë bërë ndryshime. Me rëndësi është fakti se këtë ndryshim, ky sistem është përgjegjës për regjistrimin, shpërndarjen dhe administrimin e informacionit të klasifikuar, të shkëmbyer në kuadrin e bashkëpunimit me NATO-n. Nëpërmjet sistemit të zyrave të regjistrimit qarkullon edhe informacioni i klasifikuar i shteteve ose i organizatave të tjera ndërkombëtare. Ligji ka 9 nene dhe ka hyrë në fuqi më 24.6.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.57 të vitit 2006, në faqen 1629.

Ligj nr.9542, datë 22.5.2006 “Për disa ndryshime në ligjin

nr.8996, datë 30.1.2003 “Për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse (metrologjinë)” Në nenin 2 të ligjit në fuqi jepen kuptimet e fjalëve që përdoren në ligjin në tërësi, kurse në nenin 3 jepen njësitë ligjore të matjes në Republikën e Shqipërisë. Në pikën 2 të nenit 3 thuhet që Këshilli i Ministrave bën përcaktimin e njësive të matjes, të pavarura dhe të rrjedhura nga SI-ja (Sistem Ndërkombëtar i Matjeve), si dhe shumëfishat dhe nënfishat dhjetorë të SI-së. Me ligjin 9542, datë 22.5.2006, pika 2 e nenit 3 ndryshohet si vijon: “Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës bën përcaktimin e njësive të matjes, të pavarura dhe të rrjedhura nga SI-ja, si dhe të shumëfishave dhe nënfishave dhjetorë të sistemit SI.” Në nenin 6 të ligjit në fuqi ndryshohen pikat 1 dhe 4. Para ndryshimit, pikat 1 dhe 4 të nenit 6 kanë pasur këtë përmbajtje: 1. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit është person juridik publik, i specializuar për njësitë e ruajtjes dhe kontrollin e tyre. 4. Drejtori i Përgjithshëm emërohet dhe shkarkohet nga Kryeministri. Me ndryshimin që u bëhet pikave 1 dhe 4 të nenit 6 me ligjin nr.9542, datë 22.5.2006, ato kanë këtë përmbajtje: 1. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe e Kalibrimit është person juridik dhe kontrollin e tyre, në varësi të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. 4. Drejtori i Përgjithshëm emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Ligji ka 3 nene dhe ka hyrë në fuqi më 24.6.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.57 të vitit 2006, në faqen 1631.

Ligj nr.9543, datë 29.5.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së sigurisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Greqisë për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar”. Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Greqisë, në lidhjen e kësaj Marrëveshjeje kanë pasur për qëllim të sigurojnë mbrojtjen e ndërsjellë të gjithë informacionit të klasifikuar, të klasifikuar si të tillë në

mbështetje të legjislacionit në fuqi në shtetin e njëjës palë dhe të transferuar në shtetin e palës tjetër nga autoritetet kompetente ose personat e autorizuar. Sipas Marrëveshjes “informacion i klasifikuar” nënkupton çdo informacion, pavarësisht nga forma e tij fizike, karakteristikat, si dhe mjetet e transmetimit, i cili, në interes të sigurisë kombëtare, kërkon mbrojtje nga aksesi i paautorizuar. Përveç kësaj, me “dokument i klasifikuar” nënkupton çdo artikull që përmban informacion të klasifikuar, pavarësisht nga forma fizike e tij, karakteristikat, si dhe mjetet e transmetimit, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar te shkresat, letrat dhe shënimet e shkruara, procesverbalet, raportet, memorandumet, skicat, fotografitë, filmat, hartat, grafikët, planet, disketat etj. Dokumentet që përmbajnë informacionin e përmendur më lart do të shenjëzohen me ekuivalenten e nivelit të klasifikimit të sigurisë kombëtare në përputhje me dispozitat e legjislacionit të brendshëm të secilës palë. Autoritetet kompetente të shteteve palë, që përgjigjen për zbatimin e Marrëveshjes, janë Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, për Republikën e Shqipërisë dhe Shtabi i Përgjithshëm i Mbrojtjes Kombëtare Greke, Drejtoria e Përbashkët e Inteligjencës Ushtarake, Seksioni për Sigurimin dhe Kundërzbulimin për Republikën e Greqisë. Në Marrëveshje janë parashikuar, gjithashtu, edhe kufizimet mbi përdorimin dhe bërjen publike të informacionit të klasifikuar, mënyra e veprimit kur kemi të bëjmë me përkthimin, riprodhimin dhe shkatërrimin e këtyre dokumenteve, ose kur kemi të bëjmë me shkelje të rregullave të sigurisë etj. Edhe problemet e shpenzimeve që do të bëjnë palët për zbatimin e Marrëveshjes, si dhe rastet e mosmarrëveshjeve dhe mënyra e zgjidhjes së tyre, trajtohen në nene të veçanta. Marrëveshja është bërë në Athinë më 14 shkurt 2006. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 5.7.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.63 të vitit 2006, në faqen 1727. Ligji i bashkëlidhet Marrëveshja e Sigurisë.

Ligji nr. 9544, datë 29.5.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes

ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve, viktima të trafikimit”. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Greke, të udhëhequr nga dëshira për të bashkëpunuar, zbatuar dhe respektuar të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga instrumentet ndërkombëtare përkatëse, lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, kanë shprehur solidaritetin dhe përkushtimin e tyre për të luftuar trafikimin e fëmijëve dhe çdo formë të shfrytëzimit të tyre. Për realizimin e këtyre angazhimeve, në Marrëveshje është parashikuar që palët të bëjnë harmonizimin efektiv të përkufizimit të krimeve dhe procedurave dhe bashkëpunimin bazuar në parimet dhe metodat e pranuar nga të dyja palët. Lidhur me këtë, palët kontraktuese kanë rënë dakord që, në kuadër të sistemeve të tyre ligjore kombëtare dhe kur shihet e nevojshme, të vendosen sanksione të veçanta për trafikimin dhe shfrytëzimin e fëmijëve. Gjithashtu, gjithnjë në këtë kuadër, palët kanë rënë dakord për të penalizuar tentativën, bashkëpunimin dhe nxitjen morale, lidhur me krimin e trafikimit të fëmijëve, duke përpunur legjislacionin për mbrojtjen e fëmijëve me standardet ndërkombëtare. Detyre me rëndësi për palët kontraktuese është edhe marrja përsipër, për të miratuar masa efektive, nëse këto masa nuk ekzistojnë, për themelimin ose funksionimin e njësive antitrafik në strukturën e autoriteteve të përshtatshme policore, të përbëra nga personel i trajnuar, që punon me kohe të plotë, për mbrojtjen e fëmijëve. Marrëveshja trajton edhe politikat financiare dhe sociale në përcaktimin e shkaqeve, të origjinës së trafikimit të fëmijëve dhe njëkohësisht jep edhe mundësinë e parandalimit, ndërmjet të cilave janë rritja e mundësisë për arsimimin dhe trajtimin profesional, si dhe rritja e përqindjes të ndjekjes së shkollës. Si masë parandaluese parashikohet edhe ndërgjegjësimi i shoqërisë kundër trafikimit të fëmijëve, vënia në jetë e masave institucionale për këtë parandalim, duke u krijuar nga secila palë nga një grup qendror bashkërendues, që do të bashkëpunojnë për të siguruar

vënien efektive në jetë të kësaj Marrëveshjeje. Me rëndësi janë edhe parashikimet në kreun III që trajtojnë problemet e identifikimit të viktimeve fëmijë, referimi i një viktime fëmijë, te autoritetet kompetente, caktimi i një kujdestari të përkohshëm, riatdhesimi i sigurt, integrimi, rivendosja e fëmijës në një vend të tretë etj. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 7.7.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 63 të vitit 2006, në faqen 1731. Ligjit i bashkëngjitet Marrëveshja.

Nga punimet e Kuvendit për periudhën 21 janar – 3 mars 2008

*Përgatiti: Alma Kondakçiu
Këshilltare,*

*Komisioni për Ekonominë dhe Financat,
Kuvendi i Shqipërisë*

1. P/ligji “Për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi sasinë e arit dhe metaleve të tjera të çmuara, nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, Bankës së Shqipërisë” (miratuar në seancë plenare në datën 24 janar 2008).

Projektligji ka objekt ndryshimin e pronësisë së një pjese të rezervave valutore të Republikës së Shqipërisë, që aktualisht është në pronësi të Këshillit të Ministrave. Konkretisht, bëhet fjalë për një sasi ari të barabartë me rreth 86 mijë onz dhe një rezervë në metale të tjera të çmuara në shumën rreth 120 mijë onz, të dyja të konvertueshme në rreth 5.7 miliardë lekë. Ky ndryshim i pronësisë do të bëjë të mundur rritjen e vlerës së aseteve të Bankës së Shqipërisë dhe përmirësimin e bilancit financiar të saj. Ai është sugjeruar në raportin e misionit të FMN-së në tetor të vitit 2007.

Kjo rezervë valutore administrohet nga Banka e Shqipërisë, mbështetur në bazën ligjore si më poshtë:

- nenin 161 të Kushtetutës, pika 1, sipas të cilit Banka e Shqipërisë ka të drejtën e mbajtjes dhe të administrimit të rezervave valutore të Republikës së Shqipërisë;

- nenin 63 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i

cili e detyron Bankën e Shqipërisë të mbajë dhe administrojë rezervat valutore të Republikës së Shqipërisë në ar apo metale të tjera të çmuara. Ajo përdor mundësitë e saj më të mira për të mbajtur rezervën e saj valutore ndërkombëtare në një nivel që, sipas opinionit të Bankës së Shqipërisë, është i përshtatshëm për zbatimin e politikës monetare dhe të këmbimeve valutore të Republikës së Shqipërisë dhe ekzekutimet e menjëhershme të pagesave në transaksionet me jashtë.

Veç kësaj, Banka e Shqipërisë ka në pronësi dhe administron rezervat valutore të krijuara nga veprimtaria e saj, mbështetur në nenin 3, pika 4, shkronja “ç” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997, i cili e ngarkon këtë institucion të disponojë dhe të administrojë rezervat e tij valutore.

Në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, si dhe në seancë plenare, deputetët e konsideruan të nevojshëm ndryshimin e pronësisë së rezervave valutore, pasi ai do të ndikojë jo vetëm në rritjen e kapitalit të Bankës së Shqipërisë, por edhe në përmirësimin e administrimit të tij.

Çështjet e diskutuara nga deputetët për këtë projektligj ishin:

- përrputhja e projektligjit me nenin 161, pika 1 të Kushtetutës, sipas të cilit Banka e Shqipërisë ka të drejtën e mbajtjes dhe të administrimit të rezervave valutore të Republikës së Shqipërisë.

- përfshirja në projektligj e një neni, i cili të detyrojë Bankën e Shqipërisë të pasqyrojë në aktet ligjore e nënligjore ekzistuese ndryshimin e pronësisë së arit dhe metaleve të tjera të çmuara.

Pas sqarimeve të dhëna nga specialistët për përrputhjen e projektligjit me Kushtetutën dhe për plotësinë e përmbajtjes së tij, Kuvendi e miratoi projektligjin.

2. P/ligji “Për ushqimin” (miratuar në seancë plenare në datën 28 janar 2007).

Projektligji ka qëllim të vendosë bazat për sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe interesave të konsumatorit. Ai përcakton kërkesat dhe parimet e përgjithshme, që lidhen me sigurinë e

ushqimeve për njerëz dhe kafshë, lëvizjen e lirë të ushqimeve në treg dhe siguron përshtatjen me standartet ndërkombëtare.

Në projektligj parashikohet ngritja për herë të parë e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU), në varësi të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, i cili do të kryejë veprimtari inspektuese, teknike dhe shkencore për sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve.

Në Komisionin për Veprimtarisë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, si dhe në seancë plenare, pati debate për varësinë e AKU-së. Disa deputetë u shprehën që ky autoritet të ishte në varësi të Këshillit të Ministrave, por me shumicë votash u vendos që të mbetet në varësi të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Krahas kësaj, në këtë Komision u vendosën disa ndryshime parimore e teknike në projektligj, nga të cilat më kryesoret janë:

1- disa kompetenca që projektligji ia jep Ministrisë së Shëndëtsisë i kalojnë Ministrisë së Bujqësisë, sepse zgjidhja e disa problemeve nga 2 ministra do të sillte vonesa e anomali në vendimmarrje;

2- për të përmirësuar sigurinë ushqimore dhe për të rritur rolin e ministrisë që mbulon fushën e ushqimit, të gjitha udhëzimet që nxjerr Ministri i Bujqësisë, në kuadër të këtij ligji, do të bëhen me propozim të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;

3- u vendos që AKU do të ketë drejtori rajonale në qarqe, të cilat do të lidhen në mënyrë elektronike me qendrën dhe nuk do të kenë asnjë lidhje me drejtoritë rajonale të bujqësisë, siç parashikohet në projektligj;

4- emërimi i drejtorit të AKU-së u vendos të bëhet nga Kryeministri dhe jo nga ministri, siç parashikohet në projektligj;

5- u bënë ndërhyrje në diapazonin e gjobave, kryesisht duke rritur nivelin minimal e zbutur nivelin maksimal të propozuar) etj.

Deputetët mbajtën qëndrime të ndryshme për nenin 19 të projektligjit, i cili trajton aplikimin, miratimin dhe regjistrimin e stabilimenteve. Disa deputetë mendonin që regjistri të mbahej në Agjencinë Kombëtare të Ushqimit, si

organ kompetent për sigurinë ushqimore dhe disa që të mbahej në Ministrinë e Bujqësisë, duke përdorur si argumente rëndimin e procedurave të regjistrimit të biznesit dhe sigurinë konsumatore.

Pas përfundimit të diskutimit, Kuvendi e miratoi projektligjin.

1. P/vendim “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare për periudhën 2007-2011”. (miratuar në seancë plenare në datën 31 janar 2007).

Projektprogrami i Statistikave Zyrtare 2007-2011 është hartuar nga Instituti i Statistikave, mbështetur në asistencën teknike të ekspertëve të Komunitetit Europian dhe mban në konsideratë programin e Qeverisë, detyrimet e INSTAT-it, në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, si dhe legjislacionin e vendeve të BE-së.

Programi i Statistikave Zyrtare përfshin:

- a) përshkrimin e statistikave kryesore dhe treguesit që vihen në dispozicion;
- b) institucionet përgjegjëse për prodhimin dhe shpërndarjen e rezultateve;
- c) klasifikimet që përdoren;
- ç) nivelin, në të cilin statistikave dhe treguesit bëhen të disponueshëm (nivel kombëtar, prefekturë, rrethi etj);
- d) frekuencën, me të cilën statistikave dhe treguesit bëhen të disponueshëm;
- dh) vitin, në të cilin do të shpërndahen statistikave dhe treguesit;
- e) vitin, në të cilin do të bëhen për herë të parë të disponueshme statistikave dhe treguesit e rinj;
- ë) listën e burimeve të përdorura për nxjerrjen e statistikave dhe të treguesve, të cilat mund të jenë të dhëna administrative ose vrojtme;
- f) burimet administrative, që janë regjistrat, regjistrimet, të dhënat dhe rezultatet që duhet t’i kalojnë INSTAT-it dhe agjencive statistikore, institucionet përgjegjëse dhe afatet kohore për këto veprimtari;
- g) listën e vrojtmeve që duhet të ndërmerren nga institucionet përgjegjëse, pyetësorët, regjistrimet e të dhënave dhe rezultatet që duhet t’i kalojnë INSTAT-it dhe agjencive statistikore, si dhe afatet kohore për këto veprimtari.

Në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, Drejtorja e Institutit të Statistikave, si dhe specialistë të këtij Instituti, iu përgjigjën pyetjeve të deputetëve për përmirësimet që parashikohet të sjellë zbatimi i këtij programi në drejtim të cilësisë së treguesve statistikorë, metodikat e përlogaritjes së këtyre treguesve, shkallën e përafrimit të tyre me metodikat e Eurostatit etj.

Gjatë diskutimit në këtë Komision, si dhe në seancë plenare, deputetët vlerësuan përpjekjet e Institutit të Statistikës për të hartuar këtë program afatgjatë, zbatimi i të cilit do të ndikojë në përmirësimin e sistemit statistikor dhe të cilësisë së treguesve statistikorë në vendin tonë dhe do të luajë rol të rëndësishëm në hartimin e programeve e strategjive të zhvillimit të vendit. Ata kërkuan rritjet e rolit të Institutit të Statistikave, si institucioni kryesor që përpunon statistikat në vendin tonë. Për të vënë në zbatim të gjitha detyrimet e këtij Programi, deputetët u shprehën se duhet të rritet mbështetja e INSTAT-it me fonde buxhetore, kapacitete administrative profesionale e infrastrukturë.

Deputetët e opozitës, pasi vlerësuan rolin e rëndësishëm të statistikave në përmirësimin e cilësisë së qeverisjes dhe rritjen e qëndrueshmërisë së ekonomisë, paraqitën disa vërejtje për përmbajtjen e Programit. Ata ishin të mendimit se Programi duhet të shoqërohej me një relacion të Qeverisë, ku të pasqyrohej shkalla e përafrimit të tij me metodikat dhe treguesit e Eurostatit, si dhe kërkuan statistika më të plota për koston e Programit dhe pjesën e saj që do të përballohet nga Buxheti i Shtetit.

Projektvendimi u miratua me shumicë votash.

2. P/ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura” (miratuar në seancë plenare në datën 4 shkurt 2007).

Projektligji përcakton kriteret që duhet të plotësojë territori për t’u shpallur zonë e mbrojtur, ndarjen në nënzona, sipas rëndësisë së habitateve dhe ekosistemeve, përcaktimin e zonave të veçanta të ruajtjes, të cilat janë tipe të habitateve natyrore e të llojeve me interes për komunitetin evropian, si

dhe kriteret, vlerësimet dhe menaxhimin e këtyre zonave. Përveç zonave të mbrojtura me karakter kombëtar, këshillave të qarqeve, për nevoja të komunitetit, u krijohet mundësia të shpallin parqe natyrore rajonale në territorin pronë e tyre, që kanë vlera natyrore të tilla si pyje, kullota, rezervuarë, ligatina etj. Këto parqe natyrore rajonale do të sigurojnë një përdorim të qëndrueshëm të territorit dhe zhvillimin e veprimtarive që i përshtaten karakterit të zonës.

Gjatë diskutimit në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, si dhe në seancë plenare, deputetët u shprehën dakord në parim me projektligjin dhe vlerësuan zhvillimet pozitive në drejtim të zgjerimit të zonave të mbrojtura, si dhe punën që po bëhet për përmirësimin e administrimit të tyre. Nga disa deputetë u ngrit shqetësimi se ligji ekzistues nuk ka gjetur zbatim dhe u kërkua që të bëhen përpjekje më të mëdha nga administrata shtetërore për mbrojtjen e këtyre zonave.

Përfaqësuesit e Qeverisë informuan Kuvendin për punën që po bëhet në këtë fushë, si përgatitja e vendimeve, studimeve, rritja e numrit të punonjësve që bëjnë pjesë në administratën e zonave të mbrojtura etj.

Pas përfundimit të diskutimit, Kuvendi e miratoi projektligjin.

3. P/ligji “Për huamarrjen e qeverisjes vendore” (miratuar në seancë plenare në datën 4 shkurt 2007).

Projektligji përcakton rregullat, sipas të cilave njësitë e qeverisjes vendore kanë të drejtë të marrin hua në formën e marrëveshjeve të kredisë, qirasë financiare, linjës së kreditit dhe marrëveshjeve të tjera që krijojnë detyrime financiare, si dhe në formën e emetimit të letrave me vlerë (titujve). Huaja afatshkurtër, me afat shlyerjeje deri në një vit, mund të merret vetëm në tregjet kombëtare dhe përdoret për kryerjen e pagesave, në rast të mungesës së përkohshme të likuiditeteve. Huaja afatgjatë, me afat shlyerjeje të barabartë ose më të gjatë se një vit, mund të merret në tregjet kombëtare e ndërkombëtare dhe shërben për të financuar projekte specifike kapitale ose për të rifinancuar borxhin ekzistues. Duke qenë se borxhi vendor është

pjesë e borxhit publik të vendit, ai menaxhohet dhe miratohet nga Ministria e Financave.

Gjatë diskutimit të projektligjit në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, Zëvendësministri i Financave informoi deputetët për procedurat e ndjekura për hartimin e tij, mbështetjen në ekspertizën e institucioneve ndërkombëtare, standardet më të mira të arritura në vende të tjera, si dhe konsultimet me shoqatat e bashkive e komunave. Ai prezantoi elementët kryesorë të projektligjit dhe iu përgjigj pyetjeve të deputetëve për hapësirat e njësisë të qeverisjes vendore për të marrë borxh, raportin e tij me investimet, përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore, të nevojshme për zbatimin e këtij ligji etj. Përfaqësuesit e shoqatave të bashkive e komunave, pasi paraqitën vlerësimin e tyre pozitiv për projektligjin, shprehën mendime për disa korrigjime në përmbajtjen e tij, veçanërisht për kufizimet e njësisë të qeverisjes vendore për të marrë borxh afatgjatë. Këto vërejtje u bënë objekt diskutimi në Komision dhe një pjesë e tyre u morën në konsideratë.

Projektligji u vlerësua pozitivisht nga të gjithë deputetët, si një hap i rëndësishëm në procesin e decentralizimit, i cili zgjeron autonominë e njësisë të qeverisjes vendore, duke u krijuar atyre mundësi për të kryer investime dhe përballuar shpenzime në mënyrë të pavarur nga pushteti qendror. Ai realizon një proces transparent huamarrjeje, në përputhje me politikat e zhvillimit të vendit dhe ndikon në forcimin e stabilitetit makroekonomik të vendit.

Me këto argumente, Kuvendi e miratoi projektligjin me disa ndryshime në përmbajtje.

1. Projektligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë (shqyrtuar në seancë plenare në datën 18 shkurt 2008).

Projektligji është pjesë e reformës në sistemin e drejtësisë dhe synon të forcojë pavarësinë e sistemit gjyqësor e të rrisë efektivitetin e funksionimit të strukturave të tij. Ai sjell disa risi në organizimin e gjykatave, vlerësimin

dhe karrierën e gjyqtarëve, mekanizmat e konkurrimit të tyre, pagën dhe elemente të tjera, që kanë qëllim shëndoshjen dhe funksionimin më të mirë të sistemit gjyqësor në vendin tonë.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut u njoh me mendimet e grupeve të interesit, si Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Konferencës Gjyqësore Kombëtare, Avokatit të Popullit, Gjykatës Ushtarake të Apelit, Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Grupit Parlamentar LSI + PDS, të cilat u diskutuan nga një grup ekspertësh e, më pas, nga deputetët dhe u morën në konsideratë pjesërisht. Shqyrtimi i këtij projektligji u realizua nëpërmjet një kontributi të përbashkët të deputetëve të forcave të ndryshme politike, të cilët vendosën me konsensus ta miratojnë atë me disa ndryshime, që synojnë përmirësimin e statusit të gjyqtarëve, nëpërmjet riformulimit të dispozitave për emërimin dhe vlerësimin e tyre, karrierën profesionale dhe drejtuese, sistemin e pagave, procedimin disiplinor etj.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në seancë plenare deputetët e dy forcave kryesore politike e vlerësuan pozitivisht projektligjin e riformuluar nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, duke theksuar se ai sjell disa risi në funksionimin e sistemit gjyqësor, veçanërisht në normat që rregullojnë karrierën e gjyqtarëve, kriteret e përzgjedhjes dhe kompetencat e kryetarëve të gjykatave të shkallës së parë e të apelit, vlerësimin e aftësive profesionale të gjyqtarëve etj. Në mënyrë të veçantë, ata vlerësuan riformulimin e dispozitave për pagën e gjyqtarëve, duke hequr trajtimin unik e të barabartë për të gjithë gjyqtarët dhe duke vendosur trajtimin individual të tyre; vendosjen e së drejtës së shpërblimit për kryetarët e gjykatave; vendosjen e shpërblimit për kushte të veçanta pune për gjyqtarin dhe kryetarin e Gjykatës së Krimeve të Rënda, vendosjen e shpërblimit për vjetërsinë në profesion për të dyja nivelet e gjykatave etj.

Disa deputetë të grupeve të vogla parlamentare paraqitën vërejtje për disa dispozita të projektligjit. Në lidhje me gjykatën administrative, ata ishin të mendimit se projektligji arrin vetëm të vendosë detyrimin për ngritjen e

saj, por nuk krijon hapësirat e nevojshme ligjore për ngritjen dhe funksionimin e plotë të saj, në raport me gjykatat e rrethit, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën e Lartë. Ata kundërshtuan procedurat për emërimin e kryetarëve të gjykatave nga KLD, procedurat e emërimit të gjyqtarëve për krimet e rënda dhe gjyqtarëve të apelit, procedimin disiplinor të gjyqtarëve nga Ministri i Drejtësisë etj.

Pas përfundimit të diskutimit, Kuvendi e miratoi projektligjin me shumicë votash.

2. Projektligji “Për ankandin publik”.

Projektligji “Për ankandin publik”, së bashku me ligjin “Për prokurimin publik” dhe ligjin “Për koncesionet” formojnë kuadrin e plotë ligjor të administrimit të fondeve dhe pasurive publike.

Procedurat e ankandit deri tani janë realizuar nga institucionet, rast pas rasti, duke u bazuar vetëm në rregullore të përgjithshme ose në vendimet e Qeverisë, që datojnë edhe në vitin 1991. Pra, nuk ka pasur transparencë në realizimin e procedurave të ankandit, njoftimet kanë qenë spontane dhe nuk bëheshin në buletine zyrtare, duke krijuar preferenca në përzgjedhjen e pjesëmarrësve. Nuk realizoheshin kushte të barabarta për pjesëmarrësit në ankand dhe dokumentacionet e ankandit nuk ishin lehtësisht të aksesueshme. Pjesëmarrësit në ankand, po të ishin të pakënaqur nga rezultatet e ankandit, nuk kishin se ku të ankoheshin.

Ky projektligj synon:

- rritjen e transparencës në procedurat e ankandit publik;
- vendosjen e sektorit publik në shërbim të përdoruesve;
- rritjen e efektivitetit të sektorit publik, nëpërmjet shkurtimit të kohës së pritjes, uljes së numrit të gabimeve, dhënies së kohës së nevojshme për kryerjen e shërbimeve ndaj publikut.

Ky projektligj ndihmon që sektori publik të kthehet në një sistem të hapur, gjithëpërfshirës dhe produktiv.

Për herë të parë, në procedurat e ankandit i jepet palëve e drejta e

ankimit pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, si një organizëm i paanshëm dhe transparent.

Në projektligj futet edhe institucioni i Avokatit të Prokurimeve Publike, duke rritur transparencën e institucioneve shtetërore ndaj publikut.

Në projektligj përcaktohen rregullat e procedurave të ankandit, duke dhënë parime të tilla si mosdiskriminimi, e drejta për informim, fshehtësia e procesit, shmangia e veprimeve korruptive dhe e konfliktit të interesit, format e komunikimit etj.

Një element i ri i projektligjit është parashikimi i komunikimit elektronik, si një ndër format e komunikimit, për të realizuar transparencë, komunikim të hapur e të drejtpërdrejtë, për të shkurtuar kohë etj.

Gjatë diskutimit të projektligjit në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, si dhe në seancë plenare, deputetët miratuan disa ndryshime në formulimin e neneve të tij.

Kuvendi e miratoi projektligjin me shumisë votash.

3. Projektligji “Për titujt” (shqyrtuar në seancë plenare në datën 21 shkurt 2008).

Projektligji synon të krijojë një kuadër të plotë ligjor për titujt dhe transaksionet me to. Kuadri rregullator që propozohet është më i gjerë e më i plotë se ai i parashikuar në ligjin “Për letrat me vlerë”, mbi bazën e të cilit është rregulluar deri sot ky treg. Hartimi i këtij projektligji është detyrim i dokumentit të partneritetit europian, i cili kërkon modifikimin e legjislacionit ekzistues, veçanërisht në drejtim të së drejtës së vendosjes së shoqërive të huaja, trajtimit të barabartë të tyre me shoqëritë vendase, ofrimit të përkohshëm dhe të përhershëm të shërbimeve, përmirësimit të monitorimit të sektorit financiar, si dhe përputhjes së tij me kërkesat e MSA-së.

Titujt do të mund të emetohen nga Këshilli i Ministrave, Banka e Shqipërisë, njësitë e qeverisjes vendore, shoqëritë tregtare e persona të tjerë juridikë. Llojet e titujve që emetohen dhe tregtohen në vendin tonë do të jenë: aksionet, obligacionet, bonot e thesarit dhe dëftesat tregtare.

Projektligji parashikon rregullat për veprimtarinë e shoqërive komisionere, bursës, komisionerëve të bursës dhe këshilltarëve të investimeve, të drejtat dhe detyrimet e personave që kryejnë transaksione, kujdestarinë e titujve, tregtimin e tyre në bursë, tregtimin ndërmjet investorëve institucionalë, kufizimet e veprimtarisë, garancitë për përmbushjen e detyrimeve, mbrojtjen e investorëve, regjistrimet elektronike të titujve, si dhe përgjegjësitë e personave që shkelin detyrimet ligjore në treg.

Projektligji saktëson rolin e rëndësishëm të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, si ent rregullator dhe mbikëqyrës i tregut të titujve, si dhe raportet e këtij të fundit me institucionet pjesëmarrëse.

Për hartimin e projektligjit është marrë eksperiencë nga vende, të cilat janë pak a shumë në të njëjtin stad zhvillimi ekonomik dhe financiar, si dhe të zhvillimit të sektorit privat.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrtoi projektligjin gjatë tri seancave, në konsultim me përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Bankës së Shqipërisë.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në komision u bënë përmirësime dhe rregullime në 25 nene të tij, disa prej të cilave janë ndryshime thelbësore, duke kontribuar në këtë mënyrë për një produkt cilësor dhe të pranueshëm nga të gjithë aktorët që do e zbatojnë atë.

Ndryshimet e propozuara synojnë zgjerimin e hapësirës së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për të implementuar strategji të zhvillimit dhe funksionimit të bursës së titujve. Dhënia e kompetencës Autoritetit për të përcaktuar kufizime në pjesëmarrjen si aksionarë të bursës, synon të përmirësojë strukturën aksionare të saj nëpërmjet përfshirjes së mundshme të investitorit strategjik dhe institucioneve financiare, si dhe vendosjes së kufizimeve tavan, për pjesëmarrjen e aksionarëve të tjerë në kapitalin bazë të bursës.

Ndryshimet në nenet 42, 121, 127, 131 dhe 139 krijojnë hapësirë për licensimin e veprimtarisë së kleringut dhe shlyerjes së llogarive në subjektet

që kanë infrastrukturën për të bërë një operacion të tillë, siç mund të jenë kujdestari ose një depozitar në të ardhmen, i cili do përmbledhë të gjitha operacionet e kleringut, shlyerjes dhe regjistrimit të llogarive.

Krahas këtyre ndryshimeve, janë vendosur disa kërkesa shtesë për drejtuesit e bursës së titujve, si dhe janë hequr kërkesat për dokumentacionin që shoqëron kërkesën për licensim për transaksione me titujt, duke ia lënë këtë të drejtë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Ndryshimet në nenin 48 krijojnë fleksibilitet më të madh në përcaktimin e dokumentacionit dhe procedurave të licensimit, si dhe një raport më të drejtë të kërkesave që duhen rregulluar me akt rregullativ të një niveli më të ulët.

Vërejtjet dhe ndryshimet e propozuara nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat u miratuan nga deputetët në seancë plenare. Ata theksuan se, që të vihet në zbatim projektligji, është e nevojshme që Këshilli i Ministrave dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të hartojnë aktet nënligjore. Për këtë qëllim, Autoritetit i është lënë një vit afat kohë që të përmbushë të gjitha detyrimet.

Projektligji mori miratimin e të gjithë deputetëve të pranishëm në seancë plenare.

4. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar (shqyrtuar në seancë plenare në datën 28 shkurt 2008).

Shtesat dhe ndryshimet kryesore që i bëhen ligjit ekzistues kanë objekt:

- riorganizimin e drejtorive rajonale të monumenteve të kulturës në rrethe, duke u dhënë më tepër kompetenca për mbrojtjen, ruajtjen dhe restaturimin e monumenteve të kulturës;

- zonifikimin, me qëllim shmangjen e ndërtimeve të paligjshme në zonat arkeologjike apo në territoret pranë monumenteve të kulturës;

- konfiskimin e pronës monument kulture, në rastet kur pronari nuk tregon kujdesin e duhur, e braktis ose e le atë të rrënohet. Ky proces mbështetet në përvojën rajonale dhe europiane, në fushën e trashëgimisë kulturore;

- ngritjen e Agjencisë së Shërbimit të Arkeologjisë dhe të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë, si institucione me kompetenca të plota për zbatimin e këtij ligji;

- mbështetjen financiare të shtetit ndaj pronarëve të objekteve të trashëgimisë kulturore, duke i financuar ata me 60 për qind të vlerës së objektit dhe duke u dhënë mundësinë e kreditimit me kushte lehtësuese për vlerën e mbetur.

Një ndër çështjet kryesore të diskutuara në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, si dhe në seancë plenare, ishte dhënia e kompetencës institucionit që ka në administrim objektin kulturor, që t'i propozojë Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve që ta shpronësojë pronarin e këtij objekti. Shumica e deputetëve ishin të mendimit se kjo dispozitë nuk duhet miratuar, sepse shkel të drejtat kushtetuese të pronarëve, në kushtet e pamundësisë financiare për mirëmbajtjen dhe restaurimin e objektit kulturor.

Një pjesë e deputetëve argumentuan se kjo dispozitë shmang rastet e abuzimit nga disa persona për ta restaturuar objektin kulturor, duke krijuar hapësirë që të gjitha objektet kulturore të restaurohen nga shteti.

Kuvendi vendosi me shumicë votash heqjen e këtij neni dhe trajtimin e mbrojtjes së pronësisë së objekteve monument kulture në ligjet specifike.

Pasi bëri disa ndryshime të tjera në përmbajtjen e projektligjit, Kuvendi e miratoi atë me shumicë votash.

